



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

RAPORT VJETOR

BORDI I DREJTORËVE

2006

Maj, 2007

HYRJE

Në bazë të dispozitave të nenit 42 të Rregullores për vetëqeverisjen e komunave në Kosovë, nr. 2000/45, të dispozitave të nenit 40, shkronja (ç) të Statutit të Komunës, të dt. 16.3.2001, kryeshefi i Ekzekutivit të Komunës së Prishtinës, përmes Bordit të drejtorëve, i dërgon Kuvendit të Komunës për miratim raportin e punës për vitin 2006.

KRYESHEFI I EKZEKUTIVIT

Ka ushtruar pushtetin ekzekutiv, së bashku me drejtorët e drejtorive, duke zbatuar kompetencat e tij të përcaktuara me Statutin e Komunës, rregulloret e miratuara nga Kuvendi i Komunës, ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës, e të fuqizuara me nënshkrimin e tyre nga ana e PSSP-së.

Skema organizative e organeve të administratës është miratuar në seancën e parë të Kuvendit të Komunës, të mbajtur më 29.12.2005, dhe në bazë të kësaj skeme është bërë organizimi i punëve dhe detyrave për vitin në raportim. Kryeshefi i Ekzekutivit poashtu ka siguruar që edhe institucionet arsimore dhe shëndetësore dhe ndërmarrjet: “Trafiku Urban”, “Hortikultura”, “Sport-Marketingu”, të qeverisen në mënyrë efikase.

Puna e kryeshefit të Ekzekutivit ka qenë e orientuar në:

- përkujdesin për organizimin dhe mbarvajtjen e mbledhjeve të Kuvendit,
- dhënien e ndihmës kryetarit dhe zëvendëskryetarit,
- zbatimin e vendimeve të miratuara,
- iniciimin e procedurës për ndryshimin dhe plotësimin e rregulloreve komunale me ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës,
- ngritjen e nivelit në punë, me qëllim të arritjes së efikasitetit sa më të mirë në punë,
- ngritjen e cilësisë së shërbimeve publike, në pjesën urbane dhe në viset rurale,
- miratimin e planeve-projekteve: planet rregulluese, projektet në lëmin e kulturës, gjinisë, rinisë dhe të sportit, miratimin e rregullativës në mënyrë që ndërmarrjet komunale të kenë mbarëvajtje në punë, në fushat që janë në kompetencë të tyre,
- kujdesin për ligjshmërinë e punëve të organeve administrative, ligjshmërinë e çështjeve financiare të Komunës,
- lëshimin e urdhëresave administrative, me të cilat janë rregulluar fushëveprimet e disa organeve (për kufizimin e sasisë së ujit, vendosjen e stendave në hapësira publike, ndalimin nga keqpërdorimi i sipërfaqeve të gjelbëruara, përdorimin e mjeteve ndezëse, nga të cilat do të mund të shkaktohej zjarri në sipërfaqet e pyllëzuara,
- avancimin e transparencës në Komunë, e që është arritur përmes ridizajnit të “Web-faqes” së Komunës, përgatitjet e bëra për botimin e Buletinit mujor të Komunës, publikimit të doracakut për rregulloret komunale, urdhëresat administrative, udhëzime dhe vendime. Edhe pse në vitin raportues është nxjerrë Udhëzimi për transparencë, Komuna, sikurse edhe komunat tjera të Kosovës, ka qenë në dilemë se çka të bëjë, meqë mungon Ligji për transparencë. Për vitin vijues, së bashku me drejtorët e drejtorive, Komuna do ta ketë Planin e veprimit:
- Pjesëmarrje aktive në takimet e organizura për zgjidhjen e çështjes së statusit të Kosovës, përmbushjen e detyrave që rrjedhin nga planet e veprimit për standardet-integritet evropiane;

- Pjesëmarrje në kolegjiunin e kryeshefave të ekzekutiveve të komunave në një rol të rëndësishëm dhe duke marrë pjesë aktive, në mënyrë që të kenë qasje në të gjitha problemet që i preokupojnë komunitat;
- Ngritje të realizimit të të hyrave vetanake, për ç'arsye, në fund të vitit raportues është filluar edhe me harmonizimin e rregullave për inkasim më të suksesshëm të të hyrave vetanake;
- Dëgjime publike për buxhetin. Vlen të theksohet se dëgjimi I-II publik janë mbajtur gjatë periudhës qershor-korrik, ndërsa dëgjimi III-IV publik për buxhetin janë mbajtur në muajin shtator.

S F I D A T

Në vitin vijues prioritet do t'u jepet këtyre veprimeve:

1. Në krijimin e politikave:

- hartimit të strategjisë së zhvillimit ekonomik të komunës për periudhën 2007-2011,
- kompletimit të planeve rregulluese,
- parandalimi i ndërtimeve ilegale,
- lirimit të pronës së uzurpuar komunale,
- planifikimit të infrastrukturës dhe realizimit të këtij planifikimi,
- përkujdesje parësore shëndetësore – skemës për ndihmë sociale dhe shëndetësi familjare,
- mbrojtjes së konsumatorëve dhe të shëndetit publik,
- parandalimit dhe luftimit të diskriminimit,
- ngritjes së nivelit të të hyrave vetanake,
- sigurimit të donacioneve për realizim të projekteve, të shfrytëzimit të fondeve publike dhe të burimeve publike, duke përcaktuar edhe rregullat që do të zbatohen,
- qasjes në dokumentet zyrtare.

2. Në procesin e vendimmarrjes:

- caktimin e saktë të kompetencave të Komunës dhe drejtorive mes tyre,
- sigurimin e transparencës,
- aftësimin e kapaciteteve njerëzore, e sidomos të kuadrit profesional menaxhues.

3. Në lëmin e transparencës:

- shpërndarja e të dhënave përmes “Web-faqes”, buletinit dhe doracakëve,
- kompletimi i Zyrës për informim me të punësuar,
- debate publike që do të organizoheshin nga niveli komunal në objektet e Komunës dhe të bashkësive lokale,

4. Në ngritjen e kapaciteteve funksionale:

- punësimin në bazë të kërkesave të drejtorëve të drejtorive, duke e zbatuar me përpikëri Udhëzimin administrative për ngrirjen e posteve në Shërbimin Civil,
- aftësimin profesional përmes trajnimeve,
- ngritjen e postit.

5. Në procesin e standardeve – integritit:

- përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësisve që kanë të bëjnë me realizimin e Planit të veprimit për integritime evropiane, të cilat do t'i shtrohen si nevojë Komunës së Prishtinës.

Vlen të theksohet se gjatë avancimit të çështjeve të mësipërme, mund të paraqiten vështirësi, e ato mund të jenë:

- paqartësia e përgjegjësive (kompetencave në mes të pushtetit qendror dhe atij lokal),
- moskrijimi i polititkave nga ana e nivelit qendror,
- problemet financiare,
- kapacitetet njerëzore,
- kushtet e punës,
- besueshmëria e ulët e mediave,
- niveli i ultë i bashkëpunimit me shoqërinë civile,
- zhvillimet demografike,
- vetëdëia e pamjaftueshme e rëndësisë së pjesëmarrjes në vendimmarrje nga ana e qytetarëve.

Të arriturat e kryeshefit të Ekzekutivit janë bërë me një përkushtim dhe bashkëpunim me nëpunësit e Shërbimit Civil: personelin, drejtorët e drejtorive, organet e administratës: Zyrën komunale në Graçanicë, Avokaturën Publike, institucionet që qeverisen nga Komuna, trupat e Kuvendit, pjesën politike të Komunës, IPVQ-të, OJQ-të, përfaqësues të UNMIK-ut, të KFOR-it, të SHPK-së dhe të AKM-së.

Ky raport pasqyron punën dhe aktivitetin e të cituarve më lart, ku theksohen veprimet dhe angazhimet konkrete të drejtorëve të drejtorive, gjegjësisht sektorëve – zyrave.

STANDARDET

Plani për përmbylljen e standardeve, prezantimi i tyre për vlerësim teknik dhe plani i veprimit për integritet evropiane, ka qenë dhe do të mbetet prioritet në angazhimin e kryeshefit të Ekzekutivit, drejtorëve të drejtorive, si dhe i angazhimit të drejtpërdrejtë të grupeve të caktuara, apo që do të caktohen për implementimin e tyre.

Gjatë viti 2006, ndaras nga angazhimet rreth përmbushjes së detyrave të përcaktuara me planin e veprimit, zbatimi i standardeve ka qenë një nga prioritet kryesorë në agjendën e tij.

Nga fillimi i muajit prill 2004, Komuna ka formuar Grupin punues për implementimin e standardeve, në përbërje prej 7 anëtarëve, dhe gjatë punës ai ka punuar edhe me nëngrupet e caktuara të shërbyesve civilë të Komunës. Për punën e vet grupi ka bashkëpunuar, ka raportuar dhe ka qenë përgjegjës për detyrat dhe përgjegjësitë e caktuara.

Të 8-të standardet e parashtruara nga KS i OKB-së, BE-ja, Grupi i Kontaktit dhe institucionet ndërkombetare për Kosovë, janë publikuar më 10.12.2003, ndërsa Plani për zbatimin e tyre është miratuar më 31.3.2004.

Tri vite pas, në komunën tonë ka të kthyer, është përmirësuar dukshëm liria e lëvizjes, nuk ka pasur ekcese në baza nacionale. Kuvendi i Komunës funksionon në bazë të rregulloreve në fuqi, e të cilat janë të harmonizuara me ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës.

Institucionet demokratike komunale

Në Institucionet komunale janë të përfshira të gjitha komunitetet që jetojnë dhe veprojnë në territorin e komunës së Prishtinës. Janë të përfaqësuar në mënyrë proporcionale në Kuvend dhe në trupat ndihmëse të Kuvendit – në komitete. Me përpjekje të udhëheqjes komunale, është arritur që edhe komuniteti serb të marrë pjesë aktive në Komitetin për Komunitete dhe Komitetin për ndërmjetësim gje që është arritur progres krahasur me vitin paraprak.

- Gjuhët zyrtare, respektohen në të gjitha organet dhe institucionet e Komunës, gjë që vërtetohet nga të dhënat e mëposhtme:
 - palës i kthehet përgjigja në gjuhën në të cilën është parashtruar kërkesa,
 - përkthimet bëhen në gjuhët zyrtare,
 - mbishkrimet e vendosura nga institucionet komunale, përfshirë këtu arsimin, shëndetësinë, emërtimet e rrugëve në qytet dhe në fshatra janë të shkruara në gjuhët zyrtare.
- Shërbimi civil, është i paanshëm dhe i përgjegjshëm, i përfaqësuar nga të gjitha komunitetet në komunën e Prishtinës, përfshirë këtu numër të theksuar të gjinisë femërore përafërsisht 30 %.
- Të gjitha komunitetet kanë qasje të drejtë në punësim në institucionet publike.
- Ekzistojnë kodet e mirësjelljes dhe procedurat e zbatimit, të cilat sigurojnë qeverisje transparente dhe të përgjegjshme ndaj rekomandimeve që vijnë nga niveli qendror.
- Propozimvendimet dhe rregulloret e Kuvendit të Komunës shqyrtohen nga komitetet përkatëse dhe organizmat tjer para se të miratohen në Kuvend.
- Është duke u bërë përpjekje për zhbërjen e strukturave paralele, duke i siguruar komunitetit serb shërbimet e nevojshme: në administratë, arsim, shëndetësi, transport etj..
- Të gjitha format e nxitjes së urrejtjes (në rast se paraqiten) do të dënohen nga udhëheqësit politikë me të gjitha format e mundshme brenda kompetencave, duke përfshirë këtu edhe mediat e shkruara dhe elektronike, si dhe përmes tubimeve të ndryshme.

Sundimi i ligjit

Ligji, dhe të gjitha vendimet dhe rregulloret e miratuara nga Kuvendi i Komunës, zbatohen njësoj ndaj të gjithë qytetarëve, pa marrë parasysh përkatësin etnike, fetare, gjinore etj..

Liria e lëvizjes

Liria e lëvizjes është në nivelin e duhur. Të gjithë qytetarët e komunës së Prishtinës janë të lirë të udhëtojnë, të punojnë dhe të jetojnë të sigurtë, të pafrikësuar prej ndonjë sulmi apo keqtrajtimi, pavarësisht nga përkatësia etnike e tyre.

Të gjithë qytetarët janë të lirë të përdorin gjuhën e tyre, përfshirë këtu edhe vendet publike, është e sigurtë liria e lëvizjes së tyre. Ata shkojnë pa pengesë në vendet e tyre të punës, në shkolla, në tregje, kryejnë shërbimet publike sociale dhe shërbimet komunale.

Në komunën e Prishtinës përcjellja e pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë nga policia është e panevojshme. Gjithashtu, ata e kanë të siguar transportin publik.

Punonjësit publikë, pjesëtarët e komunitetit joshumicë të punësuar në organet e Komunës së Prishtinës, janë në gjendje të punojnë bashkë me pjesëtarët e komunitetit shumicë pa ndonjë vështirësi.

Numri i incidenteve që kanë të bëjnë me lirinë e lëvizjes së pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë në Komunën e Prishtinës, viteve të fundit është shumë i rrallë apo nuk ekziston fare.

Udhëheqësit komunalë pa hezitim do t'i dënojnë aktet eventuale të dhunës ndaj pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë.

Komuna ka siguruar shërbime përkatëse të përkthimit për të gjitha bashkësitë, duke përfshirë përkthimin e të gjitha dokumenteve zyrtare, si dhe përkthimin simultan në gjuhët përkatëse gjatë mbledhjeve zyrtare. Kjo bëhet nga Shërbimi i përkthimeve i Administratës së Përgjithshme.

Kthimi i qëndrueshëm dhe të drejtat e bashkësive dhe te pjesëtareve të tyre

Të gjithë refugjatët dhe të zhvendosurit, të cilët dëshirojnë të kthehen në pronat e tyre në territorin e komunës së Prishtinës, do të jenë të papenguara për tu kthyer dhe këtë mund ta bëjnë pa problem.

Në Komunë ekzistojnë mekanizma përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të komuniteteve, si: zyrtarët komunalë, Zyra komunale për komunitete në Graçanicë dhe komitetet e Kuvendit të Komunës.

Është bërë shpërndarje e drejtë e resurseve komunale për të gjitha komunitetet.

Ekonomia

Të hyrat nga tarifat, ngarkesat dhe gjobat komunale janë duke e mbushur buxhetin e Komunës. Treguesit tregojnë se këto të hyra janë në rritje. Arkëtimi i tyre nga Komuna është duke u bërë pa ndikim politik.

Të drejtat pronësore

Zbatimi i drejtë i të drejtave pronësore është synimi i përhershëm i Komunës për të inkurajuar kthimin, dhe për të siguruar trajtim të barabartë të bashkësive etnike. Është krijuar dhe funksionon regjistri i të drejtave pronësore dhe janë kompletuar incizimet kadastrorë të Komunës.

Trashëgimia kulturore

Trashëgimia kulturore respektohet si trashëgim i të gjitha bashkësive etnike, fetare dhe gjuhësore të qytetarëve të saj.

Të gjitha bashkësitë kanë të dejtë ta ruajnë dhe t'i mbrojnë vendet që janë të rëndësishme për trashëgimin e tyre kulturore, historike dhe fetare, me ndihmën e autoriteteve komunale në pajtim me standardet evropiane.

Bashkëpunimi

Duhet theksuar se Komuna vazhdimisht ka bashkëpunuar me nivelin qendror, sidomos me Ministrinë e Shërbimeve Publikin, Ministrinë e Pushtetit Lokal dhe organizmat tjerë qeveritarë, për të arritur plotësimin e standardeve, obligim ky i përhershëm për ne.

Vizioni i Komunës për të ardhmen

Komuna e Prishtinës ka synim vizionin e saj për një qytet modern, me një infrastrukturë të ndërtuar, me investime të brendshme dhe te jashtme, me perspektivë të qartë për qytetaret e saj, ku komitetet do të jene tërësisht të integruar në jetën socio ekonomike, me një synim të qartë për integrimet e reja në UE, si shoqëri shumëetnike, me kultura të ndryshme që e begatojnë njëra-tjetrën, me një strategji të mirëfilltë të zhvillimit ekonomik, dhe theks të veçantë duhet vënë në integrimet rajonale, ku liria e lëvizjes, idetë dhe kapitalit do të jenë pasuri për të gjithë qytetarët e Prishtinës, të Kosovës dhe të rajonit.

ZYRA LIGJORE

Gjatë periudhës raportuese, Zyra ligjore ka vazhduar me:

- dhënien e këshillave, shërbimeve për sektorë-zyra, drejtori, institucionet komunale, Ekzekutiv, trupat e Kuvendit dhe Kuvndin e Komunës;
- shqyrtimin e të gjitha projektpropozimeve, të cilat i janë dërguar zyrës nga ana e drejtorëve të drejtorive, të drejtorëve të institucioneve arsimore dhe shëndetësore dhe të ndërmarrjeve për miratim në Kuvend;
- shqyrtimin dhe përpilimin e vendimeve lidhur me ankesat e drejtuara kryeshefit të Ekzekutivit nga ana e personave juridikë dhe fizikë. Në punë gjithsej ka pasur 131 ankesë, janë miratuar 15, janë refuzuar 90, për 17 ankesa është dhënë njoftimi, janë bartur në vitin vijues 10 ankesa.
- përpilimin e urdhëresave administrative që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e punëve të organeve administrative, institucioneve dhe ndërmarrjeve;
- përfaqësuesin e saj që ka marrë pjesë aktive në grupin për ndryshime dhe plotësime të Statutit të komunave, në kuadër të MAPL-së dhe OSCE-së, grupin për standarde në Komunë në fillim të vitit; ndërsa nga muaji tetor i vitit edhe në Grupin Punues për Integritet Evropian;
- hartimin e Doracakut: rregulloret komunale, urdhëresat administrative, udhëzimet dhe vendimet, e që janë kompetencë e kuvendeve komunale.

DEPARTAMENTI I PROKURIMIT

Në periudhën raportuese janë realizuar mbi 200 kontrata.

Për operatorët ekonomikë janë dhënë mbi 1600 dosje të tenderit.

Janë pranuar rreth 1200 oferta nga operatorët ekonomikë.

Mbi 600 zyrtarë kanë marrë pjesë në hapjen e ofertave, duke përfaqësuar drejtoratet përkatëse.

Më shumë se 600 zyrtarë të tjerë kanë marrë pjesë në vlerësimin e ofertave, duke përfaqësuar poashtu drejtoritë përkatëse.

Ka ndodhur që persona të njëjtë të marrin pjesë në hapjen e disa tendereve apo në vlerësim, por asnjëherë të njëjtit në hapje dhe vlerësim.

Ofertuesve gjithnjë iu kemi dhënë kopje të raporteve të hapjes së ofertave, konform Ligjit 2003/17.

Gjatë vitit 2006, gjithësej në tri lëndë ka pasur ankesa përmes të KRPP-së, prej të cilave e para nuk ka pasur tri oferta të përgjegjshme, e dyta është kërkuar që të jepet dokument me sasi të mallrave dhe jo me njësi dhe, e treta, zgjidhja është miratuar në të mirë të Komunës.

Projektet e realizuara apo në realizim gjatë vitit 2006		
Sipas drejtorive	Nr. i projekteve	
Ad. e Përgjithshme	36	
Arsimi	47	
Sh. Publike	38	
Zhv. Rural	20	
Shëndetësia	11	
Urbanizmi	7	
Emergjencia	7	
Inspekcioni	4	

Kadastri	2	
Kultura	11	
Sporti	6	
Financa dhe Pronë	2	
Ekonomia	3	
Grajanica	12	
gjithësej	206	

Shumica e këtyre projekteve janë përfunduar.

Gjatë këtij viti mjete janë shpenzuar për një numër të projekteve të vitit të kaluar të cilat nuk janë paraqitur në këtë tabelë.

Poashtu, nuk janë dhënë shumat e furnizimeve apo shërbimeve për disa kontrata afatgjata çmimet e të cilave janë dhënë për njësi.

Nuk janë përfshirë edhe dy kontrata të rëndësishme:

Projekti i Ndërtimit të garazheve me koncesion, rreth 6.000.000 €,

Furnizimi dhe vendosja e 50 qoshqeve, me koncesion, 690.000 €.

Vlera e kontraktuar për furnizime është 25 %



Vlera e kontraktuar për punë dhe shërbime, shumica trajtohen si investime kapitale, është 75 %.

Zyra pritëse

Gjatë periudhës raportuese, në këtë zyrë janë pranuar 26446 kërkesa përmes “intranetit”, 6638 kërkesa janë regjistruar në libër të protokollit, që do të thotë se gjatë vitit 2006 janë pranuar gjithsej 33104 kërkesa. Të njëjtat u janë dërguar organeve komunale për zgjidhje.

Në vijim do të jepet pasqyra tabelare e numrit të kërkesave, mënyra e zgjidhjes së tyre dhe numri i lëndeve që janë në procedurë.

DREJTORITË	Pranuara	Refuzuara	Miratuara	Hedhura poshtë	Kushte Urbanistik	Njoftim	Informim	Përgjigje	Leje ndërtimi	Konkluzë	Të pakryera
1.Administrata:	1603	14	1431	11	-	1	-	-	-	-	137
- Kryetari	152	1	10	-	-	2	2	-	-	-	
- Kryesia	11	-	-	-	-	1	-	-	-	-	
- Ekzekutivi	187	20	42	1	-	12	2	2	-	-	
- Avokatura komunale	4	-	1	-	-	-	-	-	-	-	
- Depart. i prokurimit	496	3	485	-	-	-	-	-	-	-	
- Zyra për marrëdh. me publikun	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	
- Zyra legale - Zyra për kthim	4	-	-	-	-	-	-	-	-	-	
2. Ekonomi	2693	119	2011	3	-	-	-	-	-	-	
3. Shëndetsi dhe Mirqenje Sociale	369	14	177	-	-	154	-	7	-	-	
4. Zhvillim Rural	59	5	5	-	-	43	5	-	-	-	
5. Planifikim, Urbanizëm dhe Ndërtim	834	241	115	-	174	19	131	4	72	13	
6. Arsim dhe Shkencë	333	61	178	-	-	69	22	2	-	-	
7. Kulturë dhe Gjini	119	26	81	-	-	2	-	-	-	-	
8. Mbrojtje Civile dhe Em.	42	-	30	-	-	-	-	2	-	-	
9. Inspektion	3259	1	2622	-	-	292	5	6	-	-	
10. Financa dhe Pronë	1155 8	213	1107 7	80	-	3	-	-	-	-	
11. Kadastër dhe Gjeodezi	3922	4	3874	1	-	1	15	-	-	-	
12. SHPTANT	668	95	273	-	-	283	5	-	-	-	
13. Sport dhe Rini	57	14	33	-	-	6	4	-	-	-	
Gjithsej :	2646 6	831	2244 7	96	174	887	191	23	72	13	



Në bazë të kërkesave të pranuar, e që janë regjistruar në libra, rezulton se:

- Kërkesa për lëshimin e vërtetimeve për mbajtjen e familjes për punëtorët që jetojnë dhe punojnë në botën e jashtme, dhe në ndihmën juridike për qytetarët (rastet sociale, invalidët, etj).....**1019**
- Libri i ekspedicionit në vend**2051**
- Libri i dorëzimit të postës personalisht..... **1385**
- Libri i faturave hyrëse**1392**
- Libri i protokollit (konkurse, D.Z, etj) **791**

Gjithsej : 6638

Zyra për marrëdhënie me publikun

Zyra për marrëdhënie me publikun e njësisë monitoruese, gjatë periudhës janar - dhjetor 2006, ka pasur këtë aktivitet:

- Takime ditore, më së paku 15 shtëpi mediash, të cilat rregullisht raportojnë për aktivitetet e Komunës;
- Përmirësimin dhe plotësimin e “Web-faqes” - ridizajnimi i saj;
- Distribuimi i informatave për mediat – për vendimet e marra, lajmet, ftesat, reagimet dhe kumtesat për opinion, shpalljen e pozicioneve të ndryshme përmes “Web-faqes” zyrtare të Komunës, www.prishtina-komuna.org;
- Organizmi i konferencave për media (elektronike dhe të shkruara), së bashku me kryeshefin e Ekzekutivit, drejtorët e drejtorive etj.;
- Përcjellja e takimeve protokollare të kryetarit, zëvendëskryetarit të Kuvendit të Komunës dhe të mbledhjeve të Bordit të drejtorëve, të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe të mbledhjeve të Kuvendit;
- Përcjellja e përhershme e shtypin ditor, veçon tekstet në faqet e gazetave ku shkruhet për Komunën e Prishtinës. Puna dhe mos puna e organeve të Komunës dhe, në të njëjtën kohë, informon përgjegjësit e atakuar në shkrime dhe, në marrëveshje me ta lëshon reagime dhe sqarime;
- Reagimi me kohë ndaj të gjitha atyre shkrimeve, në të cilat shtrembërohet e vërteta dhe deklaratat e zyrtarëve komunalë;
- Bashkëpunimi me të punësuarit në Shërbimin Civil;

Transparenca e Komunës së Prishtinës me qytetarët e saj është e kënaqshme, por analizat e bëra deri më tani tregojnë se duhet të përmirësohet qasja e saj në shpërndarjen e të dhënave përmes buletinit mujor, krahas metodave tjera që ka siguruar Komuna për transparencë: “Web – faqja”, publikimi i doracakëve etj..

Komuna duhet të shqyrtojë zyrtarisht mundësinë e hartimit të një “Plani masash” për forcimin e transparencës në Komunë, e që publikut do t’i mundësojë monitorimin publik të pajtushmërisë me legjislacionin në fuqi, duke përfshirë ndër të tjera legjislacionin për financat publike dhe përgjegjësitë, prokurorimin, shërbimin civil, qasjen në dokumentet zyrtare, Ligjin mbi ndërtimet, Ligjin për planifikimin hapësinor etj..

Zyrtarja për çështje gjinore dhe mundësi të barabarata

Zyrtarja për çështje gjinore dhe mundësi të barabarta, gjatë vitit 2006, përmes strategjisë së miratuar për vitin 2006, i ka përcaktuar objektivat dhe prioritetet për një respektim dhe zbatim të plotë të të drejtave të njeriut, për të gjitha kategoritë e qytetarëve të komunës, pa dallim gjinie, përkatësie fetare etj., përmes:

- hulumtimit, grumbullimit të të dhënave për problemet me të cilat ballafaqohen;
- statistikave të të punësuarve, në aspektin gjinor: Shërbimi Civil komunal, Arsimi, Shëndetësia.
- rekomandimeve dhe sugjerimeve të dhëna për krijimin e kushteve të barabarta për punësim dhe përfaqësim institucional;
- takimeve me Agjencionin për Barazi Gjinore pranë Zyrës së Kryeministrit;
- bashkëpunimit dhe kooperimit të ndërsjellë me Qendrën për Punë Sociale, Policinë – Njësi të për dhunë familjare rreth shqyrtimit të rasteve;
- kontakteve me OJQ-të lokale dhe ndërkombëtare rreth implemetimit të projekteve të ndryshme;
- pjesëmarrjes në seancat e Komisionit të ankesave;
- takimeve me përfaqësuesit e OSBE-së në fushën e bashkëpunimit dhe përkrahja në shumë projekte.

SEMINARET, TRAJNIMET KONFERENCAT

- Trajnimi i zhvilluar në Ohër prej dt. 30.1.2006 deri më 4.2.2006, “Planifikimi buxhetor, avokim, lobim”.
- Trajnim njëditor të organizuar nga MBPZHR-ja.
- “Konferenca rajonale mbi qeverisjen e mirë”, e organizuar nga Zyra e Kryeministrit për Qeverisje të Mirë, të Drejtat Njerëzore, Mundësitë e Barabarta dhe Çështje Gjinore, UN-HABITAT, ATRC - Qendra e Trajnimeve dhe Resurseve të Avokimit.
- Tryezë e rumbullakët e organizuar nga OSBE-ja, me temën “Roli dhe funksionimi i zyrtarëve për barazi gjinore në komuna”.
- Konferenca me temën “Gratë dhe varfëria”.
- Punëtorja dyditore, organizuar nga Agjencioni për Barazi Gjinore, qëllimi i së cilës ishte hartimi i planit të punës për vitin 2007, mbajtur më 7- 8 nëntor.
- Trajnim njëditor, i organizuar nga IOM-i, me temë “Lufta ndaj trafikimit të qenjeve njerëzore dhe parandalimi i tij”.

Projektet:

- 1 “Të drejtat ekonomike të gruas”,
- 2 “Të drejtat juridike”,
- 3 “Debate me komunitetin”,
- 4 “Ndal dhunën ndaj femrës”,
- 5 “Edukimi i femrave në viset rurale për procesin e zgjedhjeve”.

Zyrtari për kthim

Aktiviteti i zyrtarit për kthim në vitin 2006:

-Takimet me përfaqësuesin e UNMIK-ut për Komunën e Prishtinës;

Janë realizua 30 takime. Ne këto takime është raportuar mbi punën dhe aktivitetet javore të zyrtarëve të Zyrës komunale për kthime, është raportuar për punën e Zyrës së komuniteteve në Graçanicë: infrastrukturën, arsimin, shëndetësinë, çështjet ekonomike, sociale dhe sigurisë në mjediset multietnike dhe çështjet e kthimit.

- Takimet e Grupit komunal punues për kthimet;

Shtatë takime të GPKK-së, në të cilat janë shqyrtuar këto çështje:

- shqyrtimi dhe miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve,
- shqyrtimi dhe miratimi i “Strategjisë komunale të kthimeve 2006”,
- miratimi i Konceptdokumentit të UNIJA/M-it,
- miratimi i projektit për ndërtimin e objekteve të banimit për të kthyerit dhe rastet sociale “P+2” në Graçanicë,
- miratimi i Konceptdokumentit të EP/QK/ZK për “Badovci i Ri II”, dhe disa projekte për infrastrukturë në bashkësitë multietnike,
- është njoftuar lidhur me punën e zyrtarit komunal të kthimeve, me vizitat SHSHV-ve dhe me takimet informative pas vizitave,
- ka shqyrtuar kërkesa, ankesa dhe propozime të përfaqësuesve të shoqatave të të zhvendosurve, të bashkësive multietnike dhe organizatave ndërkombëtare.

- Takimet e zyrtarëve komunalë për kthimeve me zyrtarët e UNHCR-it;

Janë organizua 14 takime, në të cilat janë diskutuar këto çështje:

- kërkesat e komunitetit ashkali dhe rom për sigurimin e lëndëve djegëse për sezonin e dimrit,
- gjendja e të zhvendosurve ashkali dhe rom, banorë të komunës së Prishtinës, të cilët banojnë në Plemetin,
- hartimi i “Draftstrategjisë komunale për kthime 2006”,
- koordinimi i punëve në mes të zyrtarëve për kthime dhe organizatave tjera ndërkombëtare,
- aranzhimi i objektivave të përbashkëta lidhur me të zhvendosurit,
- aktivitetet programore të UNHCR-së për vitin 2006,
- aktiviteti për planifikimin e programit të UNHCR-së për vitin 2007,
- harmonizimi i vlerësimeve dhe propozimeve për hartimin e “Draftstrategjisë komunale për kthime për vitin 2006”.
- formimi dhe funksionimi i nëngrupeve punuese për kthime, paravizitat, vizitat dhe takimet informative pas vizitave.

- Takimet me Komitetin për Komunitete:

Zyrtarët për kthime kanë marrë pjesë në 26 takime të Komitetit për komunitete, në të cilat janë shqyrtua këto çështje:

- shqyrtimi i raporteve të Zyrës së komuniteteve në Graçanicë,
- shqyrtimi i raportit vjetor të punës,
- njoftimi me punën e Zyrës komunale të kthimit,
- shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të pjesëtarëve të komuniteteve, gjendjen e tyre ekonomike dhe sociale,
- objektivat e përbashkëta të kthimit,
- analiza e vizitave që u janë bërë komuniteteve në disa komuna të Kosovës,
- shqyrtimi i raportit të Komitetit për ndërmjetësim,
- vlerësimi i vizitave që u janë bërë institucioneve komunale-shkollave në mjediset multietnike dhe çështjet tjera të përcaktuara me rregullore dhe nga institucionet përkatëse.

- Takimet e zyrtarëve për kthime me përfaqësues të organeve dhe organizatave të ndryshme:

Me përfaqësuesit e UNHCR-së, UNMIK-ut, UNDP-së, OSCE-së, IOM-it, “Mercy Corps”-it, zyrtarë komunalë, MALP-së, MKK-së, QPT-së, KFOR-it dhe SHPK-së.

Zyrtarët për kthime kanë organizua 29 takime, në të cilat janë shqyrtua këto çështje:

- zbatimi i “Strategjisë komunale për kthim”,
- zgjidhja e çështjes së të zhvendosurve të cilët jetojnë në Kampin e Plemetit,
- shqyrtimi i kërkesave për kthim të të zhvendosurve, kushtet e kthimit, procesi i kthimit, ndihmat gjatë kthimit dhe pas kthimit; siguria, adoptimi, rindërtimi dhe lirimi i shtëpive - banesave dhe pronave të uzurpuara,
- kthimi i pjesëtarëve të komuniteteve të cilët jetojnë në shtetet e treta, e të cilët kthehen me dhunë,
- kthimi i familjeve serbe në qytetin e Prishtinës dhe në pjesët rurale,
- shqyrtimi i projekteve-granteve për pjesëtarët e komuniteteve,
- shqyrtimi i kushteve ekonomike, sociale, shëndetësore, arsimore, të banimit në kontejnerë, dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me kthimin në bashkësitë shumetnike.

- Vizitat familjeve të zhvendosura:

Zyrtarët komunalë për kthime kanë vizituar 10 familje të pjesëtarëve të komuniteteve të ndryshme.

- Vizitat e bëra familjeve të kthyer:

Janë vizituar familjet e kthyer të komuniteteve të ndryshme si:

- familja e Shemsedin Kamberit, ashkali, te Stadiumiumi i KF “Prishtina”,
- familjet e komunitetit serb, të cilat jetojnë në qytetin e Prishtinës.

- Nëngrupi punues për kthimin e të zhvendosurve në qytetin e Prishtinës dhe në pjesët rurale, në veri dhe në jug të Prishtinës.

Janë organizua 7 (shtatë) takime të nëngrupeve punuese, në të cilat janë shqyrtuar këto çështje:

- kthimi i të zhvendosurve në qytetin e Prishtinës,
 - kthimi i të zhvendosurve në pjesët rurale,
 - shqyrtimi i evidencës së familjeve të zhvendosura, të cilat kanë kërkuar të kthehen në pronat e tyre në Prishtinë,
 - bashkëpunimi me Habitatin lidhur me lirimimin e pronave të uzurpuara,
 - kthimi i qëndrueshëm dhe procesi i kthimit.
- Nëngrupi punues për shqyrtimin dhe elaborimin e “Draftstrategjisë komunale për kthim”, si dhe shqyrtimin e propozimprojekteve të ndryshme.**

Janë mbajtur 11 takime, në të cilat janë shqyrtua këto çështje:

- elaborimi dhe hartimi i “Draftstrategjisë komunale për kthim 2006”,
- shqyrtimi i projektpropozimit të UNIA/M për hapjen e një përfaqësie në qytetin e Prishtinës, i cili është miratuar nga GPKK-ja,
- elaborimi, shqyrtimi dhe plotësimi i “Konceptdokumentit të MKK-së për ndërtimin e tri ndërtesave të banimit në LLapla-Sellë”.
- elaborimi i “Konceptdokumentit të EP/QK/ZKG për Badovcin e Ri II”.

Trajnimet

Zyrtarët për kthime kanë marrë pjesë në dy trajnime të organizuara nga UNHCR-ja dhe OSCE-ja, dhe në dy komitete të përbashkëta për koordinim.

Kërkesa për kthim:

Kanë kërkuar të kthehen 25 familje, prej tyre: 11 familje të komunitetit serb, 9 familje të kom. rom, 4 familje të kom. ashkali, dhe 1 familje e kom. boshnjak.

Vizitat:

Janë organizua 11 vizita; prej tyre 9 vizita tek të zhvendosurit serbë, 2 vizita të zhvendosurve ashkali dhe rom.

Takimet informative pas vizitave:

Janë organizua 5 takime informative pas vizitave tek të zhvendosurit serbë, ashkali dhe rom në komunën e Prishtinës.

Ndërtimet-adaptimet:

Janë rindërtuar dhe adaptuar 24 shtëpi nga UNHCR-ja dhe UNDP-ja, disa nga to janë në fazë të ndërtimit, nga këto: 9 shtëpi familjeve serbe, 11 shtëpi familjeve ashkali dhe 3 shtëpi familjeve rome.

Kthimet:

Janë kthyer 24 familje të zhvendosura, prej tyre: 9 familje serbe, 11 familje ashkali dhe 4 familje rome.

Auditori i brendshëm

Në pajtueshmëri me autoritetin dhe përgjegjësitë e auditorit të brendshëm, të përcaktuara në kornizat rregullative :

LIGJIN Nr. 2003/2**PËR MENAXHIMIN E FINANCEVE PUBLIKE DHE PËRGJEGJËSITË****Pjesa XI - Komunat****Neni 55**

Zbatimi i këtij ligji në komuna.

RREGULLORJA nr. 2000/45, 11 gusht 2000**MBI VETËQEVERISJEN E KOMUNAVE TË KOSOVËS****KONTROLLI I PAVARUR FINANCIAR****STATUTI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**

Shtojca katër-faqe 4 ,

Procedurat financiare në lidhje me shërbimin publik të Komunës

REVIZIONI FINANCIAR dhe

KORNIZA PUNUESE PËR PRAKTIKAT PROFESIONALE**STANDARDET NDËRKOMBËTARE PËR PRAKTIKAT PROFESIONALE TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM****Ka ushtruar aktivitete audituese me qëllim të:**

1. ofrimit të sigurisë së arsyeshme të sistemit të kontrollit të brendshëm, të themeluar nga menaxhmenti, ka dhënë apo është duke dhënë rezultate në arritjen e objektivave të përgjithshme që konsistojnë me misionin e organizatës buxhetore,
2. ofrimit të një mendimi mbi përshtatshmërinë e sistemit të kontrollit të brendshëm,
3. nxjerrjes së rekomandimeve praktike për t'u përmirësuar aty ku është e nevojshme,
4. sigurimit për implementimit e rekomandimeve të akorduara.

Auditimet e zbatuara**1****Nr. i auditimit 1/2005****NKT-së "Trafiku Urban" në Prishtinë**

BUXHETI, PROKURIMI, SHPENZIMET DHE TË HYRAT

2

Nr. i auditimit 01/2006

Drejtorati i Administratës së Përgjithshme

Shërbimet e transportit zyrtar brenda menaxhmentit të Shërbimit të Transportit në Komunë.

3

Nr. i auditimit 02/2006

Komuna e Prishtinës

Linja Departamenti i prokurimit -Financave

Fondi për investime komunale dhe lokale III (“Operacioni”) MLIF 3

4

Nr. i auditimit 03/2006

Komuna e Prishtinës

Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe i Ndërtimtarisë

- Shërbimet: Planifikimi, Urbanizmi dhe Ndërtimi

Trajnime

Marrja dhe zhvillimi i njohurive audituese nga ofrues ndërkombëtar, duke iu bashkëngjitur ekipit të “Pilotauditimit në Komunën e Mitrovicës”, të mbajtur prej 27.4.2006 deri më 23.6.2006.

ZYRA PËR TEKNOLOGJI INFORMATIVE

Zyra për teknologji informative, gjatë vitit 2006 ka :

- udhëhequr dhe kontrolluar punën e sistemit të teknologjisë informative, me qëllim të zbatimit të standardeve dhe ofrimit të shërbimeve sa më cilësore dhe shpërndarjes së informimit mbi teknologjinë informative,
- mbikëqyrur planin për organizimin dhe funksionimin e sistemit të teknologjisë informative në Komunë,
- ndihmuar në aftësimin e personelit për punë në lëmin e teknologjisë informative,
- vënë kontakte me organizata dhe shoqata të ndryshme, me qëllim të këmbimit të informatave dhe zhvillimit sa më të mirë të teknologjisë informative në Komunë,
- zbatuar politikat e Zyrës për TI,
- bërë mirëmbajtjen e infrastrukturës për internet - intranet, shtrirjen e kablllove, kyçjen e tyre në kabinetet e “switch”-ve, dhe përcaktimi i porteve,
- kryer shërbime “softwerike” dhe “hardwerike”, ndihma për shfrytëzuesit komunalë për zgjidhjen e problemeve:

“Aplikacioni softuerik” për Drejtoratin e Ekonomisë do të kryejë këto funksione:

- regjistrimin e kompanive me të dhënat përkatëse për bizneset e tyre,
- shtypjen e lejeve të punës për bizneset e regjistruara në Komunën e Prishtinës,
- shtypjen e aktvendimeve për licencë të biznesit,
- gjenerimin e raporteve në bazë të fushave të ndryshme të kërkimit,
- dizajnimin e tabelave të tarifave vjetore për ushtrimin e veprimtarive.

Aplikacioni do të integrojë fillimisht edhe të dhënat, të cilat do të jenë në dispozicion nga ana e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, që të mundësojë plotësimin më të shpejtë të tabelave, me shënimet e bizneseve të regjistruara, dhe që shënimet e Komunës të jenë kompatible me ato të MTI-së.

- Përshkrimi teknik i punëve të realizuara për Sektorin e regjistrimit civil (Ofiqarisë)

Duke marr parasysh nevojat dhe kërkesat e Sektorit për regjistrim civil (Ofiqarisë), kemi kryer formatizimin, ruajtjen e të dhënave, instalimin, konfigurimin dhe kyçjen në rrjet të të gjithë kompjuterëve të ofiqarëve që punojnë në ndërtesën e KK-së së Prishtinës. Gjithashtu, për nevojat e Ofiqarisë janë blerë, instaluar dhe konfiguruar:

- server (1 copë),
- printer (8 copë),
- UPS (10 copë).

Realizimi i aktivitetit të mbetur të projektit SKIT: “e-aplikacion”

Në bashkëpunim me UNDP-në, zyra jonë është duke realizuar projektin SKIT: “e-aplikacion”.

- UNDP – projekti SKIT ka marrë përsipër që të ndërtojë - “e aplikacionin” në Komunën e Prishtinës, që do të mundësojë ofrimin e një shërbimi komunal përmes internetit. SKIT do të organizojë trajnimin përdoruesve të “e-aplikacion-it” dhe do të ndihmojë në mënyra tjera, deri në përfundimin e projektit, që pritet të jetë më 31 mars 2007.
- Qëllimi i ndërtimit të “e-aplikacion-it” është që të lehtësojë qasjen e qytetarëve në shërbimet e Komunës, kuptohet, në masën dhe për shërbimet për të cilat kjo është e mundur të bëhet. “E-aplikacioni” duhet të përfitojë nga infrastruktura dhe rezultatet e arritura nga projekti SKIT për t’i dhënë një kuptim të ri dhe për të mundësuar një përdorim edhe më të mirë të asaj që tanimë është ndërtuar.
- Në fillim, “e-aplikacioni” do t’i mundësojë Komunës që të ofrojë (vetëm) një shërbim për qytetarë përmes internetit. Në këtë fazë duhet të provohet se dhënia e shërbimeve komunale përmes internetit, mund të funksionojë në kushtet konkrete, gjë që do të hapte rrugën për zgjerimin e këtij sistemi për të përfshirë më shumë shërbime dhe për t’u zgjeruar në komunat tjera.

I. DREJTORATI I ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

1. Sektori i punëve të përgjithshme dhe juridike

a) Personeli

Personeli i Administratës komunale është angazhuar në kryerjen e punëve, që parashihen me dispozitat e Rregullores nr. 2001/36, për shërbim civil në Kosovë, dispozitat e Urdhresës administrative, nr. 2003/02, për implementimin e Rregullores nr. 2001/36.

Shërbimi civil i Administratës komunale në vitin 2006, është përmbyllur me 611 të punësuar, që, krahasur me vitin paraprak, është për 9 të punësuar me pak. Arsyet janë: 3 (tre) të punësuarëve u

është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të plotësimit të kushteve ligjore – pensionimit, 1 (një) punëtori i është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të shkeljes së kodit të mirësjelljes për shërbyesit civilë, dhe 5 (pesë) shërbyes civilë kanë bërë kërkesë për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me vetdëshirë; ndërsa, me Urdhëresën administrative nr. 2006/8 të MSHP-së është bërë ngrirje për punësimin e shërbyesëve të rinj civilë.

Përkujtojmë se, përkundër nënshkrimit të “Kontratës kolektive” dhe “Anekskontratës” nga: Qeveria, Oda Ekonomike dhe Sindikata, përveç pjesës që ka të bëjë me pushimin e lehonisë, e e cila është e zbatueshme me Vendimin e Kryeministrit nr. 02/201, i dt. 31.5.2006 dhe Udhëzimit administrative nr. 2006/6 të MAPL-së për rregullimin dhe përcaktimin e procedurave të pagesës për pushimin e lehonave në Shërbimin Civil të Kosovës, pjesa tjetër e saj nuk është zbatuar. Moszbatimi i saj, natyrisht se ka shkaktuar vështirësi për personelin dhe pakënaqësi te shërbyesit civilë.

Në vazhdim, në formë tabelare, është dhënë regjistri i të punësuarve: numrin e përgjithshëm, kualifikimet, strukturën etnike dhe strukturën gjinore sipas drejtorive :

Nr. Re n	DREJTORATET	Nr. i përgj	Kualifikimet				Struktura etnike				Struktura gjinore	
			Fak .	Sh ke lart ë	Shk. e mes me	Stafi mbë sht.	Shqi ptar	Se rb	Tu rq	Te tjere	M	F
1.	Drejt. i Administratës	147	15	9	101	22	139	3	5	-	107	40
2.	Drejt. i Inspektionit	64	29	3	32	-	63	-	-	1	46	18
3.	Drejt. i Fin. Dhe i Pronës	59	10	7	41	1	53	6	-	-	40	19
4.	Drejt. i Urbanizmit	31	18	2	10	1	29	-	1	1	14	17
5.	Drejt. i Shërb.Publike	28	9	3	16	-	28	-	-	-	20	8
6.	Drejt. i Shëndetësisë	13	8	-	5	-	13	-	-	-	7	6
7.	Drejt. i Kad. Dhe i Gjeod.	29	4	2	22	1	29	-	-	-	16	13
8.	Drejt. i Ekonomisë	15	10	-	5	-	14	-	1	-	8	7
9.	Drejt. i Ars. Dhe i Shken.	24	21	1	2	-	22	-	1	1	12	12
10.	Drejt. i Zhvill.Rural	8	7	-	1	-	8	-	-	-	5	3
11.	Drejt. i Kultur. Dhe i Gjin.	5	5	-	-	-	5	-	-	-	1	4
12.	Drejt. i Sportit dhe i Rin.	4	4	-	-	-	4	-	-	-	1	3
13.	Drejt. i MCE-së	149	9	10	130	-	122	27	-	-	143	6
14.	Njësia Monit. Me Zyrat	30	19	-	11	-	29	1	-	-	17	13
15.	Kryesia	5	5	-	-	-	4	1	-	-	5	-
	Gjithsej:	611	173	37	376	25	562	38	8	3	442	169

Të punësuarit në institucionet kulturore:

Nr. rend.	Emri i Institucionit	Nr. i përgjith.	F A k.	E l a r t ë	E m e s m e	u l ë t	SH Q I P T A R Ë	S E R B Ë	T U R Q	T Ë T J E R Ë	M	F
1.	Instituti i Monumenteve dhe Muzeu Rajonal i Prishtinës	6	-	-	3	3	6	-	-	-	3	3
2.	Arkivi Historik i Qytetit të Prishtinës	8	-	-	8	-	8	-	-	-	4	4
3.	Biblioteka ndërkomunale "Hivzi Sylejmani" në Prishtinë	15	1	1	13	-	15	-	-	-	7	8
4.	Qendra e Pionerëve Prishtinë	6	1	-	5	-	6	-	-	-	3	3
5.	Teatri "Dodona" Prishtinë	18	3	-	13	2	18	-	-	-	15	3
6.	Shtëpia e Kulturës në Graçanicë	11	1	2	8	-	-	10	-	1	9	2
	Gjithsej:	64	6	3	50	5	53	10	-	1	41	23

Të punësuarit në Zyrën e komuniteteve në Graçanicë:

Nr. rend	Zyra e komuniteteve ne Graçanicë	nr. p e r g j i t h e	s u p e r g j i t h e	l a r t e	m e s m e	e u l e t	sh q i p t a r e	s e r b e	t u r q	te t j e r e	m	f
1.	Zyra e komuniteteve	24	4	3	14	3	-	24	-	-	18	6
	Gjithsej	24	4	3	14	3	-	24	-	-	18	6

b) Byroteknika

Detyrë e përhershme e byroteknikës gjatë periudhës raportuese, ka qenë:

-shumëzimi dhe fotokopjimi i materialeve për të punësuarit në zyra – sektorë, në drejtori, Avokaturën Publike komunale, në trupat ndihmëse të Kuvendit të Komunës.

Pasqyra e kryerjes së punëve:

Nr. rend.	KOMUNA	Nr. i kopjeve	Nr. i risave të shpenzuar
1.	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme	206503	413
2.	Drejtoria e Financave dhe e Pronës	33376	66,5
3.	Drejtoria e Ekonomisë	4576	99
4.	Drejtoria e Planifikimit, Urbanizmit dhe e Ndërtimitarisë	1290	2,5
5.	Drejtoria e Kulturës dhe e Gjinisë	/	/
6.	Drejtoria e SHPTATN-së	/	/
7.	Drejtoria e Zhvillimit Rural dhe e Bujqësisë	6120	12
8.	Drejtoria e Mbrojtjes Civile dhe e Emergjencës	12615	25
9.	Drejtoria e Shëndetësisë	25130	50
10.	Drejtoria e Arsimit dhe e Shkencës	16275	32,5
11.	Drejtoria e Inspektionit	7095	14
12.	Drejtoria e Kadastrit dhe e Gjeodezisë	/	/
13.	Zyra e prokurimit	50457	101
14.	Kuvendi i Komunës	97842	195
15.	Të tjera	2600	5
16.	Avokatura komunale	805	1,5
	Gjithsej	464684	929

2. Sektori për punë të Kuvendit dhe të Bordit të drejtorëve

Për periudhën raportuese është përgatitur materiali për mbajtjen e mbledhjeve:

- Kuvendi i Komunës ka mbajtur 10 mbledhje të rregullta,
- Bordi i drejtorëve ka mbajtur 21 mbledhje,
- Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 10 mbledhje,
- Komiteti për Komunitete ka mbajtur 36 mbledhje,
- Komiteti për Ndërmjetësim ka mbajtur 36 mbledhje,
- Komiteti për Planifikim, Urbanizëm dhe Ndërtim ka mbajtur 8 mbledhje,
- Komisioni për ankesa, peticione dhe kontroll të përgjithshëm, 12 mbledhje,
- Komiteti për Shëndetësi, Mirëqenie Sociale dhe Strehim, ka mbajtur 24 mbledhje,
- Komiteti për Arsim dhe Shkencë, ka mbajtur 24 mbledhje,
- Komiteti për Zhvillim Rural, ka mbajtur 36 mbledhje,
- Komiteti për Shërbime Publike, ka mbajtur 26 mbledhje,
- Komiteti për Kulturë, Rini dhe Sport, ka mbajtur 29 mbledhje,
- Komiteti për Pronë ka mbajtur 24 mbledhje,
- Komiteti komunal për Banim dhe Rindërtim, ka mbajtur 24 mbledhje,
- Grupi komunal për kthim, ka mbajtur 7 mbledhje,
- Këshilli komunal për parandalimin e krimit, ka mbajtur 1 mbledhje dhe
- Janë mbajtur 2(dy) debate - obligative me qytetarë.

Gjatë kësaj periudhe Kuvendi i Komunës ka miratuar :

- 6 (gjashtë) rregullore komunale, në pajtim me dispozitat ligjore, që janë nxjerrë nga Kuvendi i Kosovës dhe janë fuqizuar nga PSSP-ja, dhe ka nxjerrë
- 68 vendime nga kompetencat dhe përgjegjësitë që ka Komuna, përfshirë këtu edhe ndryshimet dhe plotësimet e disa rregulloreve.

3. Sektori teknik

Ky sektor ka zhvilluar aktivitetin e tij në mbështetje të Rregullores mbi organizmin dhe sistematizimin e vendeve të punës. Gjatë kësaj periudhe është punuar në:

- sigurimin dhe mirëmbajtjen e objekteve të Komunës,
- mirëmbajtjen e pajisjeve në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës,
- mirëmbajtjen e ngrohjes qendror – vetanake,
- renovimin e zyrave në autopark,
- kryerjen e punëve teknike për instalimin e aparateve të klimatizimit nëpër zyrat dhe korridorët e zyrave të Sektorit të regjistrimit civil,
- ngjyrosjen e disa zyrave brenda objektit të Komunës, disa zyrave të BL-ve dhe zyrave të vendit,
- kryerjen e punëve teknike rreth regjistrimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve të Komunës,
- mbikëqyrjen për mënyrën e shfrytëzimit të automjeteve të Komunës,
- udhëheqjen e llogarisë mbi shpenzimet e karburanteve nga automjetet gjatë kryerjes së punëve zyrtare - janë hargjuar 73.330 litra karburante për gjithsej 535,180 km. të kaluara,
- sasia e karburantit të hargjuar për funksionimin e gjeneratorit: 5808,36 litra, kurse për ekskavator janë shpenzuar gjithsej 1302 litra.

4. Sektori i bashkësive lokale

Me qëllim të përmbushjes së punëve dhe detyrave që burojnë nga akti individual i organizimit dhe sistematizimit të vendeve të punës, sektori:

- ka bërë përgatitjet për mbajtjen e takimeve të rregullt me kryetarët e bashkësive lokale, me këshillat e BL-ve,
- në bazë të evidencës që ka në dispozicion, ka lëshuar vërtetime nga kompetencat e tij,
- ka bashkëpunuar me këshillat e bashkësive lokale, me komitetet dhe drejtoritë përkatëse, përkitazi me implementimin e projekteve të ndryshme të infrastrukturës,
- ka realizuar projektin për ndërtimin e zyrës së re në BL të Hajvalisë etj..

Si çështje që duhet shtruar në formë të rekomandimit, është nevoja e zgjerimit të kompetencave të këtij sektori, respektivisht referentëve në të gjitha BL-të. Me qëllim të ofrimit të disa shërbimeve sa më afër qytetarit, shtrohet nevoja e pajisjes me vula, ngase problemi është duke u përcjellë edhe nga vitet e kaluara.

5. Sektori i gjendjes civile

Në kuadër të këtij sektori janë kryer këto punë dhe detyra të punës :

- ka vazhduar puna rreth rikonstruktimit të librave amzë,
- janë zgjidhur kërkesat, të cilat kryhen në mbeshtetje të dispozitave të procedurës administrative,
- nga evidenca që mban ky sektor, janë lëshuar certifikata nga libri amzë i të lindurve, i të vdekurve dhe i të kurorëzuarve,
- është bërë formatizimi, ruajtja e të dhënave, instalimi, konfigurimi dhe kyçja në rrjet, i kompjuterëve të ofiqarëve me serverin kryesor, që mundëson punën në programin bazë të të dhënave për lëshimin e certifikatave të reja me nr. serik, në bashkëpunim me Zyrën e teknologjisë informative,
- janë bërë përgatitjet për hapjen e Zyrës së Ofiqarisë në QKU - Klinikën e Gjinekologjisë - Obstetika, pas përpjekjeve të QKU-së dhe drejtorisë.

Në vazhdim të këtij raporti paraqitet pasqyra tabelare e punës së këtij sektori:

- janë regjistruar në librin amzë të të lindurve	10371
- regjistrime të mëvonshme në LAL	18431
- janë regjistruar në librin amzë të të martuarve	1260
- regjistrime të mëvonshme në LAM.....	1200
- regjistrime të reja në librin amzë të të vdekurve	2219
- regjistrime të mëvonshme në LAV.....	574
- regjistrime speciale në LAL.....	689
- regjistrime speciale në LAM.....	95
- regjistrime speciale në LAV.....	29
- certifikata lindjeje.....	2739
- certifikata martese.....	170
- certifikata vdekjeje.....	44

Bazuar në kërkesat e palëve, gjatë periudhës raportuese janë lëshuar:

-certifikata lindjeje.....	36141
-certifikata martese.....	3094
-certifikata vdekjeje.....	2555
-certifikata të statusit martesor.....	3044
-vërtetime – dëshmi se personi është i gjallë.....	873
-deklarata mbi bashkësinë familjare.....	2951
-deklarata të konfirmuara nga dy dëshmitarë.....	45
-vërtetim i kopjeve të dokumenteve	30616

Në procedurë administrative është vendosur për kërkesat:

- ndërrim emri personal (individ - familjar).....	102
- korrigjim emri personal (individ - familjar).....	466
- përmirësim emri personal dhe shënime të tjera.....	782
- regjistrime të mëvonshme në LAL.....	147
- regjistrime në LAV.....	8
- aktvendime lidhur me anulimin e regjistrimeve etj.	2

Për kërkesat e paraqitura, mënyra e vendosjes është:

- kërkesa të miratuara	1492
- kërkesa të refuzuara.....	12
- kërkesa të hudhura	3

Në krahasim me vitin 2005, gjatë vitit raportues, në Sektorin e regjistrimit civil -Ofiqarisë është shënuar rënie sa i përket kërkesave të palëve, përjashtuar këtu kërkesat për deklaratat familjare dhe ato për vërtetimin e kopjeve të dokumenteve, të cilat kanë shënuar rritje.

II. DREJTORATI I EKONOMISË

Kjo drejtori aktivitet e vet e ka orientuar në përgatitjen e harmonizimit të rregulloreve komunale, projekteve që kanë të bëjnë me arritjen e suksesit të këtij organi.

Miratimi i Rregullores për leje të punës për shoqëritë tregtare, ka mundësuar shtimin e të hyrave për buxhetin komunal.

Gjatë kësaj periudhe kohore ka filluar zbatimi i projektit të ri “softwerik” lidhur me procedurat, evidencat, ngarkesat, lëshuarjen e lejeve të punës, të cila kanë rezultuar me azhurimin dhe ngritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara komunitetit të biznesit.

Në të njëjtën periudhë kohore janë lëshuar vendime për shoqëritë tregtare, në bazë të procesverbaleve të hartuara nga kontrollet e bëra nga komisionet mikste të Drejtoratit të Ekonomisë , të Inspekcionit dhe të Drejtoratit të Financave dhe të Pronës.

Numri i përgjithshëm i biznesit në Komunë arrin 11 300, sipas shënimeve të marra nga MTI-ja, dhe numri i të punësuarëve në këto biznese, sipas evidencës së marrë nga Trusti Pensional me seli në Prishtinë, arrin 82 784.

Nga numri i bizneseve të cekura më lart janë inkasuar 434,970.00 €, respektivisht 76,31% të mjeteve të planifikuara për vitin 2006. Në mospërmbushjen në tërësi të këtij zëri buxhetor kanë ndikuar mospërgjegjshmëria e obliguesve për kryerjen e obligimeve ndaj Komunës, rënia ekonomike, numri i vogël i inspektorëve të tregut-lejeve për punë, mospërputhshmëria e adresave të biznesit, si dhe lëshimet tjera administrative dhe procedurale që janë bërë gjatë fazës së regjistrimit të shoqërive tregtare në MTI - Agjencioni për Rexhistrimin e Bizneseve.

Në lëmin e transportit është implementuar vendimi i Kuvendit të Komunës për mosushtrim të veprimtarisë së transportit të udhëtarëve me kombibus-automjete 8+1, si mjet transporti publik, por duke u dhënë mundësi ish-përfituesve të ushtrimit të kësaj veprimtarie, që të jenë përfitues të linjave në territorin e Komunës përmesë themelimit të shoqërive aksionare.

Në sektorin e transportit të udhëtarëve me auto-taksi 4+1 ulëse, janë bërë ndryshime rrënjësore: në caktimin e 600 operuesve fizikë-juridikë për vendosjen e reklamave, duke zbatuar me përpikëri rregulloren e transportit.

Ka bashkëpunuar me Ministrinë e Tregtisë dhe të Industrisë përmes takimeve konsultative, pjesëmarrje edhe në projekte tjera të organizuara në kuadër të MTI-së, siç është: “Projekti i ndihmës për NVM-të sistemi „Voucher””, “Projekt lidhur me dhënien e konsultimeve dhe mbajtjen e trajnimeve për bizneset e vogla” financuar nga BE-ja.

Drejtori i Drejtoratit ka marrë pjesë në përzgjedhjen e 10 (dhjetë) kompanive më të suksesshme në Kosovë, në cilësinë e jurisë profesionale, të emëruar nga ministri i Tregtisë dhe i Industrisë.

Në bashkëpunim me institutin “Riinvest”, i cili është përfitues i projektit në përkrahjen teknike dhe shkencore për përpilimin e “Strategjisë zhvillimore 2007-2011” janë bërë të përgatitjet e nevojshme nga Drejtorati, si dhe i është propozuar Bordit të drejtorëve caktimi i grupit për të punuar në projekt. Janë formuar 6 (gjashtë) grupe punuese nga të punësuarit në drejtori, janë vënë kontaktet me komunitetin e biznesit, Odën Ekonomike të Kosovës, Klubin e Biznesit, Aleancën Kosovare të Biznesit, si dhe me shoqërinë civile.

Realizmi i projektit (i tretë) në bashkëpunim me KFOR-in finlandez. Janë investuar 60.000,00 €. Kompanitë fillestare dhe individët shumë e përfituar e kanë realizuar për blerjen e veglave të nevojshme për fillimin e punës. Motoja e projektit ka qenë përkrahja e të rinjve dhe e gjinisë femërore.

Në bashkëpunim me Zyrën Rajonale të Punësimit dhe Zyrën Rajonale për Trajnime me seli në Prishtinë, ka realizuar projektin “Trajnimi i të rinjve të papunë në ndërmarrësi”. Qëllimi kryesor i këtij projekti ka qenë aftësimi i të rinjve për të filluar biznesin vetanak, si një mundësi reale e vetëpunësimit, duke u ofruar trajnime profesionale nga lëmenjtë e menaxhimit të ndërmarrjeve të vogla, bazat e kontabilitetit financiar, marketingut, hartimit të biznesplanit, si dhe të planit strategjik. Projekti ka zgjatur 36 ditë pune, janë aftësuar 52 pjesëmarrës.

Pjesëmarrja aktive në Grupin konsultativ qeveritar për hartimin e strategjisë zhvillimore të Kosovës 2007-2013.

Në vitin vijues, pas miratimit të “Strategjisë zhvillimore të Prishtinës 2007-2011”, paralelisht do të përgatiten mekanizmat që do të bëjnë të mundur implementimin sa më të suksesshëm të strategjisë përmesë kontrollit dhe raportimeve, duke gjetur format e reja të bashkëpunimit me investitorët vendorë dhe të huaj për realizimin e një mori projektesh, të cilat drejtpërdrejt do të ndikojnë në rritjen ekonomike, si dhe ngritjen e perspektivës në zhvillimin më të hovshëm ekonomik, në mënyrë që kryeqendra e Kosovës, Prishtina, të bëhet një qendër e respektuar në aspektin zhvillimor dhe me një perspektivë të qartë për të ardhmën.

III. DREJTORATI I FINANCAVE DHE I PRONËS

I. SEKTORI I BUXHETIT

Në pajtim me Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendit të punës, puna dhe aktiviteti që ka zhvilluar ky sektor do të përmblihet me sa vijon:

- regjistrimi i pagesave dhe faturave nëpërmjet arkës kryesore,
- nënshkrimi i të gjitha pagesave ditore,
- plotësimi dhe pagesa e CPO-ve, periudha janar – dhjetor 2006,
- regjistrimi i të dhënave në “Akces”, xhirollogaria e rregullt, periudha 3.1.2006-31.12.2006,
- kontimi në xhirollogarinë kryesore, janar-dhjetor 2006 ,
- regjistrimi i të dhënave në “Akces” – Prona, periudha 3.1.2006 - 31.12.2006.
- të tjera (shkuarja në MEF,MSHP,Bankë etj),
- regjistrimi i faturave, janar - dhjetor 2006,
- kontimi i të gjitha CPO-ve ,
- evidencimi në “Free Balance” prej 3.1.2006 –31.12.2006,
- raportet e inkasimit - dorëzimit të kuponave nga inkasantët,
- kontimi i xhirollogarisë së Ppronës, janar-dhjetor 2006,
- kontimi i xhirollogarisë së Arsimit dhe qerdheve, janar- dhjetor 2006,
- kontimi i arkës kryesore, janar-dhjetor 2006,
- kontimi i xhirollogarisë së Shëndetësisë, janar-dhjetor 2006,
- kontimi i xhirollogarisë së participimeve të qytetarëve, sipas evidencimit të të hyrave,
- kontimi i arkës së taksave, janar-dhjetor 2006,
- punë me Komisionin për nivelimin e pagave,
- përgatitja e raportit të shpenzimeve 3,6,9m. dhe vjetor,
- regjistrimi i listës së pagave, janar – dhjetor 2006,
- prezantimi i të dhënave për auditor – “Delloite & Touche” -2002,
- përpilimi i raportit të të hyrave vetanake, janar–dhjetor 2006,
- përpilimi i të hyrave vetanake për vitin 2006 – MEF-it,
- përpilimi i raportit të shpenzimeve për vitin 2006 - MEF-it,
- përpilimi i raportit buxhetor për Arsim & Shëndetësi – 2006,
- pagesa e faturave për kompani të shërbimeve publike të obligimeve të Kuvendit të Komunës,
- pagesat e faturave për Drejtoratin e Arsimit,
- përgatitja e projekteve kapitale buxhetore për vitin 2006 – MEF-it,
- regjistrimi i punëtorëve në programin e pagave,
- ofrimi i të dhënave për palën e tretë.
- planifikimi, përgatitja e formularëve për buxhet, mallra dhe shërbime, shpenzime kapitale dhe subvencione dhe transfero,
- të tjera sipas kërkesës...

II. SEKTORI I PRONËS

Gjatë periudhës raportuese, ka kryer punë dhe detyra të punës nga fushëveprimtaria e tij, si:

- shqyrtimin dhe vendosjen sipas kërkesave të personave fizikë dhe juridikë në procedurën administrative nga lëmi i rregullimit të marrëdhënieve pronëso- juridike në çështjet lidhur me pronën komunale, dhe
- zhvillimin e veprimeve procedurale dhe administrative sipas detyrës zyrtare për ruajtjen e pronës shoqërore dhe interesit tjetër komunal.

a) Vendosja sipas kërkesave

Nga personat fizikë dhe juridikë, me përmbytje kryesisht për deekspropriimin e paluatshmërive të ekspropriuara në bazë të aktvendimeve të ish-organeve komunale për çështje pronësore, apo kompensimin e paluajtshmërive të ekspropriuara sipas atyre vendimeve, ofertat për prioritetin e Komunës për blerjen e paluajtshmërive, kërkesat për caktimin e kufijve të rrugëve publike, kërkesa për përcaktimin e lokacioneve për objekte të interesit të përgjithëshëm, kërkesa për kompensimin e paluajtshmërive në pronësi private dhe kërkesa tjera me përmbytje të ngjashme, si dhe propozime për ekspropriimin apo rregullimin e marrëdhënieve pronëso-ro-juridike, në bazë të vendimeve apo programeve tjera të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Numër i konsiderueshëm i kërkesave në periudhën raportuese në këtë sektor, ka arritur nga Gjykata Komunale, avokati komunal dhe personat fizikë për gjetjen e konkluzioneve përfundimtare, apo shkresave tjera të lëndëve të vendosura në periudhën para vitit '99të.

Numri i kërkesave të arritura për shqyrtim dhe vendosje si dhe zgjidhja e tyre në mënyrë tabelare, do të dukej si më poshtë:

Nr. i kërkesave të arritura gjatë vitit 2006	Gjiths.për punë gjatë vitit 2006	Të miratuara	Të refuzuara	Të bartura në vitin 2007
1290	1290	1213	19	58

Nga numri i lëndëve të paraqitura gjithësejt për punë (kolona 2), 1159 janë lëndë të shqyrtuara në procedurë administrative, sipas ofertave për prioritetin e Komunës në blerje, të cilat janë përfunduar me lëshim vërtetimi përkatës, ndërsa 73 janë kërkesa për deekspropriimin e pronave të paluejtshme të ekspropriuara në bazë të aktvendimeve të ish-organeve komunale apo për realizimin e kompensimit për paluajtshmëritë e ekspropriuara e të pa kompenzuara, për caktimin e kufijve të rrugëve publike, dhe kërkesa të tjera me përmbytje të ngjashme.

Po ashtu, në numrin e këtyre lëndëve janë paraqitur edhe propozimet për eksproprijime dhe rregullim të marrëdhënieve tjera pronësore me qëllim të realizimit të programeve komunale, si dhe kërkesa nga personat fizikë për kompensimin dhe rregullimin e marrëdhënieve pronëso-ro-juridike për pronat e paluajtshme të planifikuara për rrugë publike dhe destinime tjera të intersit të përgjithëshëm me plane rregulluese dhe projekte tjera të rrugëve unazore të qytetit, të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

Në kolonën e katërt të tabelës së dhënë në këtë raport, lëndë të paraqitura si të zgjidhura meritore, pos numrit të lëndëve të paraqitura e të zgjidhura, përkatësisht të përfunduara, me lëshim të vërtetimit përkatës, janë paraqitur edhe lëndët e zgjidhura pa nevojën e nxjerrjes së konkluzionit përfundimtar, por vetëm në formën e përgjigjes me shkrim, apo informacionit përkatës lidhur me përmbytjen e kërkesës, si dhe për inkompetencën e këtij sektori.

Lëndë të paraqitura si të vendosura meritore në kolonën e tabelës në fjalë, janë përshtirë edhe vendosja sipas propozimeve për realizimin e programeve komunale, me të cilat ka qenë e nevojshme zhvillimi i procedurës për ekspropriimin e paluejtshmërive në pronësinë private, kështu që gjatë periudhës raportuese janë nxjerrë tri aktvendime për eksproprijime, me të cilat janë shpronësuar pesë pronarë, dy nga këto aktvendime janë bërë të plotëfuqishme pasi që është arritur marrëveshja për kompensimin e tyre.

Lëndë të paraqitura në procedurë, janë kryesisht lëndët sipas kërkesave për deekspropriime dhe ato për kompensimin e pronave të paluajtshme, të ekspropriuara me vendimet e ish-organeve komunale, për të cilat është e nevojshme që para vendosjes, përkatësisht nxjerrjes së konkluzionit përfundimtar, të gjinden dosjet ekzistuese në origjinale, në mënyrë që të vërtetohet vërtetësia e përmbajtjeve të kërkesave, gjë që në shumicën e rasteve, këto dosje mungojnë pjesërisht apo tërësisht.

Për zgjidhjen e kësaj kategorie të kërkesave, pos vështirësive të përmendura për vendosje të drejtë sipas tyre, pengesë serioze ka qenë edhe mungesa e infrastrukturës së re ligjore, që do të rregullonte këtë çështje dhe kolezioni i dispozitave të Ligjit mbi ekspropriim dhe Ligjit mbi tokën ndërtimore, të cilat rregullojnë çështjen e deekspropriimit dhe kthimit të tokës ish-pronarit.

Po ashtu, lëndë në procedurë janë paraqitur edhe ato të cilat gjatë këtij viti raportues, në bazë të propozimeve është zhvilluar procedura e paraparë ligjore për ekspropriimin e paluejtshmërisë në pronësinë private të dhjetë pronarëve, në kuadër të lokacionit të planifikuar për ndërtimin e shkollës filllore në lagjen “ Mati 1 ” në Prishtinë, si dhe propozimi për rregullimin e marrëdhënieve pronëso- juridike, me qëllim të realizimit të projektit sipas planit rregullues të lagjës “ Qendra-Ulpiana ” në Prishtinë, por për të njejtat ende nuk janë nxjerrë konkluzionet përfundimtare.

b) Veprimet procedurale sipas detyrës zyrtare

Gjatë periudhës raportuese, ky sektor, në kuadër të përgjegjësive të caktuara ligjore, ka krye veprime procedurale edhe sipas detyrës zyrtare, kështu që, në terren ka konstatuar 46 raste të uzurpimeve të pronës publike, në sipërfaqe të përgjithëshme prej 2.97.52 ha, dhe pas marrjes në pyetje dhe përpilimit të procesverbalit përkatës, identifikimit të parcelave kadastrore dhe matjeve në terren, si dhe përshkrimit grafik nga planet gjeodete të sipërfaqës së tokës në pronësi publike të uzurpuar, janë nxjerrë 46 aktvendime, me të cilat janë urdhëruar uzurpuesit për lirim të asaj prone.

Efektet nga dorëzimi i këtyre vendimeve, gjatë kësaj periudhe, kanë qenë lirimi i pronës komunale në 8 raste, në sipërfaqe të përgjithëshme prej 0.61.59 ha, prej tyre 2 raste me procedurën e përmbartimit të dhunshëm të këtyre aktvendimeve.

Nga veprimet tjera, sipas detyrës zyrtare, do të ishte e rëndësishme të përmenden komunikimet zyrtare me AKM-në dhe Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave – Administratën tatimor, për ndikimet në marrëdhëniet pronëso- juridike të paluajtshmërive- tokave të shitura nga këto institucione në aspektin: ish-pronar – komunë- pronarë i ri, si dhe kërkesa dërguar Gjykatës Komunale të Prishtinës, që t’i dërgojë avokatit

komunal dhe kësaj drejtorie, kopjet e të gjitha kontratave mbi shitblerjen e paluajtshmërive të vërtetuara te kjo gjykatë, me qëllim të rrujtjes sa më shumë të pronës dhe interesit të komunës.

b) Vështërsitë dhe pengesat tjera në punën dhe rezultatet e sektorit

Në rezultatet e punës, nga përgjegjësia e sektorit, ndikim vendimtar ka pasur dhe ka:

- mungesa e kuadrit profesional, si nga lëmi juridik ashtu edhe nga ai për gjeodezi;
- mungesa e infrastrukturës së re ligjore, që rregullon çështjet nga përgjegjësia e sektorit;
- kolezioni i dispozitave ligjore ekzistuese të Ligjit mbi ekspropriimet dhe Ligjit mbi tokën ndërtimore, lidhur me nxjerrjen e konkluzionit përfundimtarë gjatë shqyrtimit të kërkesave të personave fizikë për deekspropriime;
- mungesa e bazës juridike dhe planeve gjeodezike origjinale të ndryshimeve në operatin kadastror;
- hyrja në posedim të Komunës në pronat private gjatë realizimit të programeve pa procedurën e shpalljes së interesit të përgjithëshëm të asjë prone, dhe pa zhvillimin e procedurës për shpronësim si dhe
- vështirësi tjera të natyrës objektive, si pengesa nga persona të tretë në terren, e të ngjashme.

Propozimi i masave

Që të jenë të kënaqshme rezultatet e punës nga fushëveprimi i sektorit, është e nevojshme që:

- sektori të forcohet me personelin civil në numër dhe kualifikim të nevojshëm të paraparë me Rregullorën për sistematizimin dhe organizimin e brendshëm të organeve ekzekutive komunale;
- të formohet një njësi organizative në kuadër të Sektorit, e cila do të ndihmojë punën e sektorit për kryerjen e punëve sipas detyrës zyrtare, veçanërisht në konstatimin e uzurpimit të pronës komunale- publike.
- Për formimin e njësisë së propozuar, do të ishte e nevojshme sigurimi i një hapësire për punë-zyreje, ndërsa sigurimi i kuadrit do të mund të oranzohet nga personeli civil brenda Drejtoratit të Financave dhe të Pronës;
- nga prona komunale, e fituar në bazë të kontratave mbi koncesionin, një fond i caktuar i kësaj prone të destinohet për kompensimin e pronave private të ekspropriuara për nevojat e realizimit të programeve komunale të interesit të përgjithshëm;
- me buxhetin komunal të planifikohet një pozicion, nga i cili do të kompensohet prona private e ekspropriuuar për nevojat e përshkruara në pikën III të këtij propozimi;
- në rastet kur ish-pronari është palë në procedurë edhe si investitor, të krijohet mundësia e kompensimit të pronës së ekspropriuuar me lartësitë e llogaritura të kompenzimit për rregullimin e tokës ndërtimore, pasi që në bazë të rregulativës ligjore ekzistuese, nga ky lloj kompensimi krijohet fondi për eksproprijime.

SEKTORI I TAKSËS NË PRONË

Operimi kompjuterik

Gjatë vitit 2006 janë kryer këto punë:

- janë nxjerrë 52080 fatura të tatimit mbi pronën për vitin 2006,
- është bërë regjistrimi i formularëve të pronave-objekteve të reja –raste,
- është marrë raporti për pagesat e tatimit mbi pronën nga bankat komerciale,
- janë regjistruar në kompjuterë pagesat e tatimit mbi pronën, të bëra nga tatimpaguesit 9933 pagesa,
- janë regjistruar të gjitha fletëpagesat e gjobave në komunikacion 38000 gjoba,
- është bërë përmirësimi në kompjuter i zonave dhe i kategorive tatimore 2100 raste,
- është bërë përmirësimi në kompjuterë i adresave (rrugëve) 7700 raste,
- janë regjistruar në kompjuterë aktvendimet sipas ankesave 1966,
- është bërë përmirësimi i gabimeve eventuale teknike në faturat e tatimit mbi pronë, 120 raste,
- janë lëshuar 6266 vërtetime për kryerjen e obligimit tatimor,
- është bërë regjistrimi i formularëve të pronave-objekteve të reja 1800 raste.

Mbledhja e shënimeve:

- Është bërë matja dhe regjistrimi i objekteve të paregjistruara gjatë vitit paraprak në 800 raste.
- Janë reregjistruar objekte banesore , afariste , industriale dhe garazhe gjithsej 600 sosh.
- Është bërë kontrollimi i objekteve në terren, në bazë të ankesave të tatimpaguesve në 900 raste.

Zyra e shpërndarjes së faturave:

- Janë përgatitur dhe sistemuar për shpërndarje 52080 fatura taimore.
- Janë shpërndarë në terren 49900 fatura tatimore.
- Kanë mbetur të pashpërndara 2180 fatura, kryesisht nëpër enklava, dhe si rezultat i problemeve me adresa .
- Janë shpërndarë 19000 letërkujtesa për tatimin në pronë.

Bordi i ankesave:

- Është bërë pranimi i 966 ankesave nga tatimpaguesit.
- Janë shqyrtuar 966 ankesa dhe janë lëshuar aktvendimet ose janë dërguar komisionet në terren për shqyrtimin e këtyre ankesave, ku ka qenë i nevojshëm edhe shikimi i gjendjes.
- Është bërë përcjellja e aktvendimeve për regjistrim në kompjuterë.

Transakcioni në pronë

Gjatë vitit 2006 janë bërë 2991 kërkesa për transaksion të paluajtshmërive, lëndët janë kryer në afatin e caktuar. Janë ekzekutuar 2872 kërkesa, dhe për këtë shërbim janë inkasuar 561.105,00 €, për dallim nga viti i kaluar ku kemi inkasim të 482.388.88 €.

OFERTAT-QARKULLIMI I PALUAJTSHMËRISË

Gjate kësaj periudhe janë paraqitur 1119 kërkesa (oferta për blerjen ose mosblerjen e tokës urbane-rurale, të objekteve të banimit-kolektive apo individuale, të lokaleve afariste, të garazheve etj.). Prej tyre , janë vendosur gjegjësisht janë lëshuar gjithsej 1119 vërtetime, që tregojnë se Komuna nuk është e interesuar për blerjen e paluajtshmërisë të ofruara me oferta përkatëse. Në procedurë kanë mbetur gjithsej 3 kërkesa të pashqyrtuara. Janë inkasuar 3357 € krahasuar me vitin paraprak, ku janë inkasuar 3369 €.

UZURPIME, KËRKESA

Gjatë këtij 6-mujori kanë arritur gjithsej 47 kërkesa, uzurpime të ndryshme.

Lidhur me identifikimin e pronës dhe bisedimin me pronarët e tokave nëpër të cilat kalon ndërtimi i rrugës sipas projektit përkatës, “Përroi i Zatriqit”, prezanton Shemi Shala, i cili deklarohe se nuk e kundërshton këtë, por kërkon që t’i bëhet kompensimi i tokës që i merret me tokë tjetër komunale, përafërsisht të vlerës së njëjtë.

Për ngastrën që i merret parashtron provat me shkrim, kontratën mbi vr.nr.28/98, të dt.6.1.1998, fletën poseduese nr.9480, të dt. 2.4.1998, kopjen e planit dt. 9.6.1997, ndërsa nga gjendja e operatit kadastror, sipas flet. posed. nr.9480, të dt. 1.11.2004, që e siguron gjeodeti i këtijë organi, del se kjo pronë ende evidencohet në emër të Hyrisha Adem Arifit. Andaj, pas konsultimit të bërë me Kryetarin e Komunës, pala udhëzohet që të bëjë bartjen e kësaj ngastre në emër të vet në kadastër, ndërsa Komuna do të shikojë mundësinë për gjetjen e pronës përafërsisht të njëjtë për t’i bërë kompensim me tokë tjetër.

Procedura është në zhvillim e sipër .

KËRKESAT PËR ARKIV

Sipas kërkesave të palëve nga arkivi, është gjetur dokumentacioni i kërkuar për palët: Ramadan Pllana, Shemi Hagjillari, Halit Vokri, për të cilët janë bërë edhe përgjigjet me shkrim dhe janë dorëzuar për nënshkrim. Gani Berisha kont.mbi shitblerjen e banesës.

Regjistrimi i lëndëve është në vijim e sipër.

IV. DREJTORATI I SHËNDETËSISË DHE I MIRËQENIES SOCIALE

Me fillimin e vitit të ri kalendarik 2007, në takim me punëtorët tanë në drejtori, e pastaj edhe me stafin drejtues të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) dhe të Entit për Ndihmë të Shpejtë Mjekësore (ENSHM) në Prishtinë, kemi analizuar në tërësi punën gjatë vitit të kaluar. Është vlerësim i përgjithshëm se e tërë puna gjatë vitit 2006, ka rezultuar me sukses të kënaqshëm. Po ashtu, jemi mobilizuar që viti pasues 2007, të jetë edhe më i suksesshëm se viti paraprak, kuptohet duke e shfrytëzuar edhe përvojën e fituar viteve të më parme. Drejtorati i Shëndetësisë dhe i Mirëqenies Sociale, veprimtarinë e vet e ushtron përmes tre sektorëve; Sektori për shëndetësi, Sektori për shëndet publik dhe Sektori për mirëqenie sociale. Gjithsej janë 13 të punësuar dhe kryejnë punët e tyre me përgjegjësi të duhur. Në mjekësinë parësore të komunës sonë janë gjithsej 871 punëtorë të profileve të ndryshme shëndetësore dhe jo shëndetësore. Edhe pse kjo shifër duket pak sa e madhe krahasuar me numrin e banorëve në komunën tonë, ne kemi mungesë të personelit shëndetësor, por mundësitë buxhetore nuk lejojnë, për momentin, rritjen e numrit të punëtorve shëndetësorë. Shërbimet shëndetësore në mjekësinë parësore ofrohen përmes 10 qendrave të mjekësisë familjare, në 14 ambulanca shëndetësore nëpër viset rurale, në Poliklinikën e Stomatologjisë, në Dispanserin e Sëmundjeve të Mushkërive, në 10 ordianca stomatologjike në shkollat fillore të qytetit të Prishtinës, si dhe përmes Entit të Ndihmës së Shpejtë Mjekësore në Prishtinë. Gjatë vitit kalendarik 2006, kemi arritur që të kemi furnizim të kënaqshëm me barna, material sanitar, karburante, si dhe material tjetër të nevojshëm për ofrimin e shërbimeve shëndetësore cilësore.

Projektet: Në muajt e parë të vitit 2006 kanë vazhduar punët në përfundimin e projekteve në vazhdim nga viti 2005, dhe të atyre të parapara për vitin 2006.

Projektet që kanë vazhduar nga viti 2005 :

- Ndërtimi i QMF-së në lagjen “Kodra e Trimave”.....	34.683,53 €
- Ndërtimi i QMF-së në lagjen “Kalabria”.....	51.744,32 €
- Ndërtimi i Ambulancës shëndetësore në fshatin Llukar	35.201,52 €

Projektet e realizuara gjatë vitit 2006 :

- Ndërtimi i Ambulancës shëndetësore në fshatin Shkabaj.....	20.877,75 €
- Ndërtimi i mbulojës së autoparkut në ENSHM	25.286,33 €
- Rregullimi i Qendrës për Mirëqenien e Gruas	13.090,62 €
- Dezinsektimi hapësinor i Prishtinës 2006	107.369,50 €
- Deratizimi vjeshtor i rrjetit të kanalizimit të Prishtinës	39.146,00 €
- Deratizimi vjeshtor i gar. dhe pod. publike të Prishtinës	34.750,00 €
T o t a l i :	362.149,57 €

Projektet e parapara për vitin 2006 dhe të pa realizuara:

- Ndërtimi i Ambulancës shëndetësore në fshatin Rimanishtë	50.000,00 €
- Rregullimi i oborrit dhe rrethojës në QMF – Kalabri	70.000,00 €
- Rregullimi i oborrit dhe rreth. në QMF në l. “K. e Trimave”	70.000,00 €
- Inventar shënd. për QMF-në në l. “Kalabria” dhe në l. “K. e Trimave”.....	65.000,00 €
- Rregullimi i rrethojës së QMF-së në l. “K. e Diellit”.....	35.000,00 €
- Aparaturë stomatologjike	60.000,00 €
- Aparaturë laboratorike	20.000,00 €

Gjithsej..... 370.000,00 €

Mosrealizimi i këtyre projekteve të parapara është si rezultat i vonesës së alokimeve nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave e Kosovës. Këto mjete financiare, të cilat janë vonuar për alokim, kanë qenë të ardhurat vetanake të Komunës, dhe ministria në fjalë ka paraparë alokimin e këtyre mjeteve muajin e parë të vitit 2007 për tu realizuar projektet. Projektet janë të gatshme dhe tenderimi i këtyre projekteve është bërë në muajin shkurt, dhe do të realizohen më së largu deri në fund të muajt maj 2007.

Sektori për mirëqenie sociale punën dhe aktivitetin e vet i ka zhvilluar në përputhje me planin e punës së sektorit për vitin 2006, dhe konform kompetencave të përcaktuara me aktet normative të Komunës.

Veprimet dhe aktivitetet thelbësore të Sektorit për mirëqenie sociale në periudhen raportuese, mund të klasifikohen me sa vijon:

- pranimi, seleksionimi, shqyrtimi dhe vendosja e kërkesave të palëve drejtuar sektorit,
- ofrimi i shërbimeve cilësore qytetarëve që i drejtohen këtij sektori,
- verifikimi i gjendjes së përgjithshme sociale të familjeve në varfëri ekstreme në komunë.
- kontaktet dhe takimet e ndryshme,
- hartimi i projekteve të nevojshme për sektorë.

Gjatë vitit 2006 këtij sektori iu kanë parashtruar 114 kërkesa, nga të cilat 74 kanë marrë përgjigje pozitive, kurse 49 përgjigje negative.

Janë ndihmuar financiarisht katër shoqata të personave me aftësi të kufizuara me vlerë prej 10.000,00€. Janë ndihmuar 20 familje me gjendje të rëndë sociale, me ushqime në vlerë 50 – 100€. Për festat e fundvitit 2006, sektori ynë ka ndihmuar 200 familje të varfëra me nga 40 € për familje. Poashtu, për festat e fundvitit 2006 sektori ka ndarë nga 100 € për 61 familje të dëshmorve në komunën tonë. Sektori ka bërë përzgjedhjen e 275 fëmijëve të familjeve më të varfëra, për t'u dhuruar nga një dhuratë për Vitin e Ri 2007, donacion nga kompania “Buçaj” e Prishtinës.

Në Shërbimin e strehimit social janë parashtruar 192 kërkesa, prej tyre 40 kërkesa për rindërtim të shtëpive dhe 152 kërkesa për banim social. Janë lëshuar 30 rekomandime për Habitatin. Shërbimi për strehim social një kujdes të veçantë i ka kushtuar përkujdesjes dhe mbikëqyrjes së familjeve të strehuara përkohësisht në lagjen “Fusha e Pajtit” në Prishtinë.

V. DREJTORATI I ARSIMIT DHE I SHKENCËS

Objektivat kryesorë të punës së Drejtoratit të Arsimit dhe të Shkencës, kanë qenë:

- angazhimi për realizimin e projekteve të ndryshme të ndërtimit, rindërtimit dhe meremetimit të objekteve të ndryshme shkollore të komunës së Prishtinës.
- sigurimi dhe plotësimi i kuadrit mësimor dhe mbështetës për vitin shkollor 2005/2006, në bazë të nevojave dhe të kërkesave nga drejtoritë e institucioneve arsimore dhe mbështetja për trajnimin e kuadrit udhëheqës dhe arsimor të institucioneve arsimore nga MASHT-i dhe organet tjera joqeveritare /KEC-i, etj./,
- realizimi i aksionit tradicional “Garat e diturisë” në nivel komunal,
- organizimi dhe realizimi i manifestimit “Garat e recitatorëve” në nivel komunal,
- organizimi dhe mbajtja e manifestimit –“Maturiada e Prishtinës 2006”,
- sigurimi i udhëtimit për nxënësit e kl. IX nga viset rurale dhe të arsimtarëve,
- sigurimi i lëndëve djegëse për sezonin dimëror, me anë të tenderëve të shpallur për dru, qymyr dhe naftë për sigurimin e ngrohjes për objektet shkollore.

Realizimi i këtyre objektivave është bërë nga tri shërbime të veçanta, që veprojnë në kuadër të Drejtoratit të Arsimit dhe të Shkencës, dhe nga stafi menaxhues i kësaj drejtorie.

Ndërtimet dhe meremetimet

Renovimet e ndryshme

Projektet e realizuara:

1. Gëlqerosja e disa objekteve shkollore.....48.730,00 €
 2. Ndërtimi i dritareve dhe ndërtimi i anekseve të zyrave në disa objekte shkollore dhe institucione parashkollore.....146.000,00 €
 3. Renovimet e disa objekteve të shkollave fillore.....8.700,00 €
 4. Renovimet e disa objekteve të shkollave të mesme.....38.000,00 €
 5. Ndërtimi i aneksit të çerdhes së fëmijëve “Gëzimi Ynë”181.833,00 €
- Gjithsej.....423.263.00 €**

Furnizimi i shkollave me inventar142.897,85 €
Furnizimi i shkollave me lëndë djegëse (dru, thëngjill, naftë).....646.999.95. €
-dru:1550 metra kub x35.960 €
-thëngjill:.....435 tonelata x 59.690 €
-naftë:.....648.647 litra:551,349,95 €

Projektet e porealizuara:

1. Ndërtimi i shkolles në lagjen “Vreshtat”750.000,00 €
 2. Ndërtimi i shkollës në “L. e Spitalit”.....650.000,00 €
- Gjithsej.....1.400.000.00 €**

Arsyeja për mosrealizimin e këtyre dy projekteve është mospajtimi i dokumentacionit teknik për tenderim të këtyre projekteve.

Zbatimi i reformës në arsim

Meqenëse në këtë vit shkollos është filluar edhe më klasat VI, VIII, , XII dhe XIII, në kuadër të Drejtoratit është vazhduar edhe më tej me punët për realizimin e reformës në arsim, duke i mbështetur dhe përkrahur nismat për reformat edhe në fushën e arsimit, përmes trajnimeve të ndryshme të arsimtarëve të të gjitha niveleve të arsimit. Në trajnime kanë marrë pjesë gjithnjë edhe një numër i zyrtarëve të arsimit të të gjitha niveleve.

Për sigurimin e kushteve sa më të mira për klasat I, II, III,IV, VI, VII, VIII, X dhe XI, XII, XIII, Drejtorati i Arsimit dhe i Shkencës, në bashkëpunim me MASHT-in, është angazhuar edhe për furnizimin e këtyre shkollave me inventar dhe mjete mësimore të konkretizimit.

Mbikëqyrja e tërë sistemit arsimor komunal

Gjatë vitit kalendarik 2006 është bërë mbikëqyrja e zhvillimit të tërë sistemit arsimor komunal, në të gjitha nivelet, duke filluar nga drejtori me personelin e vet, Shërbimi për punë të përgjithshme administrative dhe Shërbimi i zyrtarëve arsimorë:

Sistemin arsimor të Komunës së Prishtinës e përbëjnë:

Institucionet	Numri	Mësimdhënës	Personeli administrativ	Personeli ndihmës	Gjithsej	Numri i nxënësve		
						Shqip.	Min.	Gjithsej
Parashkolle	09	169	22	100	291	1504	373	1877
Fillore	42	1597	89	283	1969	33250	1522	34772
Të mesme	12	864	43	173	1080	12295	1753	14048
Gjithsej	63	2630	154	556	3340	47049	3648	50697

Gjatë vitit 2006 janë mbajtur 14 mbledhje me drejtorët e institucioneve edukativo-arsimore, në të cilat janë trajtuar çështje të ndryshme për mbarëvajtjen menaxhuese të punës edukativo-arsimore, në të gjitha nivelet e punës edukativo-arsimore, dhe janë dhënë udhëzime të nevojshme për kryerjen e detyrave dhe obligimeve konkrete, në harmoni me trendin zhvillimor të arsimit në komunën e Prishtinës.

Nga drejtori i Drejtoratit të Arsimit dhe të Shkencës dhe shefat e sektorëve, janë bërë mbi 200 vizita me karakter pune në të gjitha institucionet shkollore të komunës së Prishtinës, të nivelit parashkollor, fillor dhe të mesëm.

Shërbimi i zyrtarëve arsimorë

Zyrtarët e Arsimit të komunës së Prishtinës kanë bërë vizita të rregullta, të veçanta e kontrolluese në nëntë drejtoritë e institucionieve parashkollore, në 38 shkollat fillore me mësim në gjuhën shqipe, bashkë edhe me 23 paralele të ndara të tyre, në një shkollë speciale, si edhe në 12 shkolla të mesme.

Vizitat kanë qenë të fokusuar në mbarëvajtjen e procesit mësimor, duke e kontrolluar në tërësi punën edukativo-arsimore me nxënës, vlerësimin e tyre, vijimin e mësimin, masat edukative, procedurën e pranimit të kuadrit mësimor, disiplina në punë, realizimi i planit dhe programit mësimor etj.. Kujdes të veçantë i është kushtuar aplikimit të klasave I, II, III, IV, VI, VII, VIII, X, XI, XII dhe XIII dhe mënyrës së organizimit të procesit mësimor me këto klasa.

Përveç vizitave të rregullta, zyrtarët arsimorë kanë bërë edhe kontrollime të veçanta (50), 43 vizita kontrolluese dhe 54 kontrollime në bazë të ankesave të nxënësve, arsimtarëve, punëtorëve dhe të tjerëve.

Janë bërë edhe 18 vizita informative në shkollat fillore, 12 vizita informative në shkollat e mesme dhe shtatë vizita informative në nëntë drejtoritë e institucionit parashkollor.

Nga zyrtarët arsimorë janë përcjellë punëtoritë dhe seminarët e organizuara nga MASHT-i dhe nga organizatat tjera qeveritare dhe joqeveritare, për aftësimin e kuadrit dhe për realizimin e reformës shkollore.

Administrata

Administrata ka kryer këto detyra dhe shërbime, gjegjësisht ka bërë:

- shpërndarjen e listave të pagave për të gjitha institucionet edukativo-arsimore: parashkollore, fillore dhe të mesme,
- plotësimin dhe shpërndarjen e formularëve të ndryshëm për pagat e arsimtarëve dhe të punëtorëve të tjerë arsimorë,
- pranimin e faturave të ndryshme për shpenzime materiale dhe pagesa të tyre,
- takime pune me zyrtarët e UNMIK-ut lidhur me nevojat e furnizimit të shkollave me lëndë djegëse për sezonin dimëror,
- përpilimin e planit financiar afatmesëm për vitin shkollor 2006/2008, për të gjitha shkollat e komunës së Prishtinës,
- shpërndarjen dhe pranimin e aplikacioneve për vendet e lira të punës, në bazë të kërkesave nga Drejtorati i Arsimit dhe i Shkencës,
- përpilimin e shkresave të ndryshme,
- shtypjen e materialeve të ndryshme.

Shërbimi financiar për mallra dhe shërbime

- Është përpiluar raporti financiar për të gjitha nivelet e institucioneve shkollore dhe parashkollore të komunës së Prishtinës dhe ai u është ofruar të gjitha drejtorive të shkollave.
- Është menaxhuar me buxhetin e Arsimit të Prishtinës.
- Janë mbajtur shënime dhe janë përcjellë të gjitha faturat për shpenzimet (përveç atyre kapitale) e mjeteve financiare për të gjitha shkollat dhe për institucionin parashkollor.
- Janë mbajtur shënime për të hyrat vetanake të shkollave dhe të institucionit parashkollor.
- Është bërë zotimi i mjeteve financiare.
- Organet kompetente komunale dhe të MEF-it, me kohë janë njoftuar me shkrim për problemet me të cilat po ballafaqohet Arsimi i Prishtinës.
- Me organet e lartëshënuara janë mbajtur takime me qëllim të zgjidhjes së këtyre vështirësive.
- Është përpiluar “Propozimplani për buxhetin e Arsimit për vitin 2007”.
- Është përcjellë buxheti për paga të punëtorve të Arsimit.
- Janë marrë masa për largimin nga lista e pagave të gjithë punëtorët e Arsimit (punëtorët e arsimit të minoritetit serb), të cilët kanë realizuar të ardhura në kundërshtim me ligjin.
- Është sistemuar i tërë dokumentacioni i nevojshëm dhe është ruajtur edhe në kompjuterë.
- Janë përpiluar dhe janë plotësuar tabelat për analizën mujore të shpenzimeve .
- Është organizuar transporti për arsimtarë dhe nxënës të klasave të nënta nga qendrat lokale për në Prishtinë dhe anasjelltas.
- Është bashkëpunuar me kontrollin financiar të MEF-it.
- Kemi marrë pjesë në kontrollin financiar të disa shkollave dhe të institucionit parashkollor.
- Është proceduar për tenderim në Zyrën e prokurimit, për furnizimin e shkollave me material higjienik, material për ujë, material elektrik, material didaktik, rekuizita sportive etj..

Mënyrën e inkasimit të mjeteve vetanake të institucionit parashkollor dhe të shkollave që realizojnë mjete nga qiraja ka qenë në mbikëqyrje financiare të Sektorit të shërbimit financiar .

- Janë vizituar dhe është biseduar me njerëzit kompetentë (të ndërmarrjeve, të cilët i kryejnë shërbimet komunale) me qëllim që, eventualisht, një pjesë e borxheve të vjetra të shlyhen ose pagesa e tyre të bëhet me këste.
- Janë kryer edhe shumë punë të tjera, ku vlen të theksohet se bashkëpunimi me organet kompetente financiare të Komunës dhe me ato të MEF-it është në nivel .

Sigurimi i kuadrit mësimor dhe mbështetës

Në bashkëpunim me MASHT-in dhe me drejtoritë e shkollave, pos me konkurse të rregullta, kuadrin edukativo-mësimor dhe mbështetës për të gjitha nivelet e arsimit në komunën e Prishtinës, e kemi siguruar edhe përmes pranimit me zëvendësime.

Problemet me të cilat është ballafaquar ky sektor:

Mungesa e kuadrit të kualifikuar në shkollat fillore, për lëndët mësimore: gjuhë angleze dhe kulturë muzikore, si edhe mungesa e kuadrit arsimor për shkollat e mesme për lëndën e matematikës dhe për lëndët profesionale, si inxhinierë të profileve të ndryshme, etj. Gjendja më e vështirë me kuadër të kualifikuar është në shkollat e fshatrave, sidomos të atyre të largëta në Malësinë e Gollakut, ku është dashur të angazhohjmë personel arsimor të pakualifikuar të vendit. Tani, kur kemi siguruar transportimin e nxënësve nga pothuajse të gjitha vendbanimet rurale, është krijuar mundësia për transportimin e arsimtarëve nga Prishtina në shkollat rurale, me çka shpresojmë se do të përmirësohet struktura kualifikuese e kuadrit arsimor.

Probleme të veçanta na paraqiten me rastin e zëvendësimit të punëtorëve, të cilët shkojnë në pushime mjekësore të shkurtra, p.sh. për një ose dy javë, nga se punëtorët arsimorë që kërkojnë punësim, nuk tregojnë interesim për t'u angazhuar për kohë të shkurtër. Një gjë e tillë krijon vështirësi edhe për futjen e punëtorëve të tillë në sistemin e pagesave. Këto janë reflektuar drejtpërdrejt në çrregullimin e procesit normal edukativo-arsimor.

Mbështetja e trajnimit të kuadrit udhëheqës dhe arsimor

Kujdes i veçantë i është kushtuar edhe trajnimit të kuadrit udhëheqës dhe arsimor, i cili është realizuar në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe të Teknologjisë, në frymën e reformave arsimore që po bëhen në Kosovë.

Gjatë periudhës prill-maj-qershor, por edhe gjatë sezonit veror, e edhe gjatë muajve shtator, tetor, nëntor dhe dhjetor 2006, janë mbajtur seminare për trajnim të arsimtarëve dhe të stafit udhëheqës të shkollave, të udhëhequra nga MASHT-i, e të mbështetura nga Drejtorati komunal i Arsimit, në realizim të KEDP-së dhe të KEC-it.

Seminare për trajnimin e arsimtarëve ka organizuar edhe Shoqata finlandeze për punë me fëmijë me nevoja të veçanta.

Realizimi i “Garave të recitatorëve”, “Garave të diturisë” në nivel komunal dhe “Maturiada e Prishtinës 2006”.

Në kuadër të planit të punës që ka bërë drejtorja, janë realizuar edhe këto aktivitete: “Garat e recitatorëve” , “Garat e diturisë” (në tetë lëndë mësimore) të 35 shkollave fillore, Zgjedhja e nxënësit, paraleles, mësuesit, arsimtarit , profesorit dhe edukatores më të mirë të të gjitha niveleve edukativo-arsimore komunale. Garat e diturisë janë mbajtur më 24. 5. 2006, kurse garat e recitatorëve janë mbajtur më 4 mars – me rastin e festës “Dita e Mësuesit”.

Në vitin shkollor 2005/2006, edhe pse e planifikuar, nuk ka qenë e mundur të organizohet dhe të realizohet manifestimi, tashmë tradicional, “Maturiada Prishtina 2006”, për shkak se të gjitha shkollat e mesme profesionale nuk kishin maturantë, si rrjedhojë e klasës së XIII, në vitin shkollor 2006/2007.

Shpallja e rezultateve, ndarja e diplomave, e mirënjohjeve dhe e dhuratave modeste, është bërë me rastin e 11 Qershorit, “Ditës së Prishtinës”.

Me rastin e kremtimit të “Ditës së Prishtinës”, në bashkëpunim me Shoqatën e Pedagogëve të Kulturës Fizike të Prishtinës, janë organizuar gara sportive në nivel të shkollave fillore dhe të mesme të Prishtinës, në futboll, basketboll, hendboll, tenis dhe atletikë. Finalet e këtyre garave janë zhvilluar me rastin e kremtimit të kësaj feste, dhe më të mirët janë shpërblyer me kupa, medalje dhe diploma.

Gjatë muajit shtator, nga Drejtorati është bërë organizimi dhe realizimi i eskurzionit me maturantët e shkollave të mesme në Shqipëri, si dhe organizimi i eskursioneve të shkollave fillore dhe të mesme nëpër Kosovë.

Pos kësaj, Drejtorati ka mbështetur bashkëpunimin e disa shkollave fillore dhe të mesme, të binjakëzuara me shkollat simotra të Shqipërisë dhe të vendeve tjera evropiane.

Kemi pasur bashkëpunim me OQ-të dhe OJQ-të për realizimin e projekteve të tyre nëpër shkolla. Drejtorati ka bashkëpunuar me organizatat qeveritare dhe joqeveritare për realizimin e projekteve të ndryshme për parandalimin e dukurive negative tek nxënësit, si me Departamentin e të Drejtave të Njeriut, Institutin e Shëndetit Publik të Kosovës, Sektorin për të Drejtat e Fëmijëve, Klubin për të Drejtat e Njeriut “Fëmijët për të Drejtat e Tyre”, Teatrin e të Rinjve të Prishtinës, Qendrën e Pionierëve etj.

Organizimi - përvoja dhe perspektiva

Është bërë edhe organizimi i brendshëm profesional dhe kadrovik në kuadër të Drejtoratit të Arsimit dhe të Shkencës.

Pas miratimit të Ligjit mbi shkollimin fillor dhe të mesëm, kompetencat dhe përgjegjësitë janë më të qartësuara, ndonëse ka vend për koment lidhur me atë se çka është ekskluzivisht kompetencë dhe përgjegjësi e Komunës, e çka e MASHT-it. Disa çështje të cilat nuk janë përkufizuar krejtësisht me igj, rregullohen me udhëzime administrative nga MASHT-i.

Do theksuar veçanërisht për përgjegjësitë dhe kompetencat në relacion MASHT – Zyrë Rajonale – DKA.

Problem në vete ishte edhe mungesa e rregullave, të cilat do të kishin përkufizuar të drejtat, detyrat, obligimet dhe përgjegjësitë e punëtorëve dhe të nxënësve në institucionet arsimore, e sidomos rregullorja mbi disiplinën dhe masat disiplinore ndaj punëtorëve arsimorë, administrativë, si dhe rregullorja për masat disiplinore ndaj nxënësve. Shumë prej këtyre rregulloreve janë përpiluar dhe janë vënë në zbatim.

Kërkohej që në të ardhmen të shtohet angazhimi dhe efikasiteti në procesin e prokurimit për çështje të ngutshme të intervenimeve në sanimin e avarive të ndryshme të sistemit të ngrohjes, sanitarisë, kanalizimit, e të tjera.

Një problem që po manifestohet në praktikë, është mospërkufizimi institucional i përgjegjësive të drejtorëve të shkollave, me që sipas Ligjit për arsimin fillor dhe të mesëm, drejtorët emërohen dhe shkarkohen nga MASHT-i, kurse pagat merren nga Komuna, së bashku me të gjithë punëtorët tjerë arsimorë, kështu që ka neglizhim në kryerjen e detyrave dhe obligimeve të përcaktuara me ligj. Prandaj, është me interes që të përcaktohet më mirë me amandamente ligjore statusi i drejtorëve të shkollave.

Meqenëse jemi në vazhdim të realizimit të reformës në arsim dhe në vitin e ardhshëm shkollor, sipas Ligjit mbi arsimin fillor dhe të mesëm të Kosovës, në nivelin e Arsimit të mesëm të ulët, këtë vit shkollor, sipas reformës, kalon edhe klasa V (e pestë), sipas strukturës 5 + 4 +3, respektivisht + 4, d.m.th. vazhdohej me klasën V. Nga kjo rrjedh se një numër jo i vogël i arsimtarëve të lëndëve të ndryshme, këtë vit shkollor do të mbesin pa normë të plotë, e shumë prej tyre edhe pa normë fare.

VI. DREJTORATI I KULTURËS DHE I GJINISË

“...njeriu me kulturë, ka shpirt të dliër dhe mendje të pasur... “

Drejtorati i Kulturës dhe i Gjinisë, aktivitetin e vet e ka zhvilluar në disa kategori kulturore, disa nga të cilat ishin vazhdimësi e vitit 2005, ndërsa disa tjera ishin vizion i drejtoratit për vitin 2006. Të gjitha këto i kemi sistemuar sipas prioritetëve, duke ardhur në përfundim se investimet kapitale në infrastrukturën kulturore janë parësore dhe të domosdoshme.

- Janë përfunduar punët për renovimin e Teatrit të Rinjve, Fëmijëve dhe Kukullave “DODONA”. Komuna në vitin 2006 ka bërë pajisjen e teatrit me orendi dhe elemente të skenës.
- “Qendra Kulturore dhe Rekreative e Fëmijëve” në parkun e Gërmisë, e cila ishte planifikuar të fillojë së ndërtuari gjatë këtijë viti, për shkaqe të politikës joadekuate të prokurimit nuk u realizua. Megjithatë, arritëm që ta përfundojmë projektin ideor dhe zbatues, kështu që në fillim të vitit 2007 do të fillojnë përgatitjet për fillimin e punimeve.
- Në bashkëpunim me drejtoritë tjera janë bërë përgatitjet e nevojshme, rregullimi i dokumentacionit, pastrimi i terrenit. Në fillim të muajt mars fillojnë punimet për realizimin e

projektit “Renovimi i Arkivit të Qytetit”, donacion i Agjencionit Evropian për Rindërtim, me shumë prej 800.000€, dhe renovimit të Hamamit të Madh, në vlerë prej 14 000 €.

- Prioritet tjetër është rritja e fondit të librit në bibliotekat e Prishtinës. Biblioteka “Hivzi Sulejmani” gjatë vitit, nga Komuna ka fituar 286 tituj të rinj me 926 ekzemplarë, për të cilët janë shpenzuar 5.260,00 €.
- Veprimtaria botuese ka qenë parësore: 13 vepra të reja letrare dhe shkencore për fëmijë dhe të rritur. Vlen të theksohen këto botime: “PËR SHTETIN E DARDANISË”, “ESTETIKA E DE RADËS”, “ANTOLOGJI PËR DRAMATURGI, AKTRIM DHE REGJISURË”, “PRANVERA NË PRISHTINË”, “ÇUNI I KOHËS SË LEKËS”, “PRINCEZA QË FLUTURON”, “ZHVILLIMI I MENDIMIT POZITIV”, “SA ËSHTË ORA”, “SAMI RAQA PERSONALITET I SHQUAR I ARSIMIT”, “STËRGJYSHI SUPERMEN”, “SHKOLLA PËR KULTURËN DHE GJUHËN E ATDHEUT DHE IDENTITETIT KOMBËTAR”, “LUMI LOZONJAR”, “SALLANGJAKU” etj. për çka janë ndarë 10.850,00 €
- Rëndësi të konsiderueshme u kemi kushtuar edhe arteve pamore, duke mbështetur realizimin e gjashtë ekspozitave, kryesisht nga lëmi i pikturës dhe fotografisë, të nivelit kombëtar dhe ndërkombëtar. Sa për ilustrim po përmendim vetëm disa: mr. Saranda Kikaj, mr. Gjevahire Gashi, prof. dr. Nysret Salihmixhiqi, “Gutmorgen Ballkan” (ndërkombëtare), Elvira Shyti, Afrim Spahiu, Afërdita Merovci, Miradie Ramiqi, Zake Prelvukaj, Milaim Janova etj.
- Në kuadër të veprimtarisë filmike, është xhiruar një dokumentar për Prishtinën, me titull “PRISHTINA, PRISHTINA”, me ambicie që do t’i plotësojmë edhe me disa xhirime, që ka pretendime të një dokumentari dhe një filmi për Prishtinën.
- Masovizimi i jetës kulturore artistike në Prishtinë, ishte dhe mbetet objektiv i përhershëm. Në këtë aspekt kemi rezultate të mira, sepse kemi mobilizuar gjashtë shoqëri kulturo-artistike, të cilat me prezantimin e programeve të tyre mjaft cilësore, kanë arritur që të tubojnë rreth vehtës mbi një mijë të rinj dhe të reja. Janë këto: SHKA “Qamili i Vogël”, “Minatori i Ri”, “Malësia e Gollakut”, “Gërçek”, “Teatri i të Rinjëve të Qytetit”, shoqata e rapsodëve “Hivzi Sulejmani”, “Ansambli i UP-së” etj.
- Janë mbështetur të gjitha festivalet e mbajtura në Prishtinë. Të gjitha trupat tona që kanë marrë pjesë në festivale jashtë Prishtinës dhe Kosovës. Vlen të përmenden festivaliet: “RE MUZIKA”, “ROK PËR ROK”, “KAMERFEST”, “YLBERI I PRISHTINËS”, “NEIN ELIVEN”, “NJË JETË”, “HASI JEHON”, “RECITON BILBILI”, “FEST LOJË”, “I KËNDOJMË LIRISË”, “PANAIRI I LIBRIT 2006”, “JAZZ FESTIVALI 2006” “SKENA AP”, etj..
- Për herë të parë, këtë vit kemi filluar që në Prishtinë të sjellim ansamble të muzikës serioze të njohura në botë, siç është “PIERROT LUNAIR”, ANSAMBLI KONTEMPORAN nga Sllovenia, FILHARMONIA E KOSOVËS (prezantimi i veprave monumentale të Fahri Beqirit), etj.
- Janë shënuar të gjitha datat e rëndësishme historike dhe kulturore të Prishtinës 8 Marsi - Dita Ndërkombëtare e Gruas, 1- Qershori – “Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve”, “18 Prilli - Dita e Dëshmorëve të Prishtinës”, 11 Qershori – “Dita e Prishtinës”, “2 Korriku- Dita e Republikës së Kosovës”, 28 Nëntori – “Dita e Flamurit Kombëtar”, 25 Nëntori – “Dita Ndërkombëtare e Dhunës ndaj Gruas”.
- Janë organizuar dy seri programesh muzikore gjatë verës, me titull “PROMENADË VERE”.
- U realizuan nëntë koncerte të muzikës popullore dhe zbavitëse në dy cikle. Ishte konstatimi se ishin të qëlluara për ditët e verës në Prishtinë. Mendojmë se ky lloj programi duhet të shndërrohet në festival të diasporës shqiptare, duke lënë mundësinë e afirmimit të vlerave artistike të qytetarëve tanë jashtë vendit.
- Kujdes i veçantë i është kushtuar edhe afirmimit të kulturës së minoriteteve që jetojnë në Prishtinë dhe rrethinë. Kemi perkrahur aktivitetet e SHKA “GERÇEK”, të minoritetit turk dhe disa aktivitete të minoritetit serb në kuadër të Shtëpisë së Kulturës në Graçanicë. Për këtë kemi marrë edhe një mirënjohje publike nga OSBE-ja me rastin e festave të fundëvitit.

- Jetën kulturore dhe artistike në Prishtinë e kanë begatuar edhe institucionet e kulturës që vepron në Komunë, e që janë nën mbikëqyrjen e Drejtoratit të Kulturës. Biblioteka” Hivzi Sylejmani”, Teatri i Kukullave, Fëmijëve dhe të Rinjve” DODONA” , “Instituti i Monumenteve” dhe “Muzeu i Prishtinës”, “Arkivi i Qytetit të Prishtinës” dhe” Qendra Kulturore e Fëmijëve të Prishtinës”. Të gjitha këto, edhe pse kanë pasur probleme financiare, kanë arritur objektivat e tyre, duke dhënë një shembull të mirë edhe për komunat tjera .
- Një punë e mirë është bërë edhe në Sektorin e çështjeve gjinore. Janë realizuar dhjetë projekte. Do të përmendim vetëm disa: “ZBATIMI I LIGJEVE NË JETËN E PËRDITSHME’ realizuar më OJQ “NORMA”. Ishte ky një trajnim tremujor, që kishte objektiv realizimin e të drejtave të njeriut përmes ligjit, pa marrë parasysh gjininë. ”DITËT E TRASHËGIMISË KULTURORE” , një projekt me një temë shumë aktuale, e cila tërë vitin ishte në agjendat e Ministrisë së Kulturës dhe të strukturave tjera politike. “SHKURORËZIMI ÇELËS I ZGJIDHJES SË PROBLEMIT” , një temë që i kushtohet jetës martesore dhe problemeve që lindin më vonë. “LUFTA KUNDER AIDS-it”, është një projekt tjetër, i cili është gjithnjë aktual dhe i pakalueshëm. Një projekt tjetër që kishte karakter debati, që ishte shumë i suksesshëm, e që veçohet për pjesëmarrje të madhe të të gjitha shkollave të mesme të Prishtinës, dhe me organizim shumë të mirë nga Drejtorati i Kulturës dhe i Gjinisë i Komunës së Prishtinës (bartës i projektit) , OSBE-ja dhe Agjencioni për Çështje Gjinore pranë Zyrës së Kryeministrit.
- Një punë e mirë është bërë edhe në Asamblenë komunale të Fëmijëve, e cila ka arritur që me punën e vet të mobilizojë një pjesë të mirë të fëmijëve të Prishtinës. Duhet përmendur se punët e kryera nga kjo drejtori janë bërë në bashkëpunimin të Drejtoratit me institucionet tjera kulturore, qofshin ato të nivelit qendror, siç janë: ”Teatri Kombëtar”, Ansambli Kombëtar i Këngëve dhe Valleve ”SHOTA”, “Galeria e Arteve”, Ministria e Kulturës, dhe institucionet e nivelit lokal, siç janë: Pallati i Rinisë, OJQ-të për zhvillimin e kulturës teatrale të fëmijëve, koret e fëmijëve të Prishtinës, studiot e ndryshme të baletit dhe dizajnit, mjetet e informimit etj.

VII. DREJTORATI I RINISË DHE I SPORTIT

Në realizimin e politikave programore në tërësi janë respektuar procedurat e bashkëpunimit me Komitetin për Kulturë, Rini dhe Sport dhe drejtoritë tjera komunale.

Në vitin 2006 të gjitha projektet rinore – sportive, kanë pasur përkrahje të nevojshme buxhetore dhe me kohë janë rumbullakuar procedurat financiare. Ka pasur përparim në zhvillimin e aktiviteteve, sepse është ngritur një infrastrukturë e qëndrueshme ligjore në Sport dhe Rini. Është funksionalizuar Ligji për sport dhe janë mbajtur shumë debate dhe tryeza për zhvillimin e plotë shoqëror të rinisë të artikuluar në “Planin Kosovar të Veprimit për Rini në 2007 – 2010”. Bashkëpunimi ynë me institucione sportive dhe rinore të sektorit qeveritar dhe joqeveritar, ka qenë i hapur dhe konstruktiv, gjë që ka ndikuar në thellimin e punës së përbashkët dhe kreativ më të gjithë faktorët relevant në zhvillimin e sportit dhe çështjeve rinore.

Në vazhdim do të japim kahet kryesore të punës tonë të ndarë në sektorë:

a) SEKTORI I SPORTIT

Janë evidencuar 60 klube publike: 17 klube të karatesë, 6 klube të futbollit, 7 klube të pingpongut, 2 klube të hendbollit, 1 klub i basketbollit, 3 klube të shenëjtarisë, 3 klube të notit, 2 klube të mundjes, 2 klube të shahut, 2 klube çiklistike, 3 klube të bodibildingut, fitnesit dhe të aerobikut, 1 klub i boksit, 1 klub i “kick”-boksit, 2 aeroklube, 2 klube të skitarisë, 1 klub i atletikës, 1 klub i xhudos, 1 klub i “tekvandos”, 1 shoqatë për kultivimin dhe mbrojtjen e pëllumbave dhe një shoqatë e peshkatarëve.

Tri klube sportive private – shoqëri aksionare : klubi i futbollit “Prishtina”, klubi i basketbollit “AS-Prishtina” dhe klubi i volejbollit “Mabetex”. Klubet e Prishtinës në të gjitha degët sportive kanë rezultate të konsiderueshme dhe në garat kampionale dhe për kupë, janë vazhdimisht fitues ose janë në pozita të larta kualifikuese. Përkundër faktit se Pallati i Rinisë dhe i Sporteve nuk është në kompetencë të Komunës, falë raporteve të mira me Bordin udhëheqës të Pallatit, është arritur që shumë klube sportive të zhvillojnë stërvitjet dhe garat në Pallatin e Rinisë dhe të Sporteve.

Spektori i sportit ka punuar sipas kriterëve profesionale, për të thelluar dhe ndihmuar punën profesionale dhe organizative të klubeve dhe shoqatave të ndryshme sportive. Këto kriterë kanë qenë të harmonizuara me politikën tona programore, të cilat janë fokusuar në :

- masivizimin e sportit,
- rumbullakimin e organizimit të klubeve, bazuar në ligjin për sport,
- ndërtimin dhe renovimin e infrastrukturës sportive,
- ndërkombëtarizimin e sportit,
- bashkëpunimin me MKRS dhe ÇJR – Departamenti i Sportit,
- organizimin e manifestimeve tradicionale sportive për data të rëndësishme dhe ndihma klubeve sportive publike,
- zhvillimi i sportit për minoritetet,
- integrimi i personave me aftësi të kufizuara në aktivitete sportive,
- zhvillimi i sportit për femra,
- ngritja profesionale e kuadrove sportive dhe begatimi me literaturë profesionale – shkencore nga lëmi i sportit.

Periudha raportuese karakterizohet me investime të konsiderueshme në ndërtimin dhe renovimin e infrastrukturës sportive. Këtu përfshihen punimet për ndërtimin e dy fushave sportive në fshatin Mramuer dhe Grashticë. Aktualisht janë duke vazhduar punët në ndërtimin e fushës universale sportive në Ulpianë. Po ashtu, në partneritet me “CARE – Internacional” dhe komunitetin multietnik shqiptar – shkallë, është ndërtuar fusha universale sportive në lagjen “Kodra e Trimave”.

b) SEKTORI I RINISË

Në bashkëpunim me OJQ-të rinore dhe të rinjtë e Prishtinës, Spektori i rinisë ka nxjerrë politikën programore për vitin 2006. Këto politika pasqyrojnë kahet e punës së përbashkët të Drejtorisë dhe të rinjve të qytetit, për të potencuar dhe ngritur vetëdijen institucionale për angazhimin e të rinjve në të gjitha sferat shoqërore. Gjatë implementimit të projekteve të dobishme për të rinjtë, kemi bashkëpunuar me MKRS – Departamenti i Rinisë , Organizata rinore dhe strukturat tjera institucionale dhe shoqërinë civile, të cilat në programet e tyre kanë punën me të rinjtë. Ndër projektet e shumta të realizuara me të rinjtë, veçojmë : shënimin e “Ditës Ndërkombëtare të të Rinjve” – 12 gusht, administrimin e “SIP – Fondit” për rajonin e Prishtinës - fond i ndarë nga OJQ gjermane “GTZ” dhe përkrah projektet e grupeve të marginalizuara të të rinjve dhe ka karakter rajonal, debatin me të rinjtë e qytetit në temat “Vetëdijesimi i të rinjve mbi ruajtjen e trashëgimisë kulturore”, “Vetëdijesimi i të rinjve kundër trafikimit të qenieve njerëzore”, “Luftimi i dukurive devijuese ndër të rinjtë”. Në këtë vit puna profesionale në Spektorin e rinisë, më shumë është vërejtur në projektin “Muaji i Rinisë 2006”, i cili është tradicional dhe përfshinë aktivitete rinore njëmuajore në të gjitha komunat e Kosovës, dhe realizohet në bashkëpunim me MKRS - Departamentin e Rinisë. Ky projekt në Prishtinë manifestohet me promovim dhe prezantim të punës së OJQ-ve rinore dhe sensibilizon opinionin për përkujdesje më të madhe ndaj vlerave dhe problemeve, të cilat preokupojnë rininë e qytetit tonë. Drejtoria e Rinisë dhe e Sportit ka arritur që në tërësi të angazhojë potencialin e madh kreativ të rinisë së Prishtinës dhe, për këtë qëllim nga MKRS-ja është shpërblyer me vendin e dytë.

Në Sektorin e rinisë politikat programore në përgjithësi janë të përmbledhura në :

- Promovimin e vullnetarizmit;
- Integrimin e grupeve të marginalizuara të të rinjve;
- Fuqizimin e organizatave rinore – rrjetet rinore, qendrat rinore dhe OJQ-të rinore;
- Ndërtimi dhe renovimi i hapësirave për zhvillimin e aktiviteteve rinore;
- Luftimi i dukurive devijuese ndër të rinj dhe lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

Buxheti i Drejtorisë për vitin 2006 është shpenzuar për ndërtimin dhe renovimin e infrastrukturës sportive, mbështetjen financiare të klubeve sportive dhe të OJQ-ve rinore, dhe mbajtjen e aktiviteteve tradicionale të sportit dhe rinisë. Projektet të cilat janë realizuar financiarisht nga Drejtoria e Rinisë dhe e Sportit janë:

1. Projektimi dhe ndërtimi i terreneve sportive në:

Ulpianë, Mramuer, Grashticë dhe në fshatin Bardhosh.....	169.550 €
2. Organizimi i aktiviteteve sportive-rinore për “Ditën e Prishtinës 2006”	9.340 €
3. Realizimi i projektit tradicional për të rinj “Muaji i Rinisë 2006”	9.660 €
4. Përkrahje 30 klubeve sportive -publike të komunës me mjete financiare	41.300 €
5. Turneu tradicional i shahut “Hyzri Talla” dhe shpallja e sportistëve më të mirë të komunës	9.500 €
6. Realizimi i projekteve për të rinj.....	5.000 €
7. Turneu në futboll të vogël “Dita e Flamurit 2006” dhe organizimi i garave sportive për persona me aftësi të kufizuar në kuadër të Olimpiadës speciale.....	1.700 €
8. Organizimi ligave shkollore në sporte të ndryshme, në bashkëpunim me Shoqatën e Pedagogëve të Kulturës Fizike	1.000 €
9. Gjysmëmaratona në atletikë “Prishtina 2006 “	1.000 €

VIII. DREJTORATI I PLANIFIKIMIT, URBANIZMIT DHE I NDËRTIMTARISË

I. SEKTORI I PLANIFIKIMIT

Punët dhe detyrat nga përgjegjësjia e caktuar në aspektin e planifikimit, i ka përqëndruar kryesisht në:

1. Përgatitjen dhe hartimin e planeve të reja rregulluese;
2. Realizimin e planeve të miratuara;
3. Caktimin e lokacioneve për komplekse dhe objekte të natyrave të ndryshme;
4. Përpilimin dhe lëshimin e lejeve urbane sipas kërkesave.

1. Përgatitja dhe hartimin i planeve të reja rregulluese

Sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-35-2427, të dt. 10.9.2004, prioritet i është dhënë hartimit të këtyre projekteve dhe planeve rregulluese:

- “Mati 3”, me një sipërfaqe prej.....	40.00 ha
- “Sofalia”,	250.00 ha
- “Lakërishta”,	52.35 ha
- “Dardania”	52.00 ha
- “Lagjja e Muhaxhirëve”	60.00 ha

Gjithsej:

454.35 ha

Me planet rregulluese të miratuara deri më tani është mbuluar një sipërfaqe prej 633.05 ha, e cila me miratimin e planeve të reja do të rritet në 1047.40 ha .

Ka filluar hartimi i planeve rregulluese për lagjet “Sofali “dhe “Lakërishta”, ndërsa hartimi i planeve rregulluese për lagjet “Dardani” dhe “Lgjja e Muhaxhirëve” do të bartet në vitin 2007.

Janë hartuar projekte në bazë të të cilave është shpallur tenderi dhe janë përzgjedhur fituesit – hartuesit e planeve rregulluese:

- “Sofali”.....”Hidroing”
- “Lakërishtja”.....” CMA”

Plani rregullues “Mati 3”, me një sipërfaqe prej 42.95 ha, i destinuar kryesisht për banim individual dhe me përmbajtje tjera përcjellëse. Është punuar nga stafi i Drejtoratit, ka kaluar edhe në fazën e diskutimit publik dhe pritet të miratohet në fillim të vitit vijues.

Kuvendi i Komunës ka miratuar edhe dy propozime të Drejtoratit, gjegjësisht ka miratuar vendimet për fillimin e hartimit të planeve rregulluese: “Qyteti i vjetër”, me sipërfaqe prej 26.00 ha dhe “Prishtina e re”, me sipërfaqe prej 800.00 ha, të cilat do të hartohen gjatë vitit 2007.

2. Realizimi - zbatimi i planeve rregulluese të miratuara

Nga planet rregulluese të miratuara vitin e kaluar raportues, është filluar me realizimin e tyre duke miratuar zgjidhjet urbane të blloqeve brenda këtyre planeve, sipas kërkesave të investitorëve, gjegjësisht pronarëve të tokave. Mund të veçojmë p.sh. në “Dodonë” janë lëshuar 10 leje urbanistike dhe mbi 19 të tjera janë në procedurë. Në planet tjera rregulluese ka filluar një praktikë e re, ku fillimisht janë miratuar zgjidhjet urbane të blloqeve, e më pas janë lëshuar lejet urbanistike dhe ka vazhduar procedura me projektet ideore deri te lëshimi i lejes ndërtimore.

Gjatë periudhës kohore deri te pranimi i zgjidhjes urbane, janë organizuar takime dhe debate me qytetarë, gjegjësisht me pronarët e ngastrave katastrore të blloqeve përkatëse urbane.

- Në lagjen “Kalabria” janë lëshuar 3 leje urbanistike, 2 në procedurë,
- Në lagjen “Arbëria 3” janë lëshuar 4 leje urbanistike dhe 3 janë në procedurë, dhe
- Në lagjen “Mati 1” janë lëshuar 4 leje urbanistike dhe 3 në procedurë.

Me qëllim të realizimit të planeve rregulluese, aty ku kryesisht kemi të bëjmë me prona komunale, Drejtorati i PUN-së ka propozuar, dhe Kuvendi i Komunës e ka miratuar Vendimin për dhënien e tokës për ndërtim me koncesion.

Drejtorati është duke punuar në përpilimin e detyrave për realizimin e komplekseve kapitale përmes koncesionit, për lokacionet në vijim:

- qendra tregtare afariste banesore “ Qendra 2”,
- garazhi publik para Fak. Filozofik “Qendra 2”.
- sheshi “qendra 1” (garazh me qendër tregtare dhe rruga lidhëse),
- kompleksi “Qendra 1”,
- Pallati i Rinisë (garazh, q. tregtare, pishina rekreative me përmbajtje përcjellëse),
- “Kinemaja “– Kodra e Diellit,
- “Qendra tregtare” në lokacionet në “Kalabri”, sipas pl. Rregullues,
- “Qendra tregtare” në Kodrën e Diellit.

3. Caktimi i lokacioneve për komplekse dhe objekte të karakterit të ndryshëm

Duke kryer incizimet në terren, definimin e pronës të atyre lokacioneve, janë përgatitur prezantimet grafike, në bazë të të cilave janë përgatitur propozimvendimet me arsyetimet përkatëse, të cilat janë prezentuar për shqyrtim në Bordin e drejtorëve, Komitetin për Planifikim, Komitetin për Politikë dhe Financa dhe në Kuvendin e Komunës.

Lokacionet e përcaktuara gjatë periudhës raportuese:

- lokacioni për ndërtimin e objekteve të tërësisë së përbashkët (kolektive) në fshatin Graçanicë,
- lokacioni për vendosjen e objektit me karakter të përkohshëm për nevojat e Shërbimit Policor të Kosovës.
- lokacioni për vendosjen e antenës me pajisje të nevojshme përcjellëse për nevojat e PTK-së, në Gërmi,
- lokacioni për vendosjen e antenës me pajisje të nevojshme përcjellëse për nevojat e “IPKO-NET”-it, në Gërmi,
- vendimi për caktimin e lokacioneve për vendosjen e qoshqeve (20 sosh),
- lokacioni për ndërtimin e objektit të banimit për rastet sociale – Fusha e Pajtitimit,
- caktimi i lokacionit për Qendrën e Zjarrfikësve,
- vendim për caktimin e lokacionit për varrezat në Bardhosh,
- lokacioni për Qendrën Kulturore-Rekreative në Gërmi, për fëmijët e moshës 6- 15 vjeçar,
- ndryshimi dhe plotësimi i vendimit të lokacionit të QMF-së në Kalabri.

Përgatitja e materialeve, detyrave dhe programeve projektuese për hapjen e tendereve.

Për lokacionet e caktuara për ndërtimin e objekteve për të cilat ka qenë investitor Komuna, janë përgatitur materialet, detyrat dhe programet projektuese për hapjen e tendereve, personeli i DPUN-së ka marrë pjesë në Komisionet për vlerësimin e dokumentacionit të ofertave, si dhe ka bërë mbikëqyrjen e realizimit – ndërtimit të këtyre objekteve.

4. Përpilimin dhe lëshimin e lejeve urbanistike sipas kërkesave

Gjatë periudhës raportuese janë kryer punë të rregullta në përgatitjen e lejeve urbane për objekte brenda planeve rregulluese, kryesisht për objekte kolektive, si dhe në hapësirat tjera për objekte individuale, shndërrimin e hapësirave banesore në ato afariste dhe objekte të tjera, duke u bazuar në dispozitat e ligjeve në fuqi dhe rregulloreve nga lëmi i ndërtimit.

II. SEKTORI I URBANIZMIT

ZGJIDHJA E KËRKESAVE TË PERSONAVE FIZIKË DHE JURIDIKË

Gjatë periudhës raportuese, kësaj drejtorie i kanë arritur 862 kërkesa, ndërsa të bartura nga viti paraprak kanë qenë 36 kërkesa, nga rezulton se kanë qenë për punë 898 kërkesa, zgjidhja e të cilave bie në përgjegjësinë e kësaj drejtorie.

Përmbajtja e kërkesave kryesisht ka qenë: caktimi i lokacioneve, lëshimi i lejeve urbanistike për caktimin e kushteve urbanistiko-teknike, lejeve ndërtimore, vendosja e objekteve të përkohshme, informacione për destinimet e sipërfaqeve në planet përkatëse urbanistike, caktimi i dispozitave sipas planeve detale, për rrënimin e objekteve ekzistuese, lëshimin e vërtetimeve për dëme të shkaktuara nga lufta, ndërrimin e destinimit të përdorimit të objekteve ekzistuese prej banesore në afariste, si dhe kërkesa për informacione tjera mbi kushtet për rregullimin e hapësirës, kërkesa dhe kundërshtime me përmbajtje të ngjashme.

Zgjidhja e kërkesave në shumicën e rasteve është bërë në bazë të konkluzioneve përfundimtare, ndërsa për një pjesë të tyre nuk ka qenë e nevojshme të nxirret konkluzion përfundimtar, por të njejtat janë vendosur në bazë të informacioneve, përgjigjeve apo lëshimit të vërtetimeve të kërkuara.

Në mënyrë tabelare duket si më poshtë:

PASQYRA E RAPORTIT TË LËNDËVE SIPAS NUMRIT												
Drejtoria për planifikim,urbanizëm dhe ndërtimtar												
NR	Përshkrimi për Lëndën	Të bartura nga viti iparaprak	Numri i lendeve të vitit vijues	Gjithsejt numri i lëndëve	Të miratuara pozitivisht		Të Refuzuara	Në Procedurë	Shkala e dytë	Informime	Saktësia	Shuma
					Leje Urbanistike	Konkluza						
1	Leje Urbanistike	11	469	480	106	17	173	33	45	106	TRUE	480
2	Kushte të Lokacionit	7	137	144	76	26	20	13	0	9	TRUE	144
3	Leje ndertimore	9	107	116	76	0	4	13	2	21	TRUE	116
4	te tjera	9	149	158	1	30	11	17	5	94	TRUE	158
	Gjithsejt	36	862	898	259	73	208	76	52	230	TRUE	898

a.Mënyra e vendosjes sipas kërkesave

Zgjidhja sipas kërkesave për lëshimin e lejeve urbanistike, me të cilat caktohen kushtet urbanistike-teknike dhe lejimi i ndërtimeve, është bërë sipas planeve përkatëse rregulluese, urbanistike dhe në formë të rikonstruktimit të objekteve ekzistuese me zgjerime minimale nga shkak se, në shumicën e rasteve, hapësirat ku është kërkuar lejimi i ndërtimit, në bazë të Planit strtegjik-zhvillimi urban i Prishtinës kanë pasë destinimin e banimit, por, për këto hapësira, në momentin e vendosjes së kërkesave kanë munguar planet rregulluese.

Pas miratimit të planeve rregulluese për disa lagje të qytetit, për këtë kategori të kërkesave është vendosur në bazë të destinimeve dhe përmbajtjeve të planifikuara me këto plane me lëshimin e lejeve urbanistike, dhe në formën e kushteve për zgjedhjen e projektit ideor të blloqeve urbane brenda kufijve të planeve rregulluese. Vendosja e kërkesave për lejimin e ndërtimit të destinimit të sipërfaqëve banesore në hapësira afariste, si dhe kërkesave për përligjen e këtyre veprimeve, është bërë në bazë të kritereve të përcaktuara me Vendimin e Kuvendit të Komunës nr. 01-35-2425, të dt. 10.9.2004.

b.Arsyet kryesore për refuzimin e kërkesave

Gjatë shqyrtimit të kërkesave, arsye kryesore për nxjerrjen e konkluzionit për refuzimin e tyre ka qenë: çështja pronësoro-juridike e pazgjidhur në tokën apo hapësirën ku është kërkuar lejimi i ndërtimit, sipërfaqet në të cilat është kërkuar lejimi i ndërtimit, sipas PU kanë pasur destinim tjetër nga ai i kërkuari, si dhe nga arsyeja e qasjes së programeve komunale për nxjerrjen e planeve rregulluese, përkatësisht mungesa e këtij niveli të planeve, kërkesat për lejimin e ndërtimeve jashtë kufijve të fshatrave, përkatësisht në tokën bujqësore ose në afërsi të rrugëve magjistrale, hekurudhore dhe rrugëve tjera, kërkesat për lejimin e ndërtimit të destinimit të hapësirave në objektet banesore (kolektive), për të cilat nuk është argumentuar e drejta pronësore e kërkuarve në ato hapësira, si dhe ato të cilave nuk ka mundur t'iu ndërrohet destinomi, pa ndërhyrje me punë ndërtimore në konstruksion të objektit si tërësi, dhe pamundësisë së shfrytëzimit të qasjeve ekzistuese, si dhe ndikimet negative në stabilitetin dhe aspektin urban të objektit në tërësi, kërkesa për vendosjen e objekteve të përkohshme në sipërfaqe publike, pa provën mbi të drejtën e shfrytëzimit të asaj sipërfaqeje.

Dukuri tjetër e shpeshtë, e cila ka ndikuar në marrjen e konkluzionit për refuzimin e kërkesave, ka qenë se kërkesat për lëshimin e lejeve urbanistike, për caktimin e kushteve urbanistiko-teknike dhe për lejimin e ndërtimit, janë paraqitur pas përfundimit të zhvillimit të punimeve ndërtimore, apo pas kryerjes së punëve të konsiderueshme, të cilat kanë qenë në kundërshtim me lejen urbanistike të lëshuar nga kjo drejtori, gjë që është konstatuar gjatë shqyrtimit të kërkesave, e në procedurën e daljes në vendëshikim. Në këtë mënyrë drejtorja, konform rregullativës ligjore në fuqi, këto kërkesa i ka refuzuar me arsyetim se janë zhvilluar punimet ndërtimore, pa u caktuar kushtet urbanistike-teknike dhe pa u pajisur me lejen e ndërtimit.

c. Kërkesat e miratuara dhe ato në procedurë

Në numrin e kërkesave të paraqitura si të miratuara, është paraqitur numri i lejeve urbanistike mbi caktimin e kushteve urbanistiko-teknike, lejet ndërtimore, pëlqimet me të cilat është lejuar zhvillimi i punimeve ndërtimore, të cilat nuk kanë ndryshuar projektin e objektit ekzistues; përkatësisht punët të cilat komform me rregullativën ligjore, nuk janë trajtuar ndërtim dhe as rikonstruktiv, si dhe konkluzionet tjera me të cilat është zgjidhur

çështja, pa qenë e domosdoshme të nxirret vendim i veçantë, e të cilat janë zgjidhur në të mirë të kërkuarve, propozimvendimet për caktimin e lokacionit të miratuara nga Kuvendi i Komunës, lëshimi i vërtetimeve mbi shkallën e dëmtimit nga pasojat e luftës, si dhe kërkesat tjera të ngjashme në të mirë të palëve.

Në numrin e lëndëve të paraqitura në procedurë, pos lëndëve për të cilat është kërkuar plotësimi i tyre, janë edhe ato të cilat kanë arritur në gjysmën e dytë të muajit dhjetor të vitit raportues.

d. Dhënia e informacioneve dhe vërtetimeve për dëmtimet e objekteve si pasojë e luftës

Janë lëshuar 38 vërtetime për shkallën e dëmtimit të objekteve nga efektet e luftës, 2 kopje dokumentacioni që shfrytëzohen për rregullimin e çështjeve personale pranë gjykatave, 4 kërkesa janë refuzuar si të pabaza, kurse një (1) lëndë i është përcjellë Drejtoratit të Shëndetësisë dhe Politikës Sociale.

III. SEKTORI I NDËRTIMIT

Sektori i ndërtimit ka kryer këto punë:

- Planifikimi – projektimi i projekteve të infrastrukturës;
- Mbikëqyrja e objekteve për të cilat investues ishte Kuvendi i Komunës;
- Pjesëmarrje në pranimet teknike të objekteve dhe punimeve të kryera;
- Pjesëmarrje në komisionet për vlerësimin e tenderëve;
- Përgjigje në lëndët që kanë të bëjnë me infrastrukturë dhe rindërtim;
- Pjesëmarrje në komisionet-ekipet e ekspertëve të caktuar nga Bordi i drejtorve;
- Përgatitja e vendimeve të komisioneve për pranim teknik dhe leje të përdorimit;
- Kontrollimi i projekteve që dorëzohen për leje të ndërtimit (pjesa e stabilitetit dhe instalimeve).

a. Planifikimi – projektimi i projekteve të infrastrukturës

Rrugët e qytetit:

Janë vizituar dhe fotografuar rrugët, të cilat janë caktuar si prioritet për ndërtim nga ana e Drejtoratit të Shërbimeve Publike, Transportit, Mbrojtjes së Ambientit dhe Tokës Ndërtimore dhe Drejtoratit të Zhvillimit Rural, janë përgatitur projektet dhe janë përcjellë punimet e projekteve për rrugët:

- Rruga “Vëllezërit Fazliu; “
- Rruga: Besi- Rimanishtë;
- Rrugët brenda lagjes “Prugovc” dhe “Vranidoll”;
- Rruga nga “Fshati ndërkombëtar” deri te Xhamia në Hajvali;
- Rruga Keqekollë- Ballaban;
- Përgatitja e vendimeve për komitete dhe Kuvend për vazhdimin e rrugëve;
- Rrugën: ” Bajram Kelmendi”;
- Rr. “Muharrem Fejza” dhe rr. “Agim Ramadani “, të cilat lidhen me rrugën “B” të planifikuar në “MATI 1”;
- Rruga “Rrustem Statovci”;
- Për rr. “Enver Maloku”;
- Rruga Prishtinë - Fushë-Kosovë;

b. Mbikëqyrja e objekteve për të cilat ishte investues Kuvendi i Komunës

- Mbikëqyrja e çerdhes "Gëzimi Ynë" në Ulpianë; ky objekt është mbikëqyr në bashkëpunim me DASHK të KK të Prishtinës;
- Mbikëqyrja e terrenit sportiv "Ulpian";
- Mbikëqyrja e murit mbrojtës në "Ulpianë";
- Mbikëqyrja e terrenit sportiv në fshatin Hajvali;
- Mbikëqyrja e punimeve të kanalizimit në fshatin Drenoc;
- Mbikëqyrja e punimeve të kanalizimit në fshatin Besi;
- Mbikëqyrja e pun. të kanalizimit në fshatin Barilevë;
- Mbikëqyrja e sanimit të rrugës së f. Prapashticë- lagjja Canaj;
- Mbikëqyrja e riparimit të rrugëve; Ballaban – Keqekollë; Koliq - Lagjja Tahiraj; Lagjja Tahiraj - Mramor; Bërnice - Sinidoll; Llukar – Siqevë; Barilevë - Lagjja e Kurtollëve;
- Mbikëqyrja e ndërtimit të rrugës "Çeta e Llapit";
- Mbikëqyrja e ndërtimit të rrugës Besi – Rimanishtë;
- Mbikëqyrja e ndërtimit të Qendrës për mirëqenie të gruas;
- Menaxhimi i ndërtimit të kompleksit banesor "Kodra e Diellit";
- Menaxhimi i ndërtimit të objektit të Komunës.

Pjesëmarrja në pranimin teknike të objekteve dhe punimeve të kryera:

- Teatri "Dodona";
- Shkolla "Emin Duraku" - dritaret;
- Ambulanca në f. Llukar;
- Terreni sportiv "Ulpianë";
- QMF "Kodra e Diellit";
- Objekti i SHPK-së në Graçanicë;
- Objekti i Logjistikës;
- Çerdhja "Gëzimi Ynë" Ulpiane;
- Gëlqerosja e shkollave;
- Kanalizimi fekale në Besi;
- Kanalizimi fekale në Hajvali;
- Mbulesa e autoparkut të Entit të Mjekësisë së Shpejtë.

d. Pjesëmarrja në komisionet për vlerësimet e tenderëve:

Gjatë periudhës raportuese, personeli i kësaj drejtorie ka marrë pjesë në vlerësimin e tenderëve të organizuar nga Zyra e prokurimit:

- Vlerësimi i tenderit për projektimin e objektit të Shkollës fillore në fshatin Llukar;
- Vlerësimi i tenderit për zgjedhjen e ndërtuesit të terreneve sportive në fshatrat: Mramor dhe Grashticë;
- Vlerësimi i tenderit për zgjedhjen e ndërtuesit për ndërtimin e banesave në fshatin Graçanicë;
- Vlerësimi i tenderit për zgjedhjen e projektuesit për shkollat fillore në fshatin Llukar dhe në lagjen "Vreshtat" etj..

e. Pjesëmarrja në komisionet-ekipet e ekspertëve të caktuar nga Bordi i drejtorëve

Në komisionin për hartimin e strategjisë për dislokimin e fshatit Hade.

f. Përgjigje në lëndët që kanë të bëjnë me infrastrukturë dhe rindërtim

Gjatë këtij viti raportues u është dhënë përgjigje kërkesave që kishin të bënin me infrastrukturë si: pëlqime urbanistike dhe detyra projektuese.

Informime dhe vërtetime për rikonstruktim të objekteve:

- Vërtetime.....	45
- Informime.....	11

Vendosja e kërkesave për pranim teknik të objekteve dhe leje përdorimi:

Gjatë vitit raportues janë lëshuar dy leje të përdorimit:

- Qendra socialo-edukative “Don Bosko”, pjesa e dytë,
- QKU, objekti Emergjencës dhe Mjekimit Intensiv Psikiatrik.

Kontrollimi i projekteve të proceduara për marrjen e leje të ndërtimit (pjesa e stabilitetit dhe instalimeve)

Gjatë vitit janë kontrolluar të gjitha projektet që kanë kërkuar leje të ndërtimit dhe të shndërrimit. Kontrolli konsiston në vlerësimin e cilësisë së hartimit të projektit sipas normave dhe standardeve të aplikueshme.

REALIZIMI I TË HYRAVE BUXHETORE NGA BURIMET E ARKËTUARA NGA PËRGJEGJËSIA E KËSAJ DREJTORIE

Vlen të përmendet se pas miratimit të planeve rregulluese është rritur numri i aplikuesve për marrjen e lejeve ndërtimore për objekte kolektive dhe mundësia e pagesës në këste, ka ndikuar që të hyrat buxhetore nga tarifat dhe ngarkesat komunale për rregullimin e tokës ndërtimore të rriten dukshëm duke arritur në shumën prej: 2.999.737,77 €.

Drejtorati propozon që mjetet e realizuara në emër të kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore, dhe ato në emër të shfrytëzimit të tokës ndërtimore, të orientohen në llogari të veçantë të Komunës dhe të njëjtat të përdoren ekskluzivisht sipa destinimit për të cilin llogariten dhe paguhen.

PUNË TË TJERA NGA PËRGJEGJËSIA E DREJTORISË

Gjatë kësaj periudhe raportuese, ky drejtori ka krye edhe aktivitete tjera në përputhje me kompetencat ligjore, si:

- lëshimin e lejeve urbanistike dhe lejeve ndërtimore,
- llogaritjen e kompensimeve për rregullimin e tokës ndërtimore,
- përgatitja e detyrave projektuese dhe materialit tenderues për objektet e investuara nga Komuna, si menaxhimi dhe pranimi teknike i tyre,
- pjesëmarrja në hapjen dhe vlerësimin e tendereve,
- përgatitja e kushteve urbanistike dhe caktimi i lokacioneve për objekte të ndryshme,
- përgatitja e propozimvendimeve me arsyetimet përkatëse, e materialeve për Komitete dhe Kuvend,
- organizimi i diskutimeve publike,
- propozimi dhe harmonizimi i akteve juridike, rregulloreve për ndryshimin dhe plotësimin e tarifave dhe taksave për rregullimin e tokës ndërtimore etj..

Me hartimin e Planit strategjik - zhvillimi urban i Prishtinës, janë përcaktuar kahet e zhvillimit të qytetit, gjegjësisht me planet rregulluese janë përcaktuar kriteret urbane për destinime të ndryshme si: banim, arsim, shëndetësi, sport, kulturë dhe të tjera.

Po ashtu, gjatë vitit raportues është punuar në harmonizimin e formës së konkluzioneve përfundimtare për zgjidhjen e kërkesave me rregullativën ligjore në fuqi nga lëmi i planifikimit dhe ai i ndërtimit, si dhe aktet tjera nënligjore të këtyre ligjeve, të nxjerra gjatë vitit raportues.

Është e rëndësishme së veçantë të përshkruhet puna e kësaj drejtorie në informacionet e përditshme gojore, lidhur me destinimet e planifikuara me Planin strategjik- zhvillimi urban i Prishtinës dhe planeve rregulluese të nxjerra në bazë të tij.

Në këtë drejtori gjatë kësaj periudhe raportuese, janë paraqitur edhe disa pengesa apo vështirësi, që kanë ndikuar dukshëm në mospërmbylljen e detyrave sipas orarit të planifikimit:

- numri i vogël i bashkëpunëtorëve profesionalë,
- mungesa e infrastrukturës së plotë ligjore,
- mungesa e të dhënave të sakta statistikore, siç janë p.sh. regjistrimi i popullsisë etj,
- mungesa e standardeve dhe normativave (planifikimit, ndërtimit dhe mirëmbajtjes).

OBJEKTIVAT

Kjo drejtori para vetës ka parashtruar edhe objektiva, siç janë:

- realizimi i infrastrukturës në planet rregulluese në koordinim me ndërmarrjet publike përmes grupeve punuese të përbashkëta,
- hartimi i planit zhvillimor komunal,
- hartimi i planit zhvillimor urban – revidimi dhe plotësimi i PSZHU-së,
- hartimi i planeve të reja rregulluese, sipas detyrave programore për hartimin e planeve rregulluese,
- vazhdimi i hartimit të planeve rregulluese të filluara në vitin 2006, si p.rr. “Sofalia”, “Lakërishta”, “Dardania”, “Lagjja e muhagjirëve”, si dhe planeve rregulluese “Prishtina e re”, “Qyteti i vjetër”,
- realizimi me koncesion i projekteve kapitale me përmbyllje të llojllojshme në hapësirat e planifikuara,
- përgatitjet për fillimin e implementimit të Ligjit për trajtimin e objekteve pa leje, për të cilin nevojiten mjete buxhetore, rritje të stafit punues, mjete ligjore etj.,
- ngritja e nivelit të bashkëpunimit në mes drejtorive dhe organeve tjera relevante,
- që mjetet e grumbulluara nga të hyrat e kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore të shfrytëzohen për realizimin e infrastrukturës në planet rregulluese, nga të cilat janë grumbulluar këto mjete.
- përpilimi i një doracaku (udhëzuesi) për opinion me informata për të gjitha rrjedhat në fushën e planifikimit dhe ndërtimit, gjithashtu edhe përmes “web” -faqes.

VËSHTIRËSITË DHE PENGESAT E PARAQITURA NË REALIZIMIN E DETYRAVE TË PLANIFIKUARA

Gjatë kryerjes së punëve dhe detyrave të punës nga përgjegjësia e kësaj drejtorie, janë vërejtur pengesa të ndryshme, të cilat kanë ndikuar dukshëm në efikasitetin, azhuritetin dhe realizimin e punëve dhe detyrave të punës si:

- atakimi enorm i hapësirave me ndërtime ilegale dhe uzurpimimi sipërfaqeve tokësore në pronësi të Komunës, gjë që kanë vështirësuar planifikimin në ato hapësira,
- kufizimi i të drejtës së administrimit të Komunës në tokën në pronësi të saj me Rregulloren mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45, si dhe mosdefinimi i pronësisë shoqërore, publike apo komunale etj..

PROPOZIMI I MASAVE:

- Të bëhet ndarja e kompetencave në mes të drejtorive me një akt të veçantë, në mënyrë recidive, sepse me Statut dhe Rregulloren për organizimin e brendshëm të organeve ekzekutive të Komunës, këto kompetenca janë dukshëm të ngatërruara;
- Të intensifikohet bashkëpunimi ndërdrejtoral brenda Komunës, për çdo iniciativë të projekteve urbaniste në kuadër të përgjegjësisë së secilës drejtori, deri në realizimin e projekteve;
- Të rritet (shtohet) numri i personelit civilë profesionalë në këtë drejtori, e veçanërisht ai nga lëmi i arkitekturës;
- Mjetet e llogaritura dhe të inkasuara në emër të kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore, dhe ato në emër të shfrytëzimit të tokës ndërtimore, të orientohen në llogari të veçantë të Komunës dhe të përdoren ekskluzivisht sipas destinimit për të cilin llogariten dhe paguhen;
- Zyra e prokurimit të bashkëpunojë me këtë drejtori, në mënyrë që për objektet që investohen nga buxheti i Komunës, fillimisht të pajisen me leje ndërtimi, e pastaj të shpallen tenderet për ndërtim;
- Objektet ndërtimore të përfunduara nuk mund të përdoren pa marrjen e lejes për përdorim.

IX. DREJTORATI I INSPEKSIONIT

Aktiviteti i Drejtoratit të Inspektionit për peridhen raportuese, është orientuar në punët mbikëqyrjes së zbatimit të ligjshmërisë dhe rregulloreve lokale të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, e që kanë të bëjnë me lëmin e:

- tregtisë,
- ndërtimtarisë,
- bujqësisë,
- veterinarisë, sanitarisë dhe
- veprimtarive komunale dhe të komunikacionit.

Punët e të gjithë sektorëve në kuadër të Drejtoratit të Inspektionit, janë bazuar dhe koordinuar në bazë të planprogramit për vitin fiskal 2006, gjegjësishtë për periudhën raportuese (janar- dhjetor 2006), si dhe të punëve tjera të paraqitura kohë pas kohe, në bazë të urdhëresave të organeve kompetente komunale, kërkesave të qytetarëve, organizatave komunale shërbyese, të policisë e të tjera.

Në kryerjen e punëve dhe detyrave, në kuadër të kësaj drejtorie kanë qenë të angazhuar 61 punëtorë, prej tyre 29 inspektorë dhe 32 bashkëpunëtorë.

Në vazhdim do të jepet një përshkrim i punëve dhe detyrave për çdo sektor, veç e veç, bazuar në planprogramet e punës për vitin fiskal 2006 .

I. Sektori i inspektionit të tregut

Inspektori	Kontrollime	procesverbale	Fletparaqitje për kundervajtje	Delikte ekonomike	Aktvendime	Pelqime për kushte sanitare	Urdhërsa me shkrim	Largim shitesve nga rruga	Ankesa qytetarve	Vlera e mallit të konfiskuar	Mjete të përlogaritura nga pranimi i lokaleve	
											Të inkasuara	Të painkasuara
Ahmet Frangu	569	453	04	/	218	521	/	105	/	0€	6.146.00 €	9.676.00 €
Ali Shala	1231	685	17	/	/	1	258	575	/	4532.00 €	300. €	
Merima Kastrati	1030	739	/	/	16	204	186	39	/	€uro	16.577.00	3.565.00 €
Shpresa Zhuja	773	598	/	/	6	71	148	53	3	200.00 €	5.059.00 €	1.606.00 €
Sefer Dragusha	1854	658	27	/	/	15	531	1077	05	500.00.E	1.307.50 €	250.00 €
Haki Shala	1827	703	14	/	01	42	323	878	01	5.682.00 €	2.791.00 €	190.00 €
Shemsi Haliti	1060	757	/	/	/	02	302	72	01	/	80 €	
Zymer Hoti	1426	1033	38	/	02	55	645	214	03	1000. €	3.814.00 €	52. €
Gjithsej	9770	5628	100	/	243	911	2393	3.013	15	11.914.00 €	91.074.00 €	15.341.00 €

II. Sektori i inspeksionit sanitar dhe veterinar

Inspektori	Kontroll.	Proce	Aktvend.	Fl.per.kund	Rek.sanitare	Mostra te ujit	Mostra te ushqimit	Strisha nga siperfaqe të punes
Sali Zogiani	818	566	13	/	42	38	/	
Xhemajl Islami	1014	601	38	65	56	/	82	
Fadil Salihu	1141	773	33	126	75	/	56	158
Idriz Blaku	612	381	04	/	25	20		
Gjithsej	3585	2321	88	201	198	58	138	158

-Asgjësimit të mallit me afat të skaduar në vlerë prej 228.198.00. Euro.

Inspektorët veterinarë: Rexhep Sejdiu dhe Bahtir Gashi.

- Kontrollime	1083
- Procesverbale.....	1083
- Aktvendime.....	71
- Fl. për kundervajtje.....	50
- Delikt ekonomik.....	02
- Dënime nga gjykata.....	20
- Shuma në euro- €.....	3.700
- Kontrollimi i kafshëve në thertore.....	3.287
- Vulosja e mishit të freskët pas therjes.....	3.257
- Inspektimi i tregut të kafsheve	52

- Inspektimi i tregut të gjelbërt (Bulmetoren).....103
- Monitorimi gjatë asgjësimit të qenve endacakë.....20
- Prezenca në asgjësim të ushqimit me af. të skaduar.....69
- Pjesëmarrja në aksionet e përbashkëta.....09
- Rekomadime veterinare.....20
- Shërbime të tjera veterinare, inspektimi, vaksinimet e qenve.....21
- Asgjësimi i ushqimit me afat të skaduar në vlerë prej171.982.€

Mjetet e inkasuara nga Shërbimi veterinar:

- mjetet e realizuara 7 890 €
- mjetet e porealizuara 8 100 €

Gjithsej..... 15 990 €

III. Sektori i inspektionit komunal dhe i komunikacionit

Nr. Rend.	Emri i Inspek.	Kontroll	Proces	Aktiv.	Fletparaq	Kërkes	Njofti	Aksion me SHPK-ne dite	Pranim lokale	Flete-thirrje	Rrënim objek
1	Hilmi Xhambazi	1328	331	179		91	65	11	407	15	
2	Rrushe Gashi	1087	441	68		8	3	10		4	
3	Refiqe Aliu	2048	347	52	1	23	14	181		1	1
4	Bahrie Morina	1028	239	31		9	6	14		7	
5	Qenan Osmani	929	109	10	46	44	10	78		8	3
6	Fehmi Avdiu	1388	170	70	2	81	74	11		89	2
7	Ramadan Berisha	1654	214	22	2	35	21	30		114	
8	Halil Beka	774	124	6			18			28	
9	Skënder Gashi	2020	249	59	1	37	25	75		22	3
10	Gani Uka	1139	292	18		16	13	25			13
11	Sabile Pllana	1518	629	8		14	14	14		66	3
12	Lumnie Hyseni	1565	771	8		18	17	14		58	4
13	Ukshin Rafuna	1253	257	6	4	14	11	47		24	4
14	Xhemajl Gërbeshi	225	98	54	16	52	56	3		5	
15	Kastriot Ibrahim	1078	292	124		9	7	25		13	4
16	Skënder Ferati	1480	386		311	136		129			
17	Mehdi Hoxha	1020	368		339	88		131			
18	Daut Humolli	1116	375		347	115		143			
	Gjithsej	22650	5692	706	1069	808	535	941	407	454	44

IV. SEKTORI I INSPEKSIONIT TË BUJQËSISË, MBROJTJES SË AMBIENTIT

a). Inspekcioni i mbrojtjës së ambientit jetësor

- Kontrollon menaxhimin e deponive për hudhjen e mbeturinave .
- Kontrollon mbrojtjen e ambientit nga dëmtimet e ndryshme, qoftë nga personat e përgjegjshëm apo nga bota shtazore.

b). Inspekcioni i bujqësisë

- Përcjell dhe mbikëqyr ndërmarrjet (kooperativat bujqësore, masat agroteknike);
- Bën kontrollimet e jashtëzakonshme, sipas kërkesave të palëve, lidhur me ankesat dhe parashtrësat e tyre;
- Kontrollon përqindjen e pijeve alkoolike dhe joalkoolike në qarkullim (nëpër lokalet që merren me shitjen e tyre).
- Mbikëqyrë artikujt ushqimorë me prejardhje bimore, prodhimin, qarkullimin dhe afatin e përdorimit;
- Kontrollon tregjet (ku shiten fidanet e pemëve, farërat e ndryshme etj.);
- Kontrollon barnatoret bujqësore;
- Kontrollon masat agroteknike , lavrimin dhe kushtet e kërkuara për të;
- Bën kontrollimin rreth mbjelljeve pranverore dhe vjeshtore, si dhe kontrollon korrje-shirje gjatë sezonës.

Ky sektor gjatë periudhës raportuese ka kryer :

Kontrollime	2.606
Procesverbale	2.048
Aktvendime	136
Fletëparaqitje	32
Artikujt ushqimorë të qitur jashtë qarkullimi :	
Sasia në kg.	32815 .kg
Sasia në lit.	110660 .Lit
Nëvlerë prej 135.201.00 €	

V. SEKTORI I NDËRTIMIT

Gjatë periudhës janar – dhjetor në qytetin e Prishtinës dhe rrethinën e tij, janë bërë kontrollime të shumta, dhe nga ana e Sektorit të ndërtimit janë evidencuar një numër bukur i mardh i ndërtimeve pa leje, ndërtimi i disave me kushte urbanistike, dhe një numër shumë i vogël me leje ndërtimi.

Meqenëse në Sektorin e ndërtimit punojnë tre inspektorë me kualifikimet përkatëse, ndërsa të tjerët nuk i posedojnë të njejtat kualifikime konform me ligjin për ndërtimin dhe autorizimet që dalin prej tij, qyteti i Prishtinës kontrollohet prej tre inspektorëve dhe bashkëpuntorëve të tyre.

Sipas shënimeve dhe raporteve përfundimtare të inspektorëve të ndërtimit, për periudhën raportuese janar-dhjetor 2006, në qytetin e Prishtinës dhe rrethinën e saj janë bërë mbi 2306 kontrollime, me ç'rast janë konstatuar me proces 448 fillime të ndërtimeve të reja të objekteve, anekseve, shtojcave, tavernave, mbindërtimeve, shndërrimeve të banesave dhe bodrumeve në lokale afariste etj..

Janë nxjerrë 270 urdhërndalesë, 127 aktvendime për rrënim (prej tyre janë ekzekutuar 78, kurse numri i përgjithshëm i rrënimeve është 204).

Nga numri i përgjithshëm i ndërtimeve, 37 janë me leje të ndërtimit, 43 leje ndërtimi për shndërrim, 25 pëlqime, 5 caktime të pikave, 12 leje paraprake, kurse janë revokuar 3 leje ndërtimi dhe refuzuar 15 kërkesa për leje ndërtimi (sipas të dhënave që na janë dërguar në Drejtorat).

Gjatë kësaj periudhe janë rrethuar 21 objekte, në pronën shoqërore ka filluar ndërtimi i 6 objekteve, janë shqyrtuar dhe është intervenuar në 118 raste të ndryshme, sipas kërkesave të qytetarëve dhe institucioneve.

Për të pasur një pasqyrë më të qartë të të gjitha ndërtimeve që janë bërë në qytetin e Prishtinës (të dhënat bazë shihen në PASQYRËN E PËRGJITHSHME TË LËNDËVE TË NDËRTIMIT për vitin 2006), japim të dhënat vijuese:

Tabela 1. Ndërtimet në lagjet e paurbanizuara - Objektet e banimit-shtëpitë individuale

Lagjja	Objekt banimi	Me leje	Pa leje	Masat	Inspektori	Nr.objekteve
“Veterniku”	+	Jo	po	urdhërndalesë	I.Vokri	42
“L. e Spitalit”	+	Jo	po	-II-	I.Vokri	2
“Tauk-Bahçe”	+	Jo	po	aktvendim	F.Mazreku	4
“Vreshtat”	+	1	2	urdhërndalesë	F.Mazreku	3
“Sofalia”	+	Jo	po	II	F.Mazreku	3
“Shkolla Normale”	+	Jo	po	aktvendim	F.Mazreku	1
“Çamëria”	+	Jo	po	urdhërndalesë	Drita	5
“Medresia”	+	1	3	II	Drita	4
“Kodra e Trimave”	+	Jo	po	II	Drita	28
“L.Gallapi”	+	Jo	po	II	Drita	2
“L.Gjinaj”	+	3	3	II	Drita	6
“Besiana”	+	Jo	po	II	Drita	11
“Çagllavica”	+	Jo	po	II	I.Vokri	23
L.Muhaxhirëve		2kush.	2	4Aktvendime 3te rrenuara	F.Mazreku	4
Gjithsej		5+2kusht	20			138

Tabela 2. Ndërtimet në lagjet e urbanizuara - Objektet e banimit-shtëpitë individuale

Lagjja	Objekt banimi	Me leje	Pa leje	Masat	Inspektori	Nr.Obj.
“Qyteza Pejton”		Jo	Po	Urdherndalesë-aktvendim	I.Vokri	4
“Mati I”		1 kushtet	26	Urdherndalesa	I.Vokri	26
“Kalabria”			6	Urdherndalesa	I.Vokri	6
“Dardania”	Pronë shoqërore		4	Aktvendim	I.Vokri	4
“Kodra e Diellit”		3	2	2 aktv.,1urdhër	F.Mazreku	5
“Dodona”		4+3kush	3	2urdhër,1aktv.	F.Mazreku	10
“Aktashi”		2	3	3urdhër,1aktv.	F.Mazreku	5
“Taslixhe”		5		5urdherndalesa	F.Mazreku	5
“Tophane”			5	3 urdher,2aktv	Drita	5
“Arbëria”			12	4 urdhër,7proc. 1aktvendim	Drita	12
Gjithsej		15+4kusht.	62			82

Tabela 3. Ndërtimet në lagjet e paurbanizuara - objekte afariste

Lagjja	Objekt afarist	Me leje	Pa leje	Masat	Inspektori	Nr.Obj.
“Veterniku”			8	urdhërndalesa	I.Vokrri	8
“Arbëria 3”		0	2	Aktvendime	I.Vokrri	2
“Hajvalia”		0	1	urdhërndalesë	I.Vokrri	1
“Kodra e Trimave”			2	urdhërndalesë	Drita	2
Çagllavica			1	Urdhërnd.	I.Vokrri	1
Gjithsej		0	14	14		14

Tabela 4.- Ndërtimet në lagjet e urbanizuara - objekte afariste

Lagjja	Objekt afarist	Me leje	Pa leje	Masat	Inspektori	Nr.Obj.
“Zona industriale”			7	Urdhërndalesë	I.Vokrri	7
“Arbëria 3”			1	Pronë.sh.Aktiv.	I Vokrri	1
“Dodona”			2	Urdhërnd.,proces	F.Mazreku	2
Q. Pejton			1	Urdhërndalesë	I.Vokrri	1
Gjithsej			11			11

Tabela 5.- Mbindërtimet

“Kodra e Diellit”	8	(leje për hidroizolim,sanim të kulmit)	3 të rrënuara
“Qendra”	2	(pa leje)	aktvendime
“Dardania”	1	(pa leje)	i rrënuar
“Aktashi”	2	(pa leje)	2 të rrënuara
“Tauk-Bahçe”	1	(pa leje)	i rrënuar
Gjithsej	14		7

4. Shndërrimet - ndërrimi i destinimit të objekteve banesore në lokale afariste

Tabela 6. Shndërrimet (26)

Lagjja	Nr. i Shëndrimeve	Me leje	Pa Leje
“Ulpiana”	16	16	0
“Dardania”	2	2	0
“Qendra”	8	8	0

Tabela 7. Tarracat (14)

Lagjja	Nr.Terrasave	Me leje	Pa leje	Aktvedimet
“Dardania”	4	0	4	4
“Kodra e Diellit”	1	0	1	1
“Qendra”	2	0	2	2
“Ulpiana”	6	0	6	6
“Aktashi”	1	0	1	1
Gjithsejt	14	0	14	14

Tabela 8. Themelet (9)

Lagjia	Nr.Themeleve	Me leje	Pa leje	Aktvendime
“Arbëria”	1	0	1	Procesverbal
“Besiana”	1	0	1	Urdhërndalesë
“Dodona”	1	0	1	Procesverbal
“Medresia”	1	0	1	Procesverbal
“Tauk-Bahçe”	2	0	2	Aktvendime
“Kodra e Trimave”	2	0	2	Urdhërndalesë
Lagjia e Spitalit”	1	0	1	Urdhërndalesë
Gjithsej	9	0	9	

Tabela 9. Objektet kolektive (17)

Lagjia	Nr.obj.kolektive	Me Leje	Pa Leje	Aktvendimet
“Dodona”	5	5	0	2urdhërndalesa
“Tophane”	3	1 (me kushte)	2	2Aktvendime 1Urdhërndalesë
“Kodra e Diellit”	1	1 (B+2)-tejkalim	0	Urdhërndalesë
“Arbëria”	4	1 (me kushte)	3	2Urdhërndalesa 2Aktvendime
“Mati 1”	3	2+1(me kushte)	0	3Procesverbale
“Kalabria”	2	2	0	
Gjithsej	18	10 +3 (me kushte)	5	

154 raste të ndryshme (ku hyjnë: gropime, plato, rrethoja dhe mure të ndërtuara në hyrje të banesave).

III. Puna e inspektorëve të ndërtimit

1. Drita Rukiqi me bashkëpunëtorët:

Në pjesën e parë të qytetit, nga rruga “Haxhi Zeka” ana e majtë, deri te rr. “Ahmet Krasniqi” ana e djathtë, me të cilën është ngarkuar inspektorja Drita Rukiqi, së bashku me referentët e ndërtimit Xhemshit Aliun, Nebahate Jasharin, Gëzim Ferizin dhe Jahir Abazin. Janë evidencuar 77 objekte. Kjo zonë përfshinë këto lagje: “Gjinaj”, “Kodra e Trimave”, “Medresja”, “Arbëria” dhe “Tophane” (shih tabelën 10).

Tabela 10.

Drita Rukiqi me referentët		Objekte Banimi Individual	Me Leje	Pa leje	Masat
	L.Paurbanizuar	55	4	51	49 urdhërn. 2procesverb.
	L.Urbanizuar	17	0	17	7 urdhërn. 3 aktvendime 3 te rrenuara 4.procesver.
		Objekte Afariste	Me Leje	Pa Leje	Masat
	L.Paurbanizuar	2	0	2	1urdhërndalesë 1aktvendim
	L.Urbanizuar	0	0	0	0
		Themele	Me leje	Pa Leje	Masat
	L.Paurbanizuar	4	0	4	3urdhërnda. 5procesverbale
	L.Urbanizuar	1		1	
		Objekte Kolektive	Me leje	Pa Leje	Masat
	L.Urbanizuar	7	2me kushte	5	3 urdhërn. 4aktvendime
Gjithsej		86	4+4me kushte	80	60urdhërn. 8aktvendime. 77procesverbale

Të Tjera:

- Mure – 4,
- Rrafshim terreni – 1,
- Rrethoja – 1,
- Depo – 1,
- Gropime – 4,
- Kuzhinë verore – 1,
- Garazh – 1,
- Bodrume – 3,
- Pllakë – 1,
- Mbyllje të dritareve -1,
- Objekt ndihmës – 1.

Gjithsej 19

- Kontrollime, konstatime dhe njoftime në kërkesë të palëve – 28,
- Procesverbale 105, urdhërndalesa 79, aktvendime 13,
- Aktvendime 10 - lista e lëndëve nga Dr. i Financave dhe të gjitha të rrënuara ,
- Prej tyre 13 janë te rrënuara.

Janë bërë 13 padi penale:

- 12 padi janë bërë në lagjet “Tophane” dhe “Arbëria”,
- 1 në “Lagjen e Gjinajve”.

2. Ilaz Vokrri me bashkëpunëtorët:

Në pjesën e dytë të qytetit, nga rr. “Ahmet Krasniqi” ana e majtë, rr. “Agim Ramadani” ana e djathtë deri te rr. “Muharrem Fejza” ana e djathtë, të cilën e mbikëqyr inspektori Ilaz Vokrri, së bashku me referentët e ndërtimit: Eroll Zeqiri, Bedri Gërdofcidhe Nazife Krasniqi. Kjo zonë përfshinë këto lagje: “Qendra”, “Dardania”, “Kalabria”, “Ulpiana” dhe “Mati I”, të cilat janë lagje të urbanizuara, kurse “Veterniku” dhe një pjesë e “Lagjes së Spitalit” janë të paurbanizuara.

Ilaz Vokrri me referentët		Objekte banimi	Me Leje	Pa leje	Masat
	L.Paurbanizuar	60	0	60	67 urdhërn.
	L.Urbanizuar	37	1 me kushte	37	31 urdhërnd. 6 aktvendime
		Objekte Afariste	Me Leje	Pa Leje	Masat
	L.Paurbanizuar	17	0	17	17 urdhërnda
	L.Urbanizuar	4	2	2	3 urdhërndal. 1 aktvendime
		Objekte Kolektive	Me leje	Pa Leje	Masat
	L.Urbanizuar	4	3+1 me kushte	0	
		Terraca	Me leje	Pa Leje	Masat

	L. Urbanizuar	12	0	12	12 aktvendime
		Shëndrrime të objekteve banesore në lokale afariste	Me leje	Pa Leje	
		8	5	3	
		Mbindërtime	Me Leje	Pa Leje	
		7	0	7	7 aktvendime
Gjithsej		149	10+1me kusht	138	88 Urdherndal 26 Aktvendime

Të tjera:

- Mure – 5,
- Objekte bujqësore -
- Objekte Hoteliere – 1,
- Objekte të përkohshme montuese – 11,
- Lokale afariste – 6,
- Rrethoja – 6,
- Gropime -7,
- Shtojca – 6,
- Themele – 1,
- Renovime – 2,
- Mbulesa – 1,
- Shkallë – 3,
- Plato – 7,
- Gropim/rrafshim terreni – 4,
- Terren sportiv – 1,
- Konstruksion metalik – 1,
- Tarraca - 12,
- Uzurpim i hapësirave të përbashkëta – 3.

Gjithsej: 77

- Kontrollime, konstatime dhe njoftime në kërkesë të palëve 90 (prej këtyre të rrënuara janë 31).

Janë bërë gjithsej 25 padi penale.

3. Flora Mazreku me bashkëpunëtorët:

Në pjesën e tretë të qytetit, nga rr. “Muharrem Fejza” ana e majtë, rr.” Agim Ramadani” ana e majtë, si dhe rr. “Haxhi Zeka” ana e djathtë, të cilën e mbikëqyr inspektorja Flora Mazreku, së bashku me referentët e ndërtimit: Sadik Hajdini, Nerxhivane Daka dhe Erdin Kurtolli. Kjo zonë përfshinë këto lagje: “Aktashi”, “Lagja e Muhaxhirëve”, “K. e Diellit I – II”, “Dodona”, “Mati I”, “Taslixhe”, “Tauk-Bahçe”, “Sofalia” dhe “Velania”.

Flora Mazreku me referentët		Objekte Banimi Individual	Me Leje	Pa leje	Masat
	L.Paurbanizuar	15	1+2me kushte	11	2urdhërndalesa 6aktvendime 4 të rrënuara 8procesverbale
	L.Urbanizuar	31	12+5me kushte	14	13urdhërndalesa 5aktvendime 15procesverbale 2 te rrënuara
		Objekte Afariste	Me Leje	Pa Leje	Masat
	L.Paurbanizuar	0	0	0	
	L.Urbanizuar	2	0	2	1aktvendim – e rrenuar 1procesverbal
		Objekte Kolektive	Me leje	Pa Leje	Masat
	L.Urbanizuar	7	7	0	2urdhërndalese 1aktvendim
	L.Paurbanizuar	4	0	4	4aktvendime- 2 te rrënuara
		Terraca	Me leje	Pa Leje	Masat
	L.Urbanizuar	2	0	2	2aktvendime
		Themele	Me leje	Pa Leje	
		3	0	3	1procesverbal 2aktvendime
Gjithsej		64	20+7me kushte	36	

Të tjera :

- Mbindërtime - 11, prej tyre 6 leje për hidroizolim, sanim të kulmit, 5 pa leje, 3 të rrënuara,
- Anekse – 8,
- Depo – 1,
- Gërmime – 5,
- Rrethoja – 5,
- Shtylla -1,
- Adaptim bodrume – 4,
- Rrafshim terreni – 3,
- Plato – 3,
- Mure – 2,
- Parking – 1,
- Thyerje të mureve – 1,
- Garazhe – 3,
- Bodrume - 5,
- Objekt ndihmës – 1,
- Shtëpizë – 1

- Kontrollime, konstatime dhe njoftime në kërkesë të palëve 70,
- Procesverbale 115, urdhërndalesa 30, aktvendime 45, të rrënuara 21,
- 74 prej ndërtimeve gjinden në lagjet e urbanizuara, ndërsa 41 në lagjet e paurbanizuara.
- Janë bërë gjithsej 24 padi për gjykatë.

Për hir të një pasqyre më të mirë të tërë punës tonë të zhvilluar në terren, do cekë vetëm disa rënime të bëra gjatë kësaj periudhe në tërë qytetin dhe rrethinën e tij.

➤ Mbindërtime.....	7
➤ shtojca.....	1
➤ themele.....	3
➤ objekte banimi	8
➤ gropime tereni.....	2
➤ tarraca.....	7
➤ garazhe.....	8
➤ rrënime të etazhit.....	11
➤ shtylla të katit.....	11
➤ rrethoja	36
➤ plato	52
➤ lokale afariste.....	11
➤ mure	3
➤ autolarje.....	2
➤ konstruksione të metalta.....	12
➤ pllaka të betonit.....	25
➤ objekte montuese.....	5

Të dhënat e parqitura në mënyrë globale për punët e kryera gjatë periudhës raportuese në kuadër të Drejtoratit të Inspekcionit :

➤ Kontrollime	37.768
➤ procesverbale	15.395
➤ aktvendime	1.658
➤ fletëparaqitje për kundërvajtje	1.212
➤ urdhërndalesa me shkrim	3.036
➤ intervenime të përbashkëta për largim të shitësve ambulantë.....	2.973
➤ kërkesa për asistencë të policisë	65
➤ konfiskim të mallit pa kthim nga shitësit, në vlerë prej.....	9.808 €
➤ asgjasim të mallit pa afat:	
-Sektori sanitar-veterinar.....	228.195 €
-Sektori i bujqësisë	135.201 €
	<u>Gjithsej: 363.396.00 €</u>
➤ Pëlqime për kushte tekniko-higjienike	932. lokale afariste
a) mjetet e inkasuara	92.642 €
b) mjetet e painkasuara	29.327 €
➤ Për konsum të brendshëm janë therur e vulosur:	
a) dema	2.813. copë
b) viça.....	695. copë

➤ rrënim i objekteve të ndryshme pa leje	204.
➤ kërkesa të palëve	2.813.
➤ njoftime palëve	1.695.

Në aktivitetin e përgjithshëm të kësaj drejtorie përpos punëve të parapara me planprogram, janë përfshirë edhe një varg aktivitetësh tjera me rëndësi për këtë drejtori, që tani do të japim paksa ma të detalizuar në kuadër të të gjithë sektorëve.

- Aksioni i përbashkët i Inspektionit me SHPK-në për largimin e stërshitësve ambulantë nga trotuaret dhe rrugët e qytetit, në veçanti para tregjeve në Ulpianë dhe Tregu i Gjelbër, me ç'rast, disa herë është bërë edhe konfiskimi i mallrave të ekspozuara .
- Punëtorët e sektorëve tjerë janë angazhuar kryesishtë në realizimin e punëve përkatëse sipa planit dhe sipas rasteve.
- Inspektorët e tregut kanë kontrolluar subjektet afariste për respektimin e ligjshmërisë, siç janë : leja e punës dhe dokumenatacioni përkatës .
- Sektori sanitar ka bërë kontrollimin e objekteve hoteliere, kuzhinave publike, mishtoreve, pishinave dhe objekteve shkollore për kushtet higjienike .
- Sektori i bujqësisë, kryesishtë ka bërë përcjelljen e fushatës së korrje-shirjeve , mbikëqyrjen e masave agroteknike, si në sektorin shoqëror ashtu edhe në në atë privat, barnatoret bujqësore, furrat private për kualitetin e bukës, prodhimet dhe finalizimet, si dhe mbikëqyrjen e artikujve ushqimorë me prejardhje bimore, si dhe të pijeve alkoolike dhe jo alkoolike , prodhimin dhe qarkullimin e tyre, afatin dhe kualitetin etj.
- Sektori i ndërtimit ka vazhduar me punën e përditshme në parandalimin e ndërtimeve pa leje dhe ushtrimin e masave administrative ndaj tyre.
- Sektori komunal dhe ai i komunikacionit, kanë qenë të anagazhuar në zbatimin e planit të punës në kuadër të kompetencave përkatëse rreth zbatimit të ligjshmërisë dhe pengimit të dukurive negative të hasura në terren. Me ritëm, të vazhduar ka bërë kontrollimin e subjekteve afariste për ekspozimin e mallrave jashtë lokaleve afariste, dhe ka ndërmarrë masa të duhura ligjore ndaj tyre. Po ashtu, ky sektor, përkatësishtë inspektorët e komunikacionit, në bashkëpunim me SHPK-në, policinë e trafikut, kanë kontrolluar auto-taxit dhe kombibusët lidhur me respektimin e rregullave dhe linjave përkatëse, duke shqiptuar fletëparaqitje dhe janë ndërmarrë masat e duhura ligjore ndaj kundërvajtësve .
- Me ndërmarrjet shërbyese dhe komunale, Drejtorati i Inspektionit pati një bashkëpunim të mirëfilltë dhe bashkarishtë u zgjodhën shumë probleme të paraqitura në terren.
- Drejtorati i Inspektionit i K.K. të Prishtinës, gjatë periudhës raportuese, ashtu si edhe më parë, pati një bashkëpunim të sinqertë dhe mjaft të suksesshëm me SHPK-në në realizimin e detyrave të përbashkëta.
- Drejtorati i Inspektionit edhe ditëve të fundjavëve (vikendeve), kanë mbajtur kujdestari të rregulltë për pengimin e dukurive negative të hasuara në terren, e që, për fat të keq, kjo punë nuk u është kompensuar si punë jashtë orarit punëtorëve të Inspektionit .
- Këto dhe aktivitete tjera, janë vetëm një pjesë e pasqyrimit të punëve shumë të mëdha në këtë drejtori.
- Për të gjitha rastet e veçanta gjatë kontrollimit, si dhe masave të ndërmarrja ligjore mbahen shënime zyrtare, siç janë: procesverbalet, aktvendimet, rekomandimet përgjigje palëve deri te procedura administrative gjyqësore.

Kjo drejtori gjatë aktivitetit për mirëvajtjen e procesit të punës, ka zhvilluar kontakte dhe bashkëpunim të mire me gjithë subjektet si drejtoritë brenda Komunës së Prishtinës, po ashtu edhe me drejtoritë e inspektionit të komunave tjera të Kosovës, me Administratën e UNMIK-ut, Policinë e UNMIK-ut, Shërbimin Policor të Kosovës, ndërmarrjet publike shërbyese, mediat elektronike dhe të shkruara, e në veçanti bashkëpunim të mire pati me bashkësitë lokale dhe me qytetarët në territorin e Prishtinës.

SFIDAT DHE VËSHIRËSITË:

- 1 Vëllimi i madh i punëve dhe problemeve që i dalin Drejtoratit të Inspekcionit, zvogëlon efikasitetin në punë, kur merret parasysh numri i pamjaftueshëm i inspektorëve të ndërtimit, por edhe i inspektorëve të tjerë si të Tregut , të Veterinës dhe të Sanitarisë
- 2 Mungesa e kompanisë që do të merrej me ekzekutimin e ndërtimeve pa leje. Këtë e kemi mbuluar deri diku me punëtorët fizikë me kontratë mbi vepër .
- 3 Mungesa e një force detyruese, që do të zbatonte urdhëresën e inspektorit për ndalimin e punimeve , derisa të pajiset investitori me dokumentet përkatëse teknike-leje ndërtimi etj..
- 4 Shpeshherë, inspektori në mungesë të sigurisë fizike (për shkak të shantazheve dhe kërcënimeve), pas kryerjes së aksionit ose ndërmarrjes së masave adekuate ligjore ndaj kundërvajtësit, heziton të bjerë vendimin adekuat ligjor. Kur kësaj i shtojmë stimulimin jo adekuat dhe gradimin jo të duhur, sipas Rregullores për ndarjen e të ardhurave personale, komenti mbase është i tepërt.

Këto janë vetëm disa prej sfidave të shumta me të cilat ballafaqohet Inspekcioni në punët e përditshme .

KËRKESAT DHE NEVOJAT E NGUTSHME:

- 1 Plotësimi i infrastrukturës ligjore dhe evitimi i magësive;
- 2 Krijimi i një “taks-forc”-e (policisë komunale të ndërtimit), apo i një sektori të veçantë në kuadër të SHPK-së , i cili do të merrej ekskluzivisht me zbatimin dhe mbikëqyrjen e urdhërndalesës së inspektorit;
- 3 Plotësimi i kuadrit profesional me inspektorë të ndërtimit dhe inspektorë të tjerë të sektorëve përkatës , konform me vëllimin e punëve;
- 4 Plotësimi i nevojave të Inspektoratit me pajimet e nevojshme për punë.

PËRFUNDIM

Pavarësisht kësaj që u tha më lart, falë angazhimit jo të vogël të Inspektoratit, rezultatet e punës nuk kanë munguar, edhe pse kërkohet mund dhe angazhim edhe më i madh për kryerjen e detyrave të punës me sukses.

Siç shihet nga pasqyrat tabelare, nxjerrja e planeve Rregullative, krijimi i vetëdijes dhe ndikimi në krijimin e kësaj vetëdijeje te qytetarët se janë të obliguar ta respektojnë ligjin dhe të jenë të përgjegjshëm ndaj vetvetes dhe të tjerëve, ka nisur të ketë efektin e vet. Në këtë drejtim gjithëherë jam angazhuar përmes mjeteve të informimit për krijimin e kësaj vetëdijeje. Kështu, stafi politik dhe ekzekutiv i Komunës, po edhe vet qytetarët, kanë krijuar një klimë mjaft pozitive në përkrahje të institucioneve për parandalimin e ndërtimeve ilegale.

X. DREJTORATI I ZHVILLIMIT RURAL

Drejtorati për zhvillim rural përkujdeset për krijimin e një infrastrukture më të mirë në zonat rurale dhe përkrahjen e zhvillimit të bujqësisë.

Prioritetet kryesore të kësaj drejtorie janë: infrastruktura rrugore, zhvillimi i bujqësisë në mënyrë direkte dhe indirekte, në bashkëpunim me Drejtoratin e Arsimit dhe atë të Shëndetësisë, koordinimi i punëve rreth krijimit të kushteve më të mira për arsim dhe shëndetësi.

Të gjitha prioritetet për vitin 2006, janë caktuar sipas kërkesave të përfaqësuesve të BL-ve, me një seleksionim të bërë nga përfaqësuesit e Drejtoratit dhe të Komitetit për zhvillim rural, çdo herë duke pasur parasysh mundësitë financiare.

SEKTORI I ZHVILLIMIT RURAL

Nr.	Projektet	Vlera
1.	Rruga Besi-Rimanishtë	14.905,00 €
2.	Rruga Ballaban-Keqekollë dhe në Prugovc	15 905,00 €

Gjatë vitit 2006, ky sektor ka zhvilluar aktivitetin në mirëmbajtjen e punëve rreth projekteve të zhvillimit rural dhe atë me vlerë prej 759 557 €.

1. Projektet e realizuara:

Sektori për zhvillim rural				
Nr.	Projektet	km	K.K.Prishtinë	Periudha kohore
1.	Riparimi i rrugëve rurale	35,00	61.000,00 €	Tetor-Nëntor
2.	Kanalizimi në fshatin Kishnicë	0,80	32.168,00 €	Gusht
3.	Kanalizimi në fshatin Drenovc	1,38	37.167,87 €	Gusht
4.	Ndërtimi i rrugës në fshatin Prapashticë	3,00	25.270,00 €	Tetor
5.	Rregullim i rrugës në f. Mramor- L. Lleshaj	2,40	4,940,00 €	Nëntor
6.	Asfaltimi i rrugës në lagj.Shala-Barilevë	0,185	5.300,00 €	Dhjetor

2. Në procedurë janë projektet:

Nr.	Projektet	km	K.K.Prishtinë	Periudha kohore
1.	Asfaltimi i rrugës në fshatin Hajvali	2,2	121.691,12 €	Dhjetor
2.	Asfaltimi i rrugës Besi-Rimanishtë	6,0	293.842,83 €	Dhjetor
3.	Riparimi i rrugës Prapashticë-Hajkobillë	11,0	62.292,28 €	Dhjetor
4.	Kanalizimi në fshatin Barilevë-lagjja Gashi	0,8	9.104,00 €	Dhjetor
5.	Asfaltimi i rrugës në Vranidoll	2,0	58.171,00 €	E padefinuar
6.	Mirëmbajtja dimërore(Lloto I+II)	154,00	17.800,00 €	Dhjetor-Mars

SEKTORI BUJQËSISË

Në vitin 2006 në Sektorin e bujqësisë, përveç projekteve të realizuara, është zhvilluar një aktivitet që kishte për bazë përcjelljen e mbjelljeve pranverore dhe vjeshtore. Përcjelljen dhe organizimin e korrje-shirjeve, vlerësimin e gjendjes, si dhe dëmet e shkaktuara në pyjet e KK –së së Prishtinës, si dhe Parkun rajonal “Gërmia”.

Projektet e realizuara:

Nr.	Projektet	Vlera €
1.	Furnizimi me farë misri dhe plehra minerale	9 405.00
2.	Eliminimi i qenve endacakë	8 194.70
3.	Planprogrami për mbjelljet pranverore 2006	
4.	Raporti mbi realizimin e planprogramit për mbjelljet pranverore 2006	
5.	Pjesëmarrja në inventarizimin (vlerësimin) e dëmeve të shkaktuara në rajonin e Prishtinës, si dhe në Parkun rajonal “Gërmia” për vitin 2006	
6.	Rrjedhat e punës në Parkun rajonal “ Gërmia”	
7.	Projekti- “Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura në “Lisica””- Prapashticë	
8.	Realizimi i projektit: “Pastrimi fito-sanitar i Parkut rajonal “Gërmia””	
9.	Përcjellja e projektit në mirëmbajtjen e gjelbërimit në Parkun e Qytetit ,Tauk-Bahçe dhe Arbëri për vitin 2006	
10.	Përcjellja e punëve në procesin e korrje-shirjeve 2006	
11.	Planprogrami i mbjelljeve vjeshtore 2006	
12.	Raport mbi realizimin e planprogramit të mbjelljeve vjeshtore	
13.	Furnizimi me farë gruri dhe plehra minerale	18.630.00
14.	Veterina mobile (realizim sipër)	9 660.00
15.	Gjithsej	45.889.70

Bujqësia është një degë mjaft e rëndësishme për zhvillimin e gjithmbarshëm ekonomik, si dhe për përmirësimin e mirëqenies sociale të qytetarëve të komunës së Prishtinës.

Gjatë vitit 2006 në lëmin e lavëtarisë, kemi bërë realizimin e këtyre punëve dhe projekteve:

- Planprogrami dhe realizimi i mbjelljeve pranverore dhe vjeshtore
Bazuar në programin e të mbjellave pranverore për vitin 2006, në komunën e Prishtinës janë planifikuar të mbillen gjithsej 2.778 ha me kultura pranverore. Ky planifikim është realizuar në tërësi. Sipërfaqet e mbjella me kultura pranverore/ha. Tërshërë - 62ha, misër - 2.130 ha, bimë foragjere – 240 ha, perime 78 ha, patate - 260ha, fasule si monokulturë - 8 ha.

Në vitin 2006 me kultura vjeshtore janë planifikuar të mbillen 2.568 ha, ky planifikim është realizuar në tërësi.

Sipërfaqet e mbjella me kultura vjeshtore / ha :

Grurë - 2.395, elb vjeshtor - 115, bimë foragjere - 15.

Nga të dhënat e lartpërmendura shihet se kemi një zvogëlim të konsiderueshëm të sipërfaqeve të mbjella me kultura lavëtarie krahasuar me vitet e mëparshme dhe në raport me sipërfaqet e përgjithshme të tokës punuese.

Faktorët që më së shumti kanë ndikuar në zvogëlimin e sipërfaqeve të mbjella me kultura lavëtarie janë:

- mungesa e mbështetjes dhe stimulimit institucional, subvencioneve etj.,
- hyrja e produkteve bujqësore nga vendet fqinje me lehtësi fiskale dhe që krijon një konkurrencë jo lojale në raport me prodhuesit vendor,
- çmimi i lartë i inputeve bujqësore(farërave, plehrave, derivateve të naftës etj.),
- mungesa e kredive me kamat të volitshme për zhvillimin e bujqësisë.

- Raport rreth procesit të korrje-shirjeve

Sipërfaqja e përgjithshme e mbjellë me kultura vjeshtore, për vitin 2005, ka qenë 2.680 ha. Prosesi i korrje-shirjeve ka filluar më 17.7.2006 dhe ka përfunduar më 16.8.2006.

Çmimi i korrjes sillej prej 85€/ha.

Rendimentet e grurit ishin mjaft të ulëta (2.500 kg/ha) dhe krahasuar me vitin e kaluar, janë përafërsisht 40% më të ulëta. Faktorët që kanë ndikuar në uljen e rendimenteve kanë qenë kushtet atmosferike jo të mira, që kanë mbretëruar prej mbjelljes së grurit e deri në korrjen e tij.

Në procesin e korrje-shirjeve kanë marrë pjesë 19 kombajna.

- Projekti “Furnizimi me farë misri dhe plehra minerale”

Projekti është realizuar më 10-11.4.2006, janë ndihmuar gjithsej 110 familje me nga 10 kg. farë misri, 150kg pleh mineral (NPK) dhe 100kg pleh mineral (Urea).

- Projekti “Furnizimi me farë gruri dhe pleh mineral”

Projekti është realizuar prej dt. 3.10.2006- .10.2006.

Janë ndihmuar gjithsej 200 familje me nga 150kg. farë gruri dhe 150kg pleh mineral.

Blegtoria – është një degë e rëndësishme e bujqësisë, zhvillimi i së cilës do të ndikonte në përmirësimin e kushteve jetësore në fshatra. Komuna e Prishtinës i ka të gjitha kushtet natyrore (livadhe dhe kullosa) për zhvillimin e këtij sektori, vetëm se duhet një përkrahje financiare e fermerëve, mirëpo për shkak të mjeteve të kufizuara buxhetore, nuk kemi pasur mundësi të realizojmë ndonjë projekt që do ndikonte në përmirësimin e ndjeshëm në këtë sektor.

Prandaj, me qëllim të përmirësimit sado pak të gjendjes ekzistuese, kemi realizuar projektin “**Veterinës mobile**”. Realizimi i këtij projekti ka për qëllim përmirësimin racor të gjedheve në komunën e Prishtinës, nëpërmes mbarësimit artificial, si dhe dhënien e këshillave veterinarë dhe zoohigjienike për fermerët që merren me blegtori.

-Projekti “Eliminimi i qenve endacakë”

Gjatë këtij aksioni janë eliminuar gjithsej 500 qen endacakë, ku është përfshirë tërë qyteti, dhe ky aksion ka rezultuar të jetë i suksesshëm dhe pa asnjë aksident të shkaktuar.

Eliminimi i qenve endacakë ka filluar më 17.8.2006 dhe ka përfunduar më 9.9.2006.

Pylltaria

Pas nënshkrimit të Memorandumit të mirëkuptimit nga sfera e pylltarisë, bashkëpunimi në mes të APK-së - njësisia e Prishtinës dhe DZHR.-së Prishtinë, gjatë vitit 2006 ka qenë në nivel

dhe kemi marrë pjesë në vlerësimin e kërkesave të qytetarëve për nevojat e furnizimit me dru për djegie. Janë shqyrtuar dhe miratuar 171 kërkesë, në sasi prej 10 263 m³ dru për djegie.

Komisioni i përbashkët ka punuar në inventarizimin e dëmeve pyjore në Sektorin shtetëror gjatë muajve tetor-nëntor 2006.

Është realizuar projekti: “ Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura Lisica-Prapashticë”, sipas Planit menaxhues për vitin 2006, në sipërfaqe prej 6 ha, janë mbjellë 15 000 copë fidanë të halorëve (pishë). Mbjellja është realizuar sipas planit gjatë muajit nëntor 2006.

Parku rajonal “Gërmia”

Sipas Strategjisë së zhvillimit afatgjatë të Gërmisë dhe Planit vjetor NPK”Hortikultura”, ka realizuar projektin: “ Pastrimi fito-sanitar i Parkut rajonal “Gërmia””, në zonën kadastrorë “Gërmia-II“, në sipërfaqe prej 321.68.12 ha, gjatë muajve shtator, tetor dhe nëntor 2006, është realizuar masa prej 453 m³ dru për djegie në vlerë prej 9 060 €.

Gjatë muajve nëntor-dhjetor 2006, është kryer inventarizimi i dëmeve të shkaktuara në Parkun rajonal “Gërmia”. Është regjistruar dëmi i shkaktuar prej 91.791m³. Krahasuar me dëmet gjatë viteve 2003 - 2004, janë zvogëluar për 70%.

Projekti: “ Ngritja e sipërfaqeve gjelbëruese, rregullimi i rigollave dhe rregullimi i trim stazave në Parkun rajonal “Gërmia”, NPK “ Hortikultura” projektin e ka realizuar gjatë vitit 2006 në vlerë prej 30 000 €, 50% ka financuar UNDP-ia dhe 50% NPK “ Hortikultura “.

1.	Sektori për zhvillim rural	759 557.00€
2.	Sektori për bujqësi	45.889.70€
3.	Gjithsej	805 446.80€

XI. DREJTORATI I KADASTRIT DHE I GJEODEZISË

Gjatë periudhës raportuese, angazhimi i drejtorisë ka qenë në përmbushjen e detyrave dhe punëve, të cilat janë të parapara me dispozitat që kanë të bëjnë me kadastrin dhe gjeodezinë.

- Miratimi i kërkesave të personave juridikë: Kuvendi i Komunës dhe organet e administratës, organet e pushtetit qendror dhe Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit në përgatitjen e dokumentacionit për privatizim. Për nevojat e Komunës, ka shqyrtuar të gjitha kërkesat që kanë të bëjnë me kompetencë të saj: për nevojat e infrastrukturës, planifikimit dhe të shërbimit pronësor.
- Fillimi i zabtimit të projektit për regjistrimin e kadastrit etazhor.
- Shqyrtimi i të gjitha kërkesave të paraqitura nga personat fizikë: kërkesat për certifikatë mbi të drejtat e pronës së paluajtshme, kërkesat për kopje plani, kërkesat për certifikata për ndihmë sociale, për rregullimin e vizës, për rregullimin e dok. për bursat e studentëve, për rregullimin e dok. për banim në konvikt dhe për nevoja personale, kërkesat për regjistrimin (bartjen) e pronave sipas kontratave, aktvendimeve dhe aktgjykimeve të gjitha të vërtetuar në gjykata, kërkesa për regjistrimin e ndarjeve të ngastrave, kërkesa për intabulim të hipotekës, kërkesa për çregjistrim të intabulimit të hipotekës, kërkesa për barrë tatimore, kërkesa për matjen dhe ndarjen e ngastrave kadastrorë, kërkesa për rievimin e gjendjes faktike, identifikimin e objekteve apo indentifikimin e ngastrave, ndërrimin e kulturës në ngastër, ripërtirja e kufijve të ngastrave, dhe të gjitha punët tjera gjeodezike. Edhe në mungesë të tërë elaboratit kadastror, si juridik ashtu edhe teknik (origjinal) , me angazhimin maksimal të personelit janë kryer me kohë obligimet ndaj qytetarëve, ndërrmarrjeve dhe institucioneve tjera.

Pasqyra e realizimit të punëve sipas kërkesave

Lëndë të terrenit janë pranuar:

- gjithsej.....	1043
- të miratuara – të kryera (private)	913
- të miratuara – të kryera (sipas kërkesave të organeve të KK-së dhe instituc. tjera).....	54
- në procedurë	76

Në bazë të dokumentacionit juridik dhe teknik për nevojat e ndërrimeve në operatin kadastror, janë pranuar:

- gjithsej.....	2038
- janë kryer.....	1985
- në procedurë.....	27
- janë refuzuar.....	6

Lëndët e intabulimit – hipotekave janë pranuar dhe miratuar:

- gjithsej.....	861
- për regjistrim.....	678
- për çregjistrim.....	183

Lëndët për barrë tatimore

- gjithsej.....	11
- të kryera.....	6
- të pakryera në mungesë të të dhënave.....	5

Zyra për certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme dhe kopje plani, certifikata për ndarjen e ngastrave, për rreg. e dokumentacionit të ndihmës sociale etj. janë pranuar dhe miratuar:

- gjithsej (kërkesa).....	14416
- certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme	5221
- kopje plani.....	4713
- certifikata për ndarjen e ngastrave.....	734
- certifikata për rreg. e dok. të ndihmës sociale etj.	3748

Vlen të theksohet se përkundër të gjitha vështirësive objektive, në mungesë të të dhënave teknike dhe juridike, të cilat nuk janë kthyer ende nga Serbia, ashtu edhe vështirësive subjektive, Drejtorati i Kadastrit dhe i Gjeodezisë ka arritur t'i kryejë të gjitha punët në afatet e caktuara, edhe pse është rritur vëllimi i punëve mbi 30% krahasuar me vitin paraprak.

XII. DREJTORATI I SHËRBIMEVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE I MBROJTJES SË AMBIENTIT DHE TOKËS NDËRTIMORE

Fushëveprimi i Drejtoratit përfshin realizimin dhe mbikëqyrjen e shërbimeve publike, avancimin e tyre përmes programimeve, planifikimeve, monitorimeve, ndërtimit të strategjisë për investime në lëmin e shërbimeve publike dhe harmonizimin e veprimtarive të subjekteve tjera, të cilat drejtpërdrejt ose tërthorazi merren me këto shërbime. Gjithashtu, Drejtorati bën mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve, rregulloreve dhe të akteve tjera nënligjore me të cilat rregullohet lëmi i shërbimeve publike, si: dhënie e lejeve për shfrytëzimin e hapësirave publike për vendosjen e objekteve të përkohshme, mbikëqyrjen e pastrimit të qytetit dhe bartjes së mbeturinave, rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave, zgjerimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara dhe funksionimin e transportit publik urban të udhëtarëve dhe të parkingjeve publike me pagesë. Drejtorati i Shërbimeve Publike, Transportit dhe i Mbrojtjes së Ambientit dhe Tokës Ndërtimore, aktivitetet e veta është duke i zhvilluar në përputhje me planin e punës për vitin 2006.

SHËRBIMI JURIDIK

Gjatë periudhës së vitit 2006 kemi vazhduar punën në hartimin e akteve juridike, nga fushëveprimi i tij, në bazë të ligjeve më të reja, të miratuara në Kuvendin e Kosovës. Në Kuvendin e Komunës janë punuar dhe miratuar Rregullorja për rrugët lokale dhe rrugët në vendbanime, Rregullorja për sigurimin dhe mirëmbajtjen e varrezave dhe Rregullorja për caktimin e linjave dhe itinerarit të transportit urban të rregullt të udhëtarëve me autobusë në territorin e komunës së Prishtinës. Është hartuar dhe miratuar edhe Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për shërbimin e transportit me "merimangë". Është nxjerrë një numër i konsiderueshëm i vendimeve dhe aktvendimeve në bazë të kërkesave të qytetarëve dhe subjekteve tjera, lidhur me realizimin e të drejtave apo obligimeve të tyre nga kompetencat e drejtorisë, siç janë: dhënia e lejeve për shfrytëzimin e përkohshëm të hapësirave publike, për parkim në rrugët dhe hapësirat e qytetit dhe për rregullimin e sipërfaqeve të gjelbëruara.

Gjatë vitit 2006 kemi realizuar 536 986. 87€

Kemi pranuar dhe zgjidhur këtë numër të kërkesave:

- **856 kërkesa të pranuar,**
- **848 „ të zgjidhura,**
- **8 „ në procedurë.**

SEKTORI I SHËRBIMEVE PUBLIKE

Sektori i shërbimeve publike gjatë vitit 2006, aktivitetet e veta i ka zhvilluar në bazë të planit të punës, e që kryesisht ka të bëjë me dhënien e lejeve për kyçjen e objekteve individuale të banimit dhe objekteve shoqërore në rrjetin kryesor të ujësjellësit, kanalizimit, rrjetit elektrik dhe të ngrohjes në qytet. Me qëllim të përmirësimit të kushteve elementare të jetës së qytetarëve, sektori është angazhuar edhe në bashkëpunim me kompanitë përgjegjëse, ka zgjidhur problemet në fushën e furnizimit me ujë të pijes, zgjidhjen e problemit të ujërave të zeza, furnizimi me energji elektrike dhe mirëmbajtjes së higjienës në qytet. Është hartuar dokumentacioni për tenderimin e infrastrukturës rrugore në qytet, në bazë të projekteve të hartuara nga shtëpitë projektuese. Gjithashtu, është bërë monitorimi gjatë ekzekutimit të punimeve nga fituesit e tenderëve. Kemi marrë pjesë në hapjen dhe vlerësimin e ofertave të ofertuesve, si dhe pranimin teknik të punëve të kryera.

Gjithsej kemi pranuar 36 kërkesa, që kryesisht kishin të bënin me lëshimin e aktvendimeve për kyçjen e objekteve në rrjetin e ujësjellësit, të kanalizimit, njoftime dhe të gjitha janë zgjidhur.

Kanalizimi

- Hartimi i paramasës me paralogari për pastrimin e lumenjve Prishtina dhe Kolovica, e realizuar me kontratë nr. 616 06 173 521, të dt. 23.11.2006 në vlerë prej **21.140,00 €**.
- Hartimi i paramasës me paralogari për pastrimin e rrjetit të kanalizimit atmosferik në qytet, e realizua në vlerë prej **11.857,00 €**.

Ngrohja

- Është bërë mbikëqyrja e sanimit të rrjetit të ngrohjes qendrore në disa rrugë të qytetit (investimi i Ngrohtores).

Higjiena publike në qytet

Janë paraparë të pastrohen 31 rrugë në qytet në gjatësi prej 22.71 km. Pastrimi, larja e rrugëve dhe e trotuareve i është besuar NP “Pastrimi”.

Projekti mbi pastrimin e rrugëve është kryer me sukses dhe ka përfunduar më 15.11.2005, në shumën 147,626.22 €.

Mirëmbajtja dimërore në vitin 2006/2007, i është besuar dy kompanive:

VZ”Company”, me kontratën nr 616 06 174 521, të dt. 6.11.2006, ku janë paraparë të pastrohen 82 rrugë në shumën prej 66.860,00 €.

NR”Pastrimi”, me kontratën nr. 616 06 174 521, të dt. 6.11.2006, ku janë paraparë të pastrohen 69 rrugë, në shumën prej 44.100,00€.

SHËRBIMI ELEKTRO-ENERGJETIK

Gjatë vitit 2006 në Shërbimin e energjetikës, gjithsejtë kanë arritur 95 kërkesa. Prej tyre 89 janë zgjidhur, ndërsa 6 kërkesa janë në procedurë e sipër. Kërkesat kanë të bëjnë me dhënien e lejes për ndërtimin e objekteve elektro-energjetike: PTK, TV, informata, lajmërimë, pëlqime dhe fatura.

Mirëmbajtja dhe sanimi i ndriçimit publik

Në bazë të kontratës nr. 06–029-121, të dt. 22.5.2006, punët për mirëmbajtjen e ndriçimit publik i janë besuar NP “Monten” nga Prishtina. Për mirëmbajtje janë shpenzuar mjetet në shumë: 87.289,60 € për ndriçimin e 185 rrugëve.

Mirëmbajtja e semaforëve

Në bazë të kontratës nr .06–091-121, të dt. 4.7.2006, punët në mirëmbajtjen e semaforëve i janë besuar DPZ. “Jame” nga Prishtina, në shumë 49.666,00 €. Nga mjetet e alokuara janë shpenzuar 12.838,00€.

Shpenzimi i energjisë elektrike

Shpenzimet e energjisë elektrike për ndriçim publik dhe semaforë për periudhën janar-dhjetor në shumën 236.369,38 €, janë dërguar mjetet për pagesë.

Mbikëqyrja e ndriçimit publik dhe kanalit të rrjetit kablovik

Në këtë periudhë kohore është punuar në mbikëqyrjen e ndriçimit publik dhe kanalit të rrjetit kablovik të 10 (dhjetë) rrugëve të reja në qytet.

Shfrytëzimi i hapësirave publike

Gjatë kësaj periudhe kanë arritur gjithsejtë 347 kërkesa për shfrytëzimin e hapësirave publike para lokaleve, standave lëvizëse dhe panove. Prej tyre 194 janë zgjedhur, ndërsa 95 janë refuzuar, 26 janë kryer me njoftime, 6 janë përcjellë në drejtoritë përkatëse, 26 kërkesa janë kryer me aktvendime për vendosjen e shkallëve para lokaleve.

Të hyrat nga shfrytëzimi i hapësirave publike:

- para lokaleve, standave, reklamave dhe gjeneratorëve.....115.162.02 €
- nga kompania AMM.....92.002,00 €

Gropimet e kanalit për shtrirjen e tubave të ujësjellësit.....110,00 €

Gropimet e kanalit për shtrirjen e kablllove energjetike..... 705,00 €

Të hyrat e realizuara nga sektori për transport dhe ambient janë:

• NTP”Park Project – Itg” ,loto I dhe II	19.600,00 €
• Kompania “Beni-Dona Plast”, loto III dhe IV.....	10.000,00 €
• NN”Mala”.....	12.202,00 €
• Nga parkingjet e rezervuara	45.700,00 €
• Nga kompanitë e shërb. me “merimangë”.....	44.529,25 €
• Nga parku i Gërmisë	81.814,58 €
Gjithsej të hyra	536.986,87 €

SEKTORI I TOKËS NDËRTIMORE

Gjatë këtij viti kanë arritur 48 kërkesa dhe të gjitha janë kryer. Kërkesat kanë të bëjnë me hartimin e paramasës me paralogaritë për ndërtimin e infrastrukturës me participimin e komunitetit. Po ashtu, ky sektor ka bërë mbikëqyrjen gjatë ekzekutimit të punimeve në ndërtimin e infrastrukturës rrugore. Ka qenë pjesëmarrës në hapjen dhe vlerësimin e ofertuesve, në takimet me komunitete rreth zgjidhjes së problemeve në infrastrukturë, në takimet me Komitetin e Shërbimeve Publike dhe pranimet teknike të punëve të kryera.

Rrugët:

Realizimi i projekteve në ndërtimin e infrastrukturës rrugore(të realizuara dhe në realizim e sipër) janë dhënë në formë tabelore.

INVESTIMET E BARTURA NGA VITI 2005-2006

Nr.	Rruga	Aktiviteti	Punëkryesi	Marrëveshja	Vlera	Vlerat e paguara gjatë vitit 2005	Vlerat e paguara gjatë vitit 2006
1	“Nuhi Berisha”	Asfaltim Ndriçim Sinjalizim Kanalizim atmosferik fekal	“Albaniku”	31.10.2005	126.743,95	-	121.685,14
2	“Rexhep Shema”	Asfaltim Kanalizim fekal atmosferik	“Viktoria”	4.07.2005	160.715,72	-	141.221,79
		Sinjalizim ndriçim publik, kanal i rr.kabllovik					
3	“Shaban Shala”	Asfaltim Kanalizim Ndriçim publik, rr.kabllovik sinjalizim	“Ndërtimi”	22.08.2005	154.033,91	44.248,42	41.399,15
4	“Çeta e Llapit”	Asfaltim Kanalizim atmosferik n.publik. rr.kabllovik Sinjalizim	“Getoari”	13.06.2005	179.390,90	-	178.867,15
5	“Jakup Ferri”	Asfaltim kanalizim atmosferik	“Labi”	21.10.2005	51.350,86	-	34.903,41
6	“Xhavit Ahmeti”	Asfaltim Kanalizim n.publik	“Unicom”	21.10.2004	237.984,81	-	237.984,31
7	“Dëshmorët e Marecit”	Asfaltim Kanalizim Ndriçim Ujësjetës sinjalizim	„Unicom”	30.06.2005	218.014,27	158.976,11	59.038,16
8	“Holgen Petersen”	Asfaltim Kanalizim atmosferik Ndriçim publik, rr. kabllovik dhe sinjalizim	„Labi”	12.09.2005	227.373,13	52.840,90	174.532,23
9	“Abedin Rexha”, “Llapi” dhe “Xheladin Kurbaliu”	asfaltim	„Shkoza”	21.05.2005	57.922,10	17.818,86	40.103,24

Vëllimi financiar i punëve të kontraktuara, të përcjella nga viti 2005 në vitin 2006:

-1.413.529,65 €
- Gjatë vitit 2005 janë paguar gjithsej:273.884,29 €
- Kanë mbetur, vëllimi financiar për vitin **2006**:1.029.734,58 €
- Gjithsej për projekte janë paguar1.303.618,87 €
- Për pagesë ka mbetur vetëm rr. “Shaban Shala”, në vlerë prej68.386,34 €

Gjatësia e rrugëve të realizuar 3557m².

Sipërfaqja e asfaltuar 19.378,50m².

Sipërfaqet e trotuareve me kubze 7.120m².

Rrugët me kubze 201m².

Kanalizimi fekal 3080m².

Kanalizimi atmosferik 3482 m².

INVESTIMET NË VITIN 2006

Nr.	Rruga	Aktiviteti	Punëkryesi	Vlera e kontraktuar 2006	Vlera e paguar 2006	Vlera e mbetur për 2007	Rruga			Trotuari
							Gjatësia	kubza	asfalt	kvaderna
							m ²	m ²	m ²	m ²
1	Sanimi i gropave	Asfaltim	“Maliqi”	97.326,76	97.326,76	-			3550	
2	“Agim Ramadani II”	Asfaltim sinjalizim	“Viadukt”	211.830,89	211.830,89	-	704		12.5	5053
3	“Agim Ramadani III”	Asfaltim sinjalizim	“Unicom”	145.504,79	145.504,79	-	542		10541,43	3791
4	“Agim Ramadani IV”	Asfaltim sinjalizim	“Unicom”	152.124,80	152.124,80	-	709		10.415,12	4602
5	“Nazim Gafurri”	Asfaltim sinjalizim	“Maliqi”	103.136,34	101.133,84	-	1250		10600,00	
6	Rrugët lidh. “Haxhi Zeka”	Asfaltim zhavorr	“Shkoza”	28.616,80	24.347,90	-	173		720m ² 900m ²	
7	“Mbretëresha Teutë”	Asfaltim Kanalizim atmosferik Sinjalizim Ndriçim publik	“Noti”	155.849,69	77.924,85	77.924,75	526		3156	1578
8	“Isa Kastrati”	Asfaltim Kan. Fek. atm. Sinjalizim Ndriçim publik k.kabllovik	“Euro Garten”	189.571,82	94.785,91	94.785,91	720		4659,8	2826,5

			“Monten”	62.615,00	41.125,00	21.490,00				
9	Rruga për MAT	asfaltim	“Ekskavatori”	92.248,65	92.248,65		1.739,52		6984.1	
10	“Holgen Petersen”	Rrj i uji Dis. i rret. Ten. i ulët	“Labi”	29966,97	29966,97					
11	San. i gropa.	Asfalt	“Maliqi”	9.731,75	9.731,75				913,0	
12	“Aziz Zhilivoda”	Asfaltim Kan. Atm. fekal	“Noti”	89.665,73	87.641,70	-	450		2970,0	830
13	“Muharrem Fejza”	Zhavorr k.fek. dhe atmos.	“Labi”	102.486,30	102.486,30	-	957		zhavorr	
14	“Hys Popova” “Islam Bulliqi”	Rrugë kanalizim atmosferik fekal ujës-jellës ndriçim	“Labi”	119.986,11	119.986,11	-	590	1642,5	1430,60	
15	“Aziz Zhilivoda”	Furnizimi me gypa- kapak	Noti(aneks)	9402	9402					
16	“Naser Hajrizi”	kubze	“Area”	4225,70	4225,70	-	65	280		
17	Ndërtimi i rrugës lidh.	kubza	“Labi”	32.616,80	20.965,18					
18	Ndërtimi I kanalizimit në Kishnicë	Kanalizim fekal	“Noti”	32.168,80	32.168,00					
19	Ndriçimi dhe kyçja me energji elektrike të kontanjerave		“Eltrafomont” F ushë Kosovë	5290,00	5290,00					

Vlera e projekteve të kontraktuara për vitin **2006**:.....**1.674.365,70 €**

- Të paguara gjatë vitit **2006**:.....**1.460.217,11 €**
- Të përcjella për vitin vijues **2007**:**194.200,66 €**
- Të kthyer**19.947,05 €**

Gjatësia e rrugëve l = 8187,52m’
 Sipërfaqja e asfaltuar 64.890,05m²
 Sipërfaqja e trotuareve me kubze 18.680,50m²
 Rrugët e shtruara me zhavorr 1.137,00m²
 Kanalizimi fekale 2.609,00m²
 Kanalizimi atmosferik 2.472,00m²

SEKTORI I TRANSPORTIT

Puna e Sektorit të transportit dhe mbrojtjes së ambientit gjatë kësaj periudhe është realizuar sipas Planit të punës së Drejtoratit për vitin 2006. Përqendrimi i aktiviteteve kryesisht ka qenë rreth transportit publik, sinjalizimit në përgjithësi dhe parkingjeve.

Transporti publik

Organizimi i transportit:

Në kuadër të angazhimit të avancimit të transportit në përgjithësi, Sektori i transportit gjatë kësaj periudhe, ka kryer këto punë:

- Është përgatitur dhe proceduar Rregullorja për caktimin e linjave dhe itinerarit të transportit urban të rregullt të udhëtarëve me autobusë në territorin e komunës së Prishtinës, e cila është miratuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës, më 4.5.2006.
- Shqyrtimi i dokumentacionit të aplikuesve për operim në transportin publik urban dhe urban - periferik.
- Punimi i orareve dhe itinerareve të operimit të transportit publik, si dhe dhënia e tyre, operatorëve transportues, punimi i itinerareve në formë grafike dhe publikimi i tyre nëpër tabela të stacioneve.
- Punimi i projekt-marrëveshjes për organizimin e transportit publik me komunat Fushë-Kosovë dhe Obiliq, marrëveshje e nënshkruar nga kryetarët e komunave Prishtinë, Fushë-Kosovë dhe Obiliq, e cila është miratuar edhe nga Ministria e Transportit.
- Punimi i orareve për operimin e transportit publik me Fushë-Kosovë dhe Obiliq, dhe vërtetimi i rrethit të udhëtimit nga të tri komunat.
- Bisedimet me përfaqësuesin e Bankës Botërore rreth programit të investimeve për qytetin e Prishtinës, në mënyrë që të bëhet përmirësimi i transportit, parkingjeve publike, semaforëve etj.

Parkingjet:

- Janë dhënë në shfrytëzim (të rezervuara) vendparkime për institucione shtetërore të vendit dhe të huaja, pa pagesë, si dhe për subjekte fitimprurëse me pagesë.
- Vazhdimi i shfrytëzimit të parkingjeve publike me koncesion, të ndara në katër loto.
- Të hyrat e realizuara nga Sektori për transport dhe ambient janë:

• NTP"Park Project – Itg", loto I dhe II.....	19.600,00 €
• Kompania "Beni-Dona Plast", loto III dhe IV.....	10.000,00 €
• NN"Mala"	12.202,00 €
• Nga parkingjet e rezervuara	45.700,00 €
• Nga kompanitë e shërb. me "merimangë".....	44.529,25 €
• Nga parku i Gërmisë	81.814,58 €
• Totali	213.845,83 €

Nga shfrytëzimi me koncesion i parkingjeve publike për vitin 2006, kanë mbetur pa paguar:

"Park Projekt-Itg".....	72801,18 €
"Beni-Dona Plast".....	48310,30 €

Për këtë me kohë janë informuar të gjitha organet kompetente të Komunës.

- **Sinjalizimi horizontal dhe vertikal:**

Në bazë të kontratës nr. 61606145521, të datës 26.10.2006, punët i janë besuar për realizim NN "Plasteline Ve-Mor" në vlerë prej. 965,00 €.

Kontrata e sinjalizimit është realizuar 25% e projektit për vitin 2006.

- Lëndë të shqyrtuara

Gjatë vitit 2006 janë shqyrtuar 230 lëndë.

SHËRBIMI I MBROJTJES SË AMBIENTIT

Puna e Shërbimit të mbrojtjes së ambientit gjatë periudhës njëvjeçare, është realizuar sipas Planit të punës së Drejtoratit të Shërbimeve Publike për vitin 2006. Përqendrimi i aktiviteteve të Shërbimit të mbrojtjes së ambientit ka qenë kryesisht rreth mbikëqyrjes së sipërfaqeve të gjelbëruara të qytetit, të parapara me tender dhe shqyrtimi i lëndëve (kërkesave) nga komuniteti.

Për mirëmbajtjen e sipërfaqeve gjelbëruese të qytetit, me tender, janë të përfshira 422.587 m², në dallim me vitin 2005 kemi rritje të sipërfaqeve për mirëmbajtje prej **122.587 m²**.

Mirëmbajtja e sipërfaqeve të gjelbëruara është ndarë në dy loto, me pesë zona.

- **Lotoja e parë** përfshinë sipërfaqet: "Varrezat e Dëshmorëve dhe të Jahudive", "Ulpiana" dhe "Kodra e Diellit".
- **Lotoja e dytë** përfshinë sipërfaqet: "Qendra" dhe "Dardania".

Fitues i lotos së parë është NPT "Las Pallmas" nga Lypjani, e cila ka kontratë njëvjeçare të mirëmbajtjes së sipërfaqes prej 276.000 m², ku shumica e vlerës së kontratës është 37.227.80 €.

Fitues i lotos së dytë është NPK "Hortikultura", e cila ka kontratë njëvjeçare për mirëmbajtjen e sipërfaqes prej 146.587 m² dhe vlera e kontratës është 34.681,16 €.

Mbikëqyrjen e punëve rreth mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbëruara e bëjnë bashkëpunëtorët profesionalë të Shërbimit të mbrojtjes së ambientit.

Gjatë kësaj periudhe kohore Shërbimi i mbrojtjes së ambientit, në bashkëpunim me NPK "Pastrimi", ka bërë vendosjen e 39 shportave të mbeturinave në rrugët "Nënë Tereza" dhe "Bulevardin e Dëshmorëve".

Kemi bërë matjen dhe incizimin e disa sipërfaqeve të gjelbëruara për përgatitjen e projekteve të reja të gjelbërimit, por në mungesë të mjeteve buxhetore nuk janë realizuar në vitin 2006.

Zyrës së prokurimit i është përcjellë për procedurë të mëtejme "Projekti për vendosjen e shportave të mbeturinave në rrugët më të frekuentuara të qytetit" dhe "Projekti për mirëmbajtjen e krojeve publike të qytetit".

Për këtë periudhë njëvjeçare, Shërbimi i Mbrojtjes së Ambientit ka pranuar 20 kërkesa për rregullimin e sipërfaqeve gjelbëruese para objekteve të banimit, të cilat janë shqyrtuar si në vijim:

- **9 pëlqime, 8 njoftime, 1 refuzim, 1 plotësim kërkesë dhe 1 për leje urbanistike.**

Së bashku me NPK "Hortikultura" kemi realizuar projektin për rregullimin dhe mirëmbajtjen e sipërfaqeve gjelbëruese në Gërmë, në bashkëpunim me MPMS dhe UNDP.

XIII. DREJTORATI I SIGURISË CIVILE DHE I EMERGJENCËS

Kjo drejtori detyrat dhe aktivitetet i ka realizuar në bazë të Programit të rregullt të punës për vitin 2006, i cili është harmonizuar me Statutin e Komunës, Rregulloren e Komunës mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës. Realizimi i detyrave dhe i aktiviteteve është bërë përmes: Sektorit të mbrojtjes civile, Sektorit të emergjencës, bashkpunimit me drejtoritë tjera të Komunës, Departamentin e Menaxhimit të Emergjencave, SHPK-në, TMK-në dhe subjektet tjera që në fushëveprimin e vet realizojnë aktivitetet të ngjashme nga ky lëmë.

SEKTORI I MBROJTJES CIVILE

Sektori i mbrojtjes civile, gjatë vitit 2006, punën e vet e ka mbështetur në:

- Hartimin e Programit vjetor të punës në nivel të drejtorisë, të hartimit të planeve të rregullta mujore që dalin nga Programi vjetor i punës;
- Organizimin e trajnimeve në kuadër të drejtorisë, ku vlen të përmendet trajnimi i organizuar me të gjitha shtabet dhe ekipet e formuara pranë bashkësive lokale. Ky trajnim ka zgjatur tre muaj dhe në të kanë marrë pjesë 500 pjesëmarrës. I njëjti trajnim është demonstruar edhe në lokalet e shkollës fillore “Ismail Qemali” në Prishtinë, i cili, në fund, nga të prinishmit u vlerësue si i suksesshëm. Në këtë trajnim ishin pjesëmarrësit e njëjtë nga trajnimi i mëparshëm;
- Organizimin dhe zbatimin e ushtrimit (trajnimin teoriko dhe praktik) nga inspektorët e Mbrojtjes Civile nëpër bashkësi lokale, me theks të veçantë në përgatitjen e strukturave civile të bashkësive lokale në raste emergjente;
- Përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për verifikimin e gjendjes momentale të strehimoreve publike nga sektori në fjalë, të cilat duhet të jepen në shfrytëzim. Sektori, në bashkëpunim me komisionin e formuar nga Komuna, e të cilin e kryeson shefi i Sektorit të mbrojtjes civile, është në përfundim të kryerjes së punës për dokumentacionin e nevojshëm, i cili është i bazuar në procedurën ligjore;
- Përmbajtjen dhe përpunimin e të dhënave për hartimin e procesverbalit për punën e kryer në vizitat e objekteve të banimit në Bashkësinë III, IV, dhe V lokale;
- Informatën mbi inspektimin e mbrojtjes civile të kryer nëpër objektet e banimit mbi katër kate në territorin e Bashkësisë I, II dhe III lokale, të dërguara Bordit të drejtorëve për shqyrtimin dhe miratimin e tij. Gjatë këtyre vizitave janë inspektuar mbi 90 objekte banimi, të cilat kanë më shumë se dy hyrje. Gjatë inspektimit gjendja ka rezultuar me: uzurpimet e hapësirave të përbashkëta, rrezikimin dhe pengimin e qarkullimit të lirë të banuesve nëpër objekte, mbi ndërtime, papastëritë nëpër bodrume dhe hapësira të përbashkëta, mungesa e aparateve të zjarrfikësve, hidranteve, shkallët emergjente, instalimi i vjetëruar i rrymës elektrike, mungesa e ashensorëve dhe mosfunksionimi i tyre etj. Inspektorët e Mbrojtjes Civile kanë shqiptuar 65 masa dhe për to e kanë njoftuar Drejtoratin e Inspektionit komunal për evitimin e tyre. Inicimi i propozimit për marrjen e masave në mënjanimin e keqpërdorimeve nëpër objektet e banimit;
- Pjesëmarrje në mbledhjet e rregullta të bashkësive lokale, të organizuar nga ana e Drejtoratit të Administratës – Sektori i BL-ve ;
- Në bashkpunimin me komunat tjera, ku gjatë periudhës raportuese është vizituar Lypjani, Drenasi dhe Skënderaj. Qëllimi i këtyre vizitave kishte karakter pune, me mundësi që këto vizita tijn sa më të shpeshta.

Edhe përkundër dëshirës për vizitë jashtë vendit, drejtorive të veprimtarive të njëjta, nuk u është bërë e mundur për arsye të shkaqeve objektive. Shpresojmë se një vizitë të tillë do ta realizojmë gjatë vitit 2007.

SEKTORI I EMERGJENCËS

Në kuadër të këtij sektori vepron Qendra për Informim, Alarmim dhe Koordinim, inspektorët e preventivës dhe hulumtimit të zjarrit, Brigada e Zjarrfikësve, koordinatori, bashkëpunëtori për logjistikë dhe bashkëpunëtori me BZP-në. Ky sektor veprimtarinë, detyrat dhe aktivitetet e planifikuara për vitin 2006, i ka realizuar në bashkëpunim të ngusht me Sektorin e mbrojtjes civile dhe subjektet tjera gjegjëse të Komunës dhe me gjerë, siç janë SHPK-ja, TMK-ja etj..

- Në periudhën raportuese prioritet i Sektorit ishte ndërmarrja me kohë e masave parandaluese në rast të ndodhjes së ndonjë fatkeqësie natyrore apo fatkeqësive tjera, me qëllim të ruajtjes së popullatës, si dhe zvogëlimit të dëmeve materialo-teknike të cilat do të shkaktoheshin po që se ndodhin.
- Në nivel të Sektorit, koordinatori me bashkëpunëtorë ka bërë azhurimin adekuat të Planit për gatishmeri emergjente dhe civile në komunën e Prishtinës dhe Planit të reagimit në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera në komunën e Prishtinës. Koordinatori rregullisht i ka koordinuar detyrat dhe aktivitetet me strukturat jasht komunale, si me SHPK-në, TMK-në, QMF-në, Kryqin e Kuq komunal, Entin e Nihmës së Shpejt etj.
- Një kujdes të veçantë ky sektor i ka kushtuar përgatitjes së dokumentacionit të nevojshëm dhe marrjes së lejes për fillimin e ndërtimit të objektit të ri të Bazës së Zjarrfikësve, lokacioni i të cilit është caktuar nga Kuvendi i Komunës.
- Brigada e Zjarrfikësve (BZP) e cila vepron në kuadër të Sektorit të emergjencës, është specializuar dhe e aftësuar për intervenime të ndryshme, e sidomos në fikjen e zjarrit, shpëtimin e njeërzve, shpëtimin e të mirave materiale të rrezikuara nga zjarri, si dhe fatkeqësitë tjera natyrore siç janë: vërshimet, përmytjet nga uji, shembja e dheut etj. për intervenime në aksidente të ndryshme në trafik etj.

Intervenimet e BZP-së për vitin 2006 janë të paraqitura në mënyrë tabelare si më poshtë:

Intervenimet e BZP-së gjatë vitit 2006:

Komuna	Zjarre	Inter. Teknike	Pjesëmarrës			Të Lënduar	Të vdekur	Vërejtje
			Autom.	Zjarre	Orë pune			
Prishtinë	510	156	839	3138	3686	32	6	
Fushë-Kosovë	49	11	69	246	1202	5	1	
Obiliq	14	5	31	111	245	6	2	
Lypjan	3	-	4	12	23	/	/	
Podujevë	3	1	7	20	47	1	4	
Gjakovë	/	1	2	5	40	-	1	
Gjithsej:	579	174	952	3532	5243	44	14	

Objektiv i BZP-së për 2007 është: sa më shumë trajnime profesionale, pajisja me teknikë adekuate, ndërtimi i objektit të ri të Bazës dhe rritje të buxhetit dhe shfrytëzimi i drejtë i tij. Për fat të mirë, të lënduar rëndë dhe as viktimë gjatë gjithë këtyre intervenimeve brenda vitit 2006, nuk kemi pasur nga ana e zjarrfikësve e as të eprorëve të tyre.

- Inspektorët e preventivës dhe hulumtimit të zjarrit, aktivitetin e tyre e kanë zhvilluar në pajtim me planin e punës, më poshtë në mënyrë tabelare paraqitet ky aktivitet:

1.

a) Tremujori i parë.....	5 persona juridikë
b) tremujori i dytë.....	13 persona juridikë
c) tremujori i tretë.....	24 persona juridikë
d) tremujori i katërt.....	10 persona juridikë

Gjithsej 52

NUMRI I MASAVE

- Tremujori i parë.....	33 masa
- tremujori i dytë.....	80 masa
- tremujori i tretë.....	137 masa
- tremujori i katërt.....	50 masa

Gjithsej: 290 masa

3.KATEGORIA:

- e parë.....	5 objekte
- e dytë.....	12 objekte
- e tretë.....	25 objekte
- e katërt.....	10 objekte

Gjithsej: 52 objekte

OBJEKTET:

- Personave juridikë.....	10 objekte
- Personave fizikë.....	32 objekte

Gjithsej: 42 objekte

II.PROCESVERBALE ME MASA DHE AFATE TË KONTROLLIT:

1.

- tremujori i parë.....	37 subjekte
- tremujori i dytë.....	44 subjekte
- tremujori i tretë.....	21 subjekte
- tremujori i katërt.....	20 subjekte

Gjithsej:112 subjekte

2.NUMRI I MASAVE:

- tremujori i parë.....	218 masa
- tremujori i dytë.....	190 masa
- tremujori i tretë.....	114 masa
- tremujori i katërt.....	102 masa

Gjithsej: 624 masa

3.KATEGORIA:

- e parë.....	5 subjekte
- e dytë.....	10 subjekte
- e tretë.....	82 subjekte
- e katërt.....	25 subjekte
	Gjithsej: 122 subjekte

4. OBJEKTE:

objekte të personave juridikë dhe objekte personave fizikë:

Gjithsej:.....162 objekte

III. SHIKIMI - HULUMTIMI I ZJARREVE:

-objekte të personave juridikë.....	8 raste
-objekte të personave fizikë.....	30 raste
	Gjithsej 38 raste

Në kuadër të këtij sektori vepron Qendra për Informim, Alarmim dhe Koordinim, e cila punon 24 orë. Operatorët kujdesen për mirëmbajtjen e radiolidhjeve bazë, që janë të vendosura në BL-të rurale. Gjithashtu, përmes kësaj Qendre mbahet evidenca e hyrjeve-daljeve të shërbyesve civilë në Komunë, të cilat i distribon në fund të çdo jave para Bordit të drejtorëve.

Një rol të rëndësishëm në realizimin e objektivave të drejtorisë në fjalë, e ka dhënë logjistika-bashkëpunëtori për logjistikë, i cili me përgjegjësi i ka përcjellë aktivitetet gjatë vitit.

Buxheti i përgjithshëm i lejuar për Drejtorat për vitin 2006, në të cilën është përfshirë edhe Brigada e Zjarrfikësve, ka qenë 460.798.00 €. Në këtë shumë nuk janë llogaritur pagat e punëtorëve.

Për shpenzimet kapitale për këtë vit janë shpenzuar me sa vijon:

- Për rroba të dimrit për zjarrfikës.....	13.977,00 €
- për blerjen e këpucëve të verës	3.825,00 €
- për këpuca dimri për zjarrfikës.....	8.940,00 €
- për mirëmbajtjen e repetitorit në Butovc.....	5.941,00 €
- për instalimin e alarmit në qytet.....	44.500,00 €
- për derivate për BZP-në.....	24.699,00 €
- para të gatshme për BZP-në.....	10.118,63 €
- hargjime për ushqim të BL.....	2.250,00 €
	Gjithsej:...114.250,63 €

-të zotuar 124.000,00+13.650,00 137.650,00
Total:.....251.900,63 ose 54,66%

Arsyet kryesore pse këto mjete nuk janë shpenzuar, janë: vonesa e madhe në tenderim, mosparaqitja e kandidatëve serioz në tenderimet e shpallura etj. Këto mjete janë të zotuar dhe pritet të realizohen gjatë vitit 2007. Gjithashtu, nga Kuvendi i Komunës janë lejuar edhe 200.000.00 € për fillimin e punëve në ndërtimin e Bazës për BZP-në, por për shkaqe procedurale këto mjete janë orientuar në investime tjera kapitale. Në bazë të evidencës që ka në dispozicion drejtoria në fjalë, nga shuma e lejuar buxhetore që ishte 460.798.00 €, janë shpenzuar 251.900,63 €, marrë në përqindje është 54.65%, me çka nuk jemi të kënaqur. Arsyet pse nuk janë hargjuar këto mjete u cekën më lart.

XIV. Zyra komunale për komunitete

Zyra komunale për komunitete, gjatë vitit të kaluar është kujdesur për bashkësitë joshqiptare në territorin e komunës së Prishtinës, në harmoni me integrimet dhe me koordinimin konkret me udhëheqësit dhe me shërbimet kompetente.

Në pjesën e administratës së përgjithshme, zyra ka punuar në harmoni me rregullativat në fuqi, duke promovuar tolerancën dhe barazinë e të gjithëve që na janë drejtuar, por edhe në mesin e punëtorëve, duke promovuar me atë rast edhe institucionin tonë.

Mjetet financiare janë shfrytëzuar në harmoni me me buxhetin e akorduar dhe procedurën komunale të nënshkruar.

Në ndarjen e mjeteve për investime kapitale jemi mbështetur në përfaqësimin numerik të bashkësive dhe në përfaqësimin numerik nëpër fshatra, me atë rast duke pasur kujdes për nevojat e përbashkëta, si dhe për nevojat momentale për disa projekte. Të gjitha këto janë bërë në bashkëpunim me udhëheqësit, strukturat kompetente, përfaqësuesit e bashkësive dhe fshatrave, e në interes të të gjithë qytetarëve të komunës sonë.

Në lëmin e arsimit dhe të shëndetësisë, e në kohën e ingerencave të paharmonizuara, Zyra është përpjekur që t'i ruajë lidhjet e mundshme në mes të drejtorive të Komunës së Prishtinës dhe institucioneve të përmendura.

Po ashtu, kujdes i veçantë është kushtuar dhe janë promovuar shumë aktivitete, të cilat kanë ndikime pozitive në marrëdhëniet ndëretnike.

Zyra ka pasur aktivitete dhe kontakte të rregullta në bazë të kërkesave të përfaqësuesve të fshatrave, përfaqësuesve të bashkësive, policisë, KFOR-it, organizatave joqeveritare, institucioneve, ndërmarrjeve etj..

Gjatë tërë kohës janë mbajtur kontakte korrekte me përfaqësuesit e UNMIK-ut.

ADMINISTRATA E PËRGJITHSHME DHE FINANCAT

- Pas përfundimit të gjysmës së parë të vitit afarist, bashkë me personelin që i takon shërbimit të përgjithshëm, kemi mbajtur mbledhje konsultative, duke ua bërë me dije të punësuarve se autoriteti i inkuadruar në vitin e ardhshëm, në bazë të vlerësimeve mbi detyrat e kryera të punës, si dhe miratimit të planeve individuale të punës për vitin raportues, na pret nivel më i lartë i angazhimit në plotësimin e detyrave të punës, duke respektuar normat e parashikuara të të punësuarve.

Numri i punëtorëve të punësuar në janar dhe shkurt të vitit 2006, ka qënë 27 punëtorë, me tendencë të rritjes së numrit të të punësuarve në 32, sa ka qënë e paraparë me sistematizimin e vendeve të punës. Pra, nga autoriteti i punësuar është kërkuar pëlqimi për shpalljen e vendeve të lira të punës, gjë që është bërë, mirëpo deri te punësimi, respektivisht deri te plotësimi i vendeve të punës nuk ka ardhur për shkaqe objektive, kështu që vendet e punës me përparësi, janë plotësuar me kuadrin ekzistues të OKZ-së.

Në muajin mars numri i punëtorëve ka qënë 28, pasi është punësuar punëtori në vendin e punës, asistent për shëndetësi. Nga fundi i muajit, drejtorit të Zyrës i është dorëzuar kërkesa për inicimin e përgjegjësisë disiplinore kundër punëtorit Zoran Nedelković, i dyshuar për bashkëpunim dhe mundësim të vjedhjes nga lokalet afariste. Lënda është dërguar me kohë në Stacionin e Policisë, si dhe Shërbimit të përgjithshëm të Prishtinës, me qëllim të konstatimit të përgjegjësisë penale. Punët dhe detyrat e punëve të sigurimit, me kontratë për kohë të caktuar, i kryen në bazë të shpallje, me këtë rast pranohet punëtori jashtë marrëdhënies së punës prej 1.4.2006.

- Në muajin maj 2006, me marrëveshje u ndërpritet marrëdhënia e punës tre punëtorëve të cilët i kanë kryer detyrat e punës në regjistrimin civil dhe për shkak të dislokimit të këtij shërbimi. Andaj, Komuna me konkurs ka punësuar punëtorë për kryerjen e këtyre punëve, që i përket të njëjtit shërbim për regjistrim civil pranë shërbimit të përgjithshëm të Komunës së Prishtinës. Po ashtu, ndërpritet marrëdhënia e punës me këshilltarin për çështje juridike pranë OKZ-së, për shkak të mosaktivitetit dhe mosrespektimit të obligimeve të punës.
- Në muajin qershor, me marrëveshje ndërpritet marrëdhënia e punës edhe me udhëheqësin e Shërbimit të inspektimit, andaj paraqitet nevoja për kompletimin e këtij shërbimi, i cili funksionon me përbërje jo të plotë.
- Shfytëzimi i pushimit vjetor bëhet sipas planit të dërguar nga ana e udhëheqësve të shërbimit, por disa vështirësi paraqiten në këtë shërbim. Punëtori i cili punon si pastrues, në ndërkohë vet e lëshoi punën, pastaj kemi edhe shkuarje të pa planifikuara në pushime mjekësore.

Slobodan Kërstiqi, punëtor teknik, në emër të Zyrës së bashkësive mer pjesë në të gjitha mbledhjet e komiteteve për bashkësi, që mbahen tri herë në muaj, ku prezanton aktivitetin javor të kësaj zyreje.

Bashkëpunimi me Zyrën e bashkësive, e vendosur në lokalet e Komunës së Prishtinës, ka qënë i përditshëm.

Ndihma e drejtorit lidhur me punën e Shërbimit të përgjithshëm dhe të financave, ka qënë në nivel, kështu që problemet eventuale janë zgjidhur në mënyrë efikase dhe me kohë, si me punët e administratës së përgjithshme, ashtu edhe me çështjet e natyrës financiare.

F i n a n c a t:

Me buxhetin e Komunës së Prishtinës për vitin afarist 2006, për bashkësitë pakica është parashikuar:

Për investime kapitale(nuk janë planifikuar mjete nga të ardhurat).....	97.430.00 €
Për mallra dhe shërbime.....	78.048,00 €
Të ardhurat personale	63.570,00 €

Duke marrë parasysh zvogëlimin drastik të buxhetit, parashikuar për pjesën e investimeve kapitale, në krahasim me me vitin e mëparshëm afarist, në bashkëpunim me liderët e bashkësive dhe duke respektuar kriteret e caktuara, janë caktuar prioritetet me interes për bashkësitë të cilat do të përshkruhen në raportin e Shërbimeve publike.

Të ardhurat personale:

Buxheti i planifikuar për të ardhurat personale të punëtorëve për vitin raportues, janë 63.570,00 € për 28 punëtorë.

Në muajin janar numri i të punësuarve ka qenë 27, me tendencë të rritjes derisa ato të plotësohen e të sistematizohen. I njëjti numër ishte edhe në muajin shkurt, dhe me punësimin e punëtorëve sipas konkursit, në muajin mars, numri i punëtorëve të punësuar ishte 29 (me punësimin e punëtorëve për zëvendësimin e atyre që janë suspenduar), e me marrëveshje për ndërprerjen e marrëdhënies së punës në muajt e kuartalit të fundit ai numër ishte 24.

Të ardhurat personale për të përmendurit janë realizuar në shumën 54.535,50 euro, përkatësisht 85,78% me pjesën e mbetur të parapar për të ardhura personale në shumën prej 9.034,50 ose 14,22% (suficiti).

Mallra dhe shërbime

Buxheti i paraparë për mallra dhe shërbime ? Good & Services?, për vitin afarist 2006 ka qenë 78.048,00 €.

- buxheti i realizuar	68.806.64 €
- suficiti.....	14.241.36 €

Projektet kapitale

Për projekte kapitale është paraparë buxheti prej 97.430,00 € prej granteve, mirëpo Komuna për projekte kapitale, nga burimet - të hyrat vetanake, ka investuar për bashkësitë pakicë edhe 71.814,00 euro për projekte që janë paguar në vitin 2006.

Është bërë bartja e obligimeve tjera financiare nga viti 2006 në vitin 2007, dhe ato do të realizohen kur të kryhen projektet në tërësi.

Bartja e obligimeve financiare nga viti 2006 në vitin 2007, kanë të bëjnë me punimin e stacionit të pompës dhe të rrjetit të ujësjellsit për fshatin Shushicë, asfaltimin e rrugëve lokale 50% nga vlera e projektit, pra hartimi i dokumentacionit teknik projektues.

Me këtë raport vjetor është dhënë pasqyra e aktiviteteve kryesore të shërbimit gjatë vitit 2006.

SHËRBIMET PUBLIKE

Në kuadër të Sektorit të shërbimeve publike të ZKK-së në Graçanicë, funksionojnë këto shërbime:

- Planifikimi urban,
- Shërbimi i inspektionit,
- Shërbimi i kadastrit,
- Nëpunësi për zhvillim ekonomik,
- Nëpunësi për bujqësi- Bërnica e Poshtme,
- Nëpunësi për zhvillim-Slivovë.

Duke pasur parasysh se Graçanica me rrethinë nuk ka bërë zgjidhje urbanistike, siuate e këtyllë në terren e vështirëson shumë zgjidhjen më të mire dhe më efektive për realizimin e problemeve të infrastrukturës në kuadër të buxhetit të lejuar të Komunës së Prishtinës.

Kur merret parasysh buxheti i paraparë, krahas bashkësisë serbe edhe bashkësitë tjera joshumicë që jetojnë në territorin e komunës së Prishtinës, atëherë është shumë vështirë të zgjidhen të gjitha problemet për bashkësitë.

Mirëpo, krahas kësaj ZKK e Graçanicës, në periudhën kohore të vitit 2006 i ka hartuar disa projekte të rëndësishme për bashkësitë. Për Sektorin e shërbimeve publike mund të thuhet si vijon: aktivitetet kryesore të sektorit kanë qenë të orientuara në planifikimin dhe realizimin e buxhetit të paraparë financiar, nëpërmjet përpilimit të dokumentacionit teknik të projekteve për problemet komunale dhe ato infrastrukturore për bashkësinë serbe dhe bashkësitë tjera etnike (rome, turke, boshnjake, e ashkallike) në komunën e Prishtinës.

Projektet e realizuara në vitin 2006:

Projekti, “Hartimi i sinjalizimit horizontal në Graçanicë”, vlera e projektit 6.929,00 euro.

Projekti “Blerja e agregatit për spitalin e Kirurgjisë dhe të Gjinekologjisë” në Graçanicë, fuqia e agregatit është 70 KV; vlera e projektit 14.523,00 euro.

Projekti multi-etnik “Punimi i stacionit të pompës dhe të rrjetit të ujësjellësit Kishnicë-Sushicë”. Me përfundimin e këtij projekti zgjidhet problemi afatgjatë i furnizimit me ujë për vendbanimin Badovci i Ri dhe Sushicën. Vlera e punëve të kontraktuara është 59.820.00 euro.

Projekti “Asfaltimi i rrugëve lokale të Graçanicës, Sushicës, Llaple-Sellës, Preocit, Çagllavicës; sanimi i gropave goditëse në Bërnice të Poshtme”, pjesa e projekteve është punuar si multi-etnike në Sushicë, në një gjatësi prej 600 m; bashkësisë rome në Graçanicë në gjatësi prej 650 m, e pjesa tjetër në mjediset e përmenduar të bashkësisë serbe në Graçanicë. Projekti është jashtëzakonisht i dobishëm, sepse me realizimin e tij përmirësohen shumë kushtet për jetë. Gjatësia e përgjithshme e rrugëve të punuara është 2270 m, e gjerësia 3.0 m plus bankinet për 0.50 m. Vlera e punëve të kontraktuara e të kryera është 104.725.00 euro .

Projekti “Pastrimi i varrezave ortodokse “ në Prishtinë, është bërë duke bërë pastrimin e kaçubave, shkurreve, drurëve etj., është bërë edhe sanimi i rrethojave. Vlera e punëve të kontraktuara dhe të kryera është 3.610.00 euro.

Projekti “Punimi i rrjetit të kanalizimit në Çagllavicë e në Graçanicë”. Me projektin e paraparë është punuar kanalizimi në Çagllavicë, në gjatësi prej 480 m; në Graçanicë në gjatësi prej 480 m, e vlera e punëve të kontraktuara dhe të punuara është 23.263.40 euro.

Projekti “Punimi i rrethojës për kopshtin e fëmijëve në Graçanicë”. Rrethoja është punuar për kopshtin e ri në Graçanicë. Gjatësia e rrethojës së punuar është 230 m, ndërsa vlera e punëve të kontraktuara dhe të kryera është 13.009.40 euro.

Projekti “Punimi i platosë dhe të laurës (rampës) hyrëse të Shtëpisë së personave me aftësi të kufizuara në Graçanicë”.

Projekti është punuar në oborrin e Shtëpisë së personave me aftësi të kufizuara dhe shërben për parkimin e automjeteve dhe për lojërat e fëmijëve. Vlera e punëve të kryera është 2.965.00 euro.

Projekti “Punimi i urës A.B në Lagjën e Romëve në Graçanicë”. Ura është punuar në Lagjën e Romëve mbi lumin Graçanka në Graçanicë. Distanca e urës është 9.00m, gjerësia e urës 5.50 m, shiriti i rrugës 4.00 m. Vlera e punëve të kontraktuara dhe të kryera është 15.425.60 euro.

Projekti “Pastrimi i rrugëve dhe mbeturinave” në Graçanicë, Preoc, Llaple-Sellë, Badovc të Ri, Çagllavicë dhe larja e rrugëve në Graçanicë. Vlera e punëve të kontraktuara e të punuara është 9.016.00.

Projekti “Ndërtimi i terrenit të futbollit në Lagjen e Romëve në Graçanicë”. Me mjete të donatorëve, punët e tokës (dheut) i ka kryer KFOR-i , vlera e të cilave është afro 25.000 euro, ndërsa hedhja e dheut dhe mbjellja e barit është financuar nga OSBE-ja, fara e barit është sjellë nga KFOR-i çek.

Krahas projekteve të përmendura, në të gjitha mjediset e komunës së Prishtinës me shumicë serbe dhe në bashkësitë tjera joshqiptare, janë punuar projekte të infrastrukturës komunale, përmbajtja e të cilëve ka qenë përmirësimi i kushteve të jetës për të gjitha bashkësitë etnike.

Buxheti i sektorëve të shërbimeve publike MSO të Graçanicës, në asnjë rast nuk ka qenë i mjaftueshëm në mënyrë që të plotësoheshin në tërësi nevojat e bashkësive për zgjidhjen e problemeve komunale të ifrastrukturës, sepse është evident problemi në bashkësi, ku është e domosdoshme që në vitin vijues të punohen: rrugët, kanalizimi, ujësjellësi dhe rrjeti elektrik.

Shërbimi i inspektionit

Në kuadër të Shërbimit të inspektionit të ZKK-së në Graçanicë, punojnë:

- Inspekcioni dërtimtarisë,
- Inspekcioni komunal,
- Inspekcioni sanitar.

Të gjitha shërbimet e inspektionit punojnë gjatë tërë vitit dhe janë munduar që me punën e tyre, t'i plotësojnë të gjitha detyrat e punës që i parasheh shërbimi.

Bashkëpunimi shumë i mirë me SHPK-në, Stacionin e Policisë në Graçanicë, të cilët kanë qenë të gatshëm për ndihmë në çdo moment.

Edhe krahas angazhimit të përhershëm, Shërbimi i inspektionit nuk i ka kryer në tërësi detyrat e veta të punës për shkak të specifikave të situatës në terren.

Shpresojmë se Shërbimi i inspektionit në këtë vit do të jetë më energjik për kryerjen e detyrave të veta të punës.

Shërbimi i gjeodezisë

Në kuadër të gjeodezisë punon një gjeometri.

Gjeometri bënë matjen në terren, pranon kërkesat e qytetarëve për rregullimin e të drejtave të ndihmës sociale, të cilat i realizon nëpërmjet Kadastrit në Prishtinë.

Ka bashkëpunim të mirë me Kadastrin e Komunës së Prishtinës.

Nëpunësi i zhvillimit ekonomik

Shërbimi për zhvillim ekonomik në Graçanicë ka realizuar projektet për zhvillim të bujqësisë ekzistuese; ka zbatuar risi në procesin e prodhimit, ka nxitur ekonominë e vogël dhe të mesme nëpërmjet donacioneve, të cilat janë siguruar nga Kontingjenti finlandez i KFOR-it, të cilat janë realizuar në gjysmën e parë të vitit 2006.

Në kuadër të aktivitetit të shërbimit të zhvillimit ekonomik në vitin 2006, janë sjellë kontejnerët për vendosjen e të shpërngulurve intern në territorin të cilin me kompetencat e veta e mbulon. Zyra për komunitete në Graçanicë, ka dërguar 30 kontejnerë të pabanuar.

Nëpunësi bujqësor – Bërnica e Poshteme

Projekti është realizuar në bashkëpunim me organizatën IOM, dhe ka të bëjë me bashkëfinancim në projektin “Ndërtimi i ngrohjes qendrore në SG.F “Dimitrije Prica” dhe Shtëpia e Kulturës. Vlera e projektit të cilin e financon zyra e jonë është 5.635,79€, ndërsa ka përfshirë edhe pjesën e klasës së Shkollës fillore.

Projekti “Asfaltimi i rrugëve lokale në Graçanicë, Sushice, Laple-Sell, Preoc, Çagllavicë, sanimi i gropave goditëse në Bërnicën e Poshteme, sanacioni ka përfshirë gropën goditëse në Bërnicën e Poshtme, në sipërfaqe prej rreth 500 m².

Nëpunësi për zhvillim – Slivovë

Nga viti 2005 ka ngelur disa probleme të mëdha: sanimi i deponime në Graçanicë, asfaltimi i rrugës Graçanicë- Laple-Sell, zgjidhje e sasisë së madhe të deponive me mbeturina në të gjitha mjediset serbe.

Ne fund të raportit, dëshiroj te ceku bashkëpunimin jashtëzakonisht të mire me të gjithë sektorët e cekur të Komunës së Prishtinës, të cilët, në çdo moment, kanë qenë të gatshëm të na ndihmojnë në zgjedhjen e problemeve tona në terren.

Shpresoj se edhe në vitin 2007, bashkëpunimi do të jetë edhe më i mirë në relacionin Komuna e Prishtine – Zyra për komunitete në Graçanicë.

ARSIMI DHE SHËNDETËSIA

Arsimi

Sektori për arsim ZKK në Graçanicë gjate vitit që po raportojmë, ka kryer aktivitete të cilat janë të lidhura drejtpërdrejt me sistemin e funksionimit të shkollave dhe të institucioneve shëndetësore që ekzistojnë në territorin e komunës Prishtinës. Pjesa më e madhe e punës së këtij sektorit është bërë në përpilimin dhe korrigjimin e listave të pagave, në bashkëpunim me Drejtoratin e Arsimit në Prishtinë, dhe përcjellja e vazhdueshme e transportit të nxënësve në të dy relacionet : Preoc-Graçanicë dhe Bërnice e Epërme – Graçanicë. Meqë Drejtorati i Arsimit në fillim të këtij viti shkollor, ka marrë të dhënat për numrin e nxënësve dhe paraleleve, ajo në bazë të të dhënave të arritura, ka planifikuar buxhetin për paga për vitin shkollor 2006/2007. Pasi që shkalla e bashkëpunimit në mes të institucioneve edukativo-arsimore dhe Drejtoratit të Arsimit në Prishtinë është në nivel të papëlqyeshëm, edhe në këtë vit është përsëritur praktika nga viti paraprak. Sektori i jonë për çdo muaj ka marrë “valcer-listat” e pagave nga Ministria e Shërbimeve Publike dhe ato ua ka ofruar të gjitha institucioneve për nënshkrim. Listat e pagave i kanë nënshkruar vetëm dy vozitës të minibuseve të shkollës. Ndërkohë është paraqitur një numër i punëtorëve, të cilët janë paraqitur pranë sektorit tonë, me dëshirë që edhe më tej të vazhdojnë me marrjen e mjeteve nga buxheti i Kosovës.

Për këtë kemi lajmëruar te kompetentët (ZKK në Graçanicë) dhe në Drejtoratin e Arsimit në Prishtinë me anë të raportit javor.

Gjatë vitit shkollor dy herë është dërguar dokumenti- oferta e shpenzimeve materiale për institucionin shkollor dhe parashkollor. Në asnjë rast shkollat nuk na kanë dërguar kërkesenevojat e veta në emër të shpenzimeve materiale, të cilat duhet dërguar në bazë të numrit të nxënësve, nga arsyet e cekura më parë.

Sikur edhe viteve tjera edhe në këtë vit, Drejtorati i Arsimit në Prishtinë ka siguruar lëndë djegëse për shkollat, të cilat ngrohjen e bëjnë me dru, naftë, dhe qymyr. Sasitë janë cekur në raportin javor, nga shkaku i mosshimit (rritjes) të hapësirës shfrytëzuese të objektit.

Në vitin e kaluar shkollor një pjesë e mjeteve është ndarë për pagesën e faturave të cilat janë paguar edhe vitin e kaluar (qiraja në Slivovë, faturat për servisimin e minibuseve të shkollës në shumë deri në 100 €.

Në vitin shkollor 2005/2006 është bërë regjistrimi i minibuseve (në një afat shumë të shkurtër- duke falënderuar Drejtoratin e Arsimit të Komunës së Prishtinës), por problem të madh paraqet mirëmbajtja e përditshme e automjeteve. Dy minibuse të shkollës të cilët bëjnë transportimin e nxënësve në relacionin Preoc-Graçanicë dhe Bërnice e Epërme-Graçanicë-Bërnice e Epërme, e kanë mekanikun i cili i mirëmban automjetet.

Kontribut në kryerjen e detyrave të punës në Sektorin e arsimit, kanë dhënë edhe asistentët për arsim dhe asistentët për shëndetësi.

Sektori i shëndetësisë

Ne Sektorin e shëndetësisë edhe gjatë këtij viti ka pasur më pakë aktivitete, nga shkak se ka pasur më pakë bashkëpunim ne mes te drejtorit të Qendrës mjekësore dhe Drejtoratit të Shëndetësisë në Prishtinë. ZKK në Graçanicë shumë herë ka qenë në dispozicion për koordinim në mes të institucioneve te cekura. Ka pasur tentime që për disa qendra të sigurohet aparatura medicinale me anë të donatorëve, por prej shume përpjekjeve është realizuar donacioni i Zyrës komunale për komunitete-për Qendrën kirurgjike në Graçanicë (Spitali Simonida). Donacioni ka qenë i paraparë për agregat, i cili ka qenë i domosdosëm për funksionim normal të institucionit në tërësi, veçanërisht në sallën e operacionit, në kohën kur është reduktimi i energjisë elektrike. Në fillim të vitit në Sektorin e shëndetësisë është angazhuar punëtori (asistent për arsim), i cili ka qenë i angazhuar në punët lidhur me këtë sektor, por ai ka paralajmëruar shkëputjen e kontratës, prandaj ky sektor do të mbetet me vendin e zbrazët të punës.

Kulturë

Aktivitetet në fushën e kulturës kanë qenë të llojllojshme, pjesa më e madhe e manifestimeve është organizuar në bashkëpunim me Shtëpinë e Kulturës në Graçanicë.

Një nga manifestimet e rëndësishme ka qenë e organizuar në bashkëpunim me Ambasadën çeke në Beograd, përmbajtja e së cilës ka qene organizimi i ekspozeve “Fotografia gazetareske çeke 2004” dhe shfaqja e dy filmave dokumentarë nga jeta e përditshme në Republikën e Çekisë.

Gjithashtu, janë organizuar dhe sponsoruar nga ana e Zyrës shume aktivitete sportive (turnir: tenis tav., futboll i vogël, shah ... turniret memoriale, si dhe aktivitete të tjera sportive).

Janë përkrahur disa aktivitete për organizimin e invalidëve, Shoqatës së të Verbërve, OON (Organizim për Persona të Retarduar – me të meta), KFOR-i ka kryer punët tokësore për ndërtimin e fushës së futbollit në Lagjen e Romëve në Graçanicë.

Nga ana e OSCE-së është financuar mbjellja e barit në fushën e nisur të futbollit me punët tjera përcjellëse.

Janë përkrahur Nga ana e Zyrës janë përkrahur edhe aktivitetet e bashkësive tjera pakicë: rom, ashkali, boshnjak dhe turk.

Janë organizuar turne në futboll të vogël dhe basketboll në Graçanicë dhe Çagllavicë me rastin e Ditës Botërore të Romëve.

Është botuar përmbledhja e vjershave në gjuhën turke, të cilën e përgatiti Enver Baki ...

Në hapësirën pas Shtëpisë së Kulturës në Graçanicë, në bashkëpunim me Zyrën britanike është organizuar manifestimi kulturor-zbvitës me këtë përmbajtje: montimi dhe ngritja e balonit me ajër, komikët e veshur në kukulla të mëdha, të cilët argëtuan të pranishmit.

Me rastin e Ditës se Mbrojtjes së Ambientit është organizuar një numër aktivitete: maskenballi për fëmijë, garat ne biçiklizëm, kros, si dhe pastrimi i sipërfaqeve te gjelbëruar.

Është përkrahur manifestimi i fëmijëve të shkollave fillore dhe të mesme, përmes parakalimit, krijimit dramaturgjik, folklor, recitim dhe lojëra.

Është bërë pastrimi dhe rregullimi i varrezave ortodokse në Prishtinë dhe Kolovicë.

Pjesëmarrja në manifestimet e ndryshme është organizuar nga ana e institucioneve tjera, si nga ana e Drejtoratit komunal dhe Ministrië së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.